

HEJZA

Qëndrim RIJANI

**TEATËR - BËRËSIT LEHTË MUND TË SHNDËRROHEN
NË SUBJEKTE QË I "VRET" KOHA!**

PËRJETËSIMI LETRAR

Sot botohen libra pafund. Për fat të keq nga të ashtuquajturit "kritikë" shkruhet përgjithësisht për çdo vepër letrare, duke lënë në hipe edhe ndonjë krijues të vërtetë. Shumë pseudoshkrimtarë e kanë kthyer fushën e letrave në një duel, ku veshjes artistike dhe lëndës letrare nuk i vishet mendimi kritik dhe estetik

Violeta ALLMUÇA

Krijuesi qysh kur ka filluar të shkruaj një libër, ka zbuluar brenda botës së madhe edhe një botë tjeter, që quhet bota e tij e artit për ta publikuar në botën njerëzore. Mendimit për të sjellë një vepër artistike, poezi apo roman, me synimin e rrëfimit të vetes, hapësirës dhe kohës së jetës së krijuesit, duhet t'i përgjigjen sistematikisht disa pyetje të vështira: A e ka zhvilluar ky libër anën e thurjes së mendimit e vlerësimit? A e ka ky libër rrjetet e vështrimit e studimit kritik? A janë disa rezultate pajtim ose mospajtim me shkrimin e një libri që lidhen si një tërësi rezultatesh apo një vizion dhe fantazi e shkrimit? Çfarë ndodh me rivlerësimin e të tjerëve, për atë që i paraqet lexuesit?

Letërsia e mirëfilltë si gjithmonë për të qenë objekt i mendimit artistik duhet pranuar që duke pasur koherencën letrare të shpalë lidhjet pa kompleksë të dialektikës mes krijimit e mendimit. Po ashtu koncepti i interpretimit e shqyrtimit duhet kuptuar si një veprim letrar dhe ndërveprimit studiues. Veçantitë e shkrimit të një libri mbështeten në çështjet e tërësorës dhe shpirtërore, ku dëshmohet veprimi i fushës së ekzistimit të një vepre po aq letrare, sa edhe mendimi për realizimin e sistemit analistik dhe estetik. Tërësia e strukturës së një vepre letrare mund të kuptohet nëse lënda e krijimit përbashkët krijues dhe studiues? A duhet të bashkohet mendimi i krijuesit me veprimin hulumtues dhe kritik? Studimet e mëtejshme në kohët e sotme, ndërsa e ngrenë lart funksionin e krijimit artistik i kujtojnë autorit të mos harrojë edhe funksionin estetik apo mendimin letrar, në radhë të parë, të lexuesit që strukturën e asaj çka lexojnë duan ta ndiejnë në tërësinë e tyre shpirtërore. Letërsia e Rilindjes Kombëtare jo vetëm që shkruhej shqip me idenë e çlirimt kombëtar, jo vetëm i mëshonte bashkimit kombëtar, por ajo pati jehonë në epokën e saj megjithëse momenti artistik, veçanërisht në poezi nuk ishte dominant. Formësimi si art letrar shfaqet pas viteve 30, ndërsa pas viteve 45 arti dhe krijimi u kthyen në përkrahës të ideve ideologjike gjatë rendit shoqëror të kohës, ku spikati edhe letërsia, e disidentëve të regjimit, si Kasem Trebeshina, Visar Zhitë, Bujar Xhaferri etj, veprat e të cilëve morën edhe vëmendjen e kritikës dhe studimeve letrare që i quajti edhe "disidentë" estetikë.

Botëkuptimi mbi artin dhe letërsinë pas viteve 90 nxiti prodhimin artistik dhe mori hov, përkundër heroizmit të lirisë, ndërsa ra në sy numri i madh i krijuesve në shoqërinë shqiptare të kohës. Ndryshimi i dukshëm i strukturës krijuese me ndërrimin e mendimit, reflektimit mendor dhe shpirtëror kërkoi të ishte i qenësishëm në tërësinë krijuese, dhe pak e pohuar



në sferën e mendimit kritik. Sot kemi një tip tjetër krijuesi që sjell një formë të re, një stil të ri, që kemi pasur privilegji ta konstatojmë si një përvojë të re. Sot gjithçka letrare ose jo letrare lejohet, mu siç edhe pritej, sepse edhe liria ishte qëllim në veteve. Jetën dhe fatet njerëzore në mënyrë të vetëdijshme po sjellin sot edhe krijuesit e soçrealizmit në veprat letrare si përsëritje të rrëfimit në kuptimin e kohës së re. Po ashtu edhe krijuesit e pas viteve 90 kanë rritur sasinë e botimeve, duke pasur si kuptim vetëm iluzionin e të qenit vepër letrare, sipas frysës estetike. Mendimi kritik çuditërisht ende mungon. Tipi i krijuesit të sotëm që ka thyer zinxhirët e së shkuarës në diktaturën komuniste, i cili synon shpalimin estetik nëpërmjet gjuhës artistike, vijon të rikrijojë lëndën e tij, jashtë konceptit e përvojës që ka ekzistuar, në zbulimin e heroit dialektik dhe ligjeve të mohimit të "heroit" të shkuar, si "antihero" i sotëm. Por, ashtu si jeta njerëzore shkon në vazhdimësi edhe fjala artistike ndjek rrugën e saj. Shkrimitari i sotëm e vendos prototipin letrar si një objekt mohues, dobia e të cilit meqë nuk ka përligjur lirinë e kthen në tendencë jashtëkohore. Letërsisë që i thyhen prangat shpirtërore me ndërgjegjen e lirisë e bëjnë dukshëm të arsyeshëm ndjeshmérinë e krijuesit që lëshohet vrullshëm sipas përvojës së tij morale, estetike dhe artistike. Tipari i krijuesit të sotëm, meqenëse në art duhet të mbizotërojë estetikja e ka kthyer interpretimin e veprës letrare në rrafshin e "vetëreklamës" duke e menduar librin si një "kryevepër" të tij, pa mendimin kritik dhe studimor, nëse ajo është dhe do të mbetet një vepër letrare e vërtetë.

Veprat e Naim Frashërit, Jeronim De Radës, Ndre Mjedës, Asdrrenit etj, me theks romantik gjithherë përmes poeziës sollën libra me tematikë kombëtare dhe identitet kombëtar. Ndaj

veprat e tyre, përvoja krijuese, hulumtimi i gjatë, përfshirë edhe mendimin kritik të mëvonshëm, siç bëri Konica edhe si kritik letrar, Fishta, Çajupi, Fan Noli etj, tërhoqën vëmendjen e lexuesit. Lasgush Poradeci, vjen me poezinë lirike moderne shqiptare duke vlerësuar edhe anën estetike të veprës letrare. Ai ka arritur në nivelin e vetëdijes deri tek lexuesit e sotëm edhe pse nuk shkroi me metodën e realizmit socialist. Veprat e shkrimitarëve të Rilindjes Kombëtare (1836-1912) mbeten edhe pas 183 vitesh gjithnjë të lexueshme deri në ditët e sotme, pasi duket se e kanë arritur përfjetësimin letrar.

Letërsia e pas viteve 45 për afër gjysmë shekulli si pasqyruese e një kohe letrare ishte në shërbim të ideologjisë së realizmit socialist. Me misionin e artit "popullor", me parimin e letërsisë së partisë, në aspektin bashkëkohës, krijuesin intelektual apo të "klasës" punëtore e shtynte në dhënen e një interpretimi anësor që i shërbente dhe ishte i përshtatshëm për regjimin. Veprat e Dhimitër Shuteriqit, Ismail Kadaresë, Dritëro Agolit, e të tjerëve, edhe pse kishin afër kritikën e kohës, si reflektim që e plotësonë këtë mision, kjo letërsi nën totalitarizëm nuk do të ishte ishte e lirë. Lënda shpirtërore dhe liria e krijuesit ishin "vdekjeprurëse" në aspektin e krijimit dhe interpretimit të veprës, ashtu siç u rrënuat edhe fjala hyjnore. Ndaj kjo letërsi me përfashitëm të pak krijuesëve nuk arriti të shfaqet si letërsi përfjetësuese. Kujtjmë këtu se vepra e Kadaresë, u ekuilibrua pas suksesit universal edhe në letërsisë shqipe. Dritëro Agolli mbeti shkrimitari më original që iu qas lexuesit popullor me veprën e tij. Çështja e atëhershme mbetej të mos përulej sistemi. Jo të gjithë shkrimitarët ndoqën metodën e soçrealizmit siç ishin Jakov Xoxa, Frederik Rreshpja, Zija Çela e të tjerë, të cilët sallën

vepra me elemente realistë e ndjeshmëri moderne në poezi e prozë. Kritika letrare e kohës e shënroi këtë moment si një përshkallëzim vlerash në krijimtarinë me frysë e kohës. Regjimi me misionin e tij mundi ta gjymtonte lirinë e çdo krijuesi që nuk i shërbente historisë së monizmit. Megjithatë letërsia e realizmit socialist me prurjet në poezi e prozë duhet studuar me vëmendje për vlerat dhe antivlerat letrare, dhe jo vlerat ideologjike. Vlera përbëjnë ato vepra që lexohen edhe sot, që do të lexohen nësë dëshirat e kohës së monizmit.

Pluralizmi i ideve pas viteve 90 krijoi një letërsi ku dominoi përpjekja për të sublimuar lirinë me vepra polivalente. Shkrimitarë të njohur si Fatos Kongoli, Luljeta Lleshanaku, Ervin Hatibi, Fate Velaj e të tjerë, kanë sjellë vepra të reja ku frymon plotësisht liria e munguar, një letërsi moderne, drejt një stili individual, ku shihen vlerat estetike, liria shpirtërore, një formë e re dhe një përvojë universale.

Sot botohen libra pafund. Për fat të keq nga të ashtuquajturit "kritikë" shkruhet përgjithësisht për çdo vepër letrare, duke lënë në hipe edhe ndonjë krijues të vërtetë. Shumë pseudoshkrimtarë e kanë kthyer fushën e letrave në një duel, ku veshjes artistike dhe lëndës letrare nuk i vishet mendimi kritik dhe estetik. Hulumtimi i faktorëve sa artistikë dhe estetikë, mendimi mbi veprën apo vlerën e një libri, mjeshtëria e shprehjes artistike e të tjera, kur letërsia merr vlerën e artit, vetëm studimet letrare dhe rrjetet kritike mbeten një argumentim përbërës që çon në përfjetësinë e veprës letrare. Ndoshta do të duhet një kohë e gjatë për të evidentuar vlerat artistike dhe estetike të letërsisë së sotme që dallohet nga letërsia shqiptare e mëhershme.

KULTURA NË KOHË KRIZASH SI NË SHTETET E EJL-së

Vitet nëntëdhjetë të shekullit të kaluar shënuan përbysjen e sistemit socialist që për gjysmë shekulli kishte dominuar sidomos në disa shtete të Evropës (Evropës Juglindore), si dhe "kataklizëm kulturore" që u shfaq me këtë përbysje e që, mjerisht, po vazhdon edhe sot e kësaj dite



Nga Avni HALIMI

Kultura, ndonëse segment kryesor i identitetit etnik e shtetëror, në kohë krizash ekonomike, politike e luftarake, gjithnjë mbetet si pjesë e fundit që do të trajtohet dhe që do të çlirohet nga pasojat e këtyre krisave. Kjo periudhë e trajtimit të kulturës pas krisave të përgjithshme shoqërore di të jetë e njegullt, shumë e gjatë, e trishtë dhe traumatike për identitetin kulturor të shoqërisë.

Në periudhë krizash dhe në ato post-krizash "shpërthejnë" duke u shurmuar hulumtues e analistë që merren me krisat politike dhe ekonomik, me ngjarjet luftarake dhe me implikimet sociale, ndërsa kolapsin kulturor, përblytjen dhe njëkëmbjen e vlerave nuk e vëren askush!

Nevoja për transformimin kulturor apo përuajtjen e vlerave kulturore nga periudha paraprake, ngelë një kronikë e pambarim, një punë që do përfshirje të gjërë e të thellë të ekspertëve të ndryshëm "neutralë"!

Shtetet Baltike (Lituanja, Estonia, Letonia), Gjermania Lindore, Çekia, Slovacia dhe Polonia procesin e transformimit kulturor e patën më të lehtë, sepse nuk lejan që të dërmohen vlerat kulturore nacionale, por që u angazhuan pa hezitim në harmonizimin dhe identifikimin e sistemit të vlerave kulturore nacionale me ato të rajonit evropian perëndimore. Jo vetëm që ishte evident angazhim i nacional, por nuk munguan as rihartimet e strategjive kulturore të shteteve evropiane, të cilat i përfshinë në vlera perëndimore të gjitha ato kultura të këtyre shteteve që u përfshinë në gjirin e familjes së madhe evropiane.

Prej shteteve të tjera post-komuniste, të cilët do të përkufizohen si shtete të Evropës Juglindore, më së lehti kaloi dhe u shkëput Slovenia. Duke e tejkualuar lehtësisht modelin kulturor socialist, ajo përqafoi sistemin modern kulturor si dhe sistemin e vlerave perëndimore.

Kroacia, përgjatë transformimit politik duke u angazhuar përuajtjen e kornizën institucionale, këmbëngulli që në mënyrë radikale ta ndryshojë tërë atë koncept të

vlerave ideologjike. Këtë angazhim Kroacia e pagoi me një luftë katastrofale, e cila do ta rëndoje dhe ngadalësojë radiusin e veprimit kulturo-politik.

Rumunia dhe Bulgaria, ndonëse transformimin e kaluan pa luftëra dhe pa trazira shoqërore të theksuara, ndonëse patën përkrahje logjistike e financiare nga Evropa, megjithatë iu deshtë më se një dekadë që sistemi i tyre kulturor të rikonstruohet dhe të shënojë hapat e para drejt sistemit të vlerave kulturore perëndimore.

Serbia dhe Mali i Zi, duke pretenduar se janë vazhdimësi e një shteti që po shkatërrohen (ish-Jugosllavia), të dy republikat këmbëngullin në ruajtjen dhe vazhdimësinë e asaj frysme politike, shoqërore e kulturore të një kreaturë që ishte nën inercinë e shpërbërjes totale. Nga ana tjetër, duke e synuar epitetin e trashëgimtarëve politikë, në të dy shtetet do të instalohen një regjim i rëndë autoritar, i cili do ta provokojë edhe themelin e sistemit paralel institucional - shtetëror dhe opozitar. Opozita do të mësyjë themelin e institucioneve paralele kulturore, për të cilët do të hasë në përkrahje të fuqishme nga fondacione të shumta perëndimore, ndërsa pusheti do të mundohet ta ruajë vazhdimësinë kulturore institucionale, duke i shtuar karakterin populist me qëllim që shoqërisë opozitare t'i ngulfa sa më shumë vlerat kulturore pro-perëndimore.

Bosnia dhe Hercegovina pas një luftë të ashperë e shkatërrimitare do të përjetojë edhe një destruktivitet përgjatë ngritjes së institucioneve shtetërore përmes një protëktorati klasik. Ky destruktivitet edhe sot e kësaj ditë ka penguar hedhjen e hapave drejt ngritjes së sistemit të ri kulturor të përbashkët. Shoqëria e ndarë në tri etnritë, edhe më tej e ka të pamundur përcaktimin për një identitet kulturor për shtetin e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Makedonia, duke u angazhuar me xhelazi në ruajtjen e vlerave të sistemit të kulturor, do të propagojë ndërkombëtarisht edhe një kinse angazhim të shqiptarëve të këtushëm për "institucionë paralele" arsimore e kulturore. Prezencën e ndërkombëtarëve do ta shfrytëzojë për ta bindur

popullatën maqedonase që të antishqiptarizohet sa më shumë dhe të mos ketë frikë për ndonjë konflikt eventual ndëretnik. Kjo politikë, sa nacionaliste aq edhe shoviniste, edhe më tej mbjell frikë se themelimi i institucioneve kulturore shqiptare praktikisht do ta "federalizojë" Maqedonië e Veriut dhe, përmes këtyre qëndrimeve zyrtare, në fakt edhe më tej mbahet një krizë latente. Politikanët maqedonas tashmë e kanë ngritur në strategji nacionale faktin që për shqiptarët e Maqedonisë së Veriut nuk mund të ketë asgjë më tepër se sa përfshirja e tyre në Qeveri. Pjesëmarrja e shqiptarëve në shtetndërtim dhe në drejtëim të organeve shtetërore i obligon ata që pa faktorit ndërkombëtar të shfaqen maksimalisht si lojalistë dhe të kënaqur e të përbushur politikisht. Kërkesat e shqiptarëve për zhvillim të "jetës paralele" institucionale hidhërojnë dhe dërmtojnë maqedonasin! Kjo frikë në "zhvillimin paralel" universitar nuk ekziston më, por akoma mbahet e fuqishme në zhvillimin institucional, kulturor të shqiptarëve të këtushëm. Prandaj, bashkëjetesa në mes të maqedonasve dhe shqiptarëve është kaq e brishtë dhe për pasojë kemi dëshirat transparente maqedonase "vetëm shqiptari i vdekur është i mirë", "vdekje shqiptarëve", "dhomë gazi për shqiptarët" etj.

Kosova ishte në një situatë shumë të vështirë në krahësim me vendet e tjera të rajonit. Shqiptarët e Kosovës i njihnin shumë mirë vlerat kulturore evropiane, i njihnin edhe vlerat kulturore të popujve të tjerë të rajonit, por, nga ana tjetër, për ta përforuar identitetin kulturor, edhe më tej po vazhdonte të ndikohej nga sistemi i vlerave kulturore soc-realiste të Shtetit Arënë, bartës të të cilave ishin personalitetet të mëdha, por edhe institucionë të rëndësishme artistike. Uzurpimi i institucioneve nacionale nga kolonialistët serbe, ndikoi në zhvillimin e një sistemi paralel duke themeluar "institucionë të pavarur" kombëtare. Jo vetëm arsimi, por në mënyrë paralele u zhvillua edhe jetë kulturore, duke u themeluar teatro e produksione paralele që mbaheshin nga shqiptarët dhe nga donatorë të ndryshëm perëndimore. Në këtë

periudhë, në emr të "jetës paralele", filloj edhe shtrirja e kicit, e shundit, e tallavasë, e disa kulturave të diskutueshme dhe që nuk kishin kurrrafë pikëtakimi me identitetin kulturor shqiptar. Kjo shtrirje e dyshimtë, ndonëse përkrahej dhe sponsorizohej institucionalisht nga kolonialistët serbe, nuk ia doli që të futet si pykë dhe ta çojë në dysh trungun e identitetit kulturor shqiptar, e as të krijojë identitetë të reja brenda etnisë shqiptare.

Edhe Shqipëria e pati shumë të rëndë transformimin e gjithmbarshëm të sistemit shoqëror. Hapja pas një izolimi total gjysmëshekullor, i cili kishte shkaktuar një varféri të rëndë shoqërore, bëri që transformimi të zhvillohej në dy segmente: në atë ekonomik dhe social. Segmentet e tjera, përfshirë këtu edhe segmentin kulturor, përijetaun një degradim dhe një stagnim, një mospërfillje shtetërore. Për pasojë, vetëm në sferën e trashëgimisë kulturore institucionet nacionale u varféruan për shumë objekte të rëndësise së veçantë kulturore, për shumë relikte e objekte arkeologjike, për shumë ikona e vepra të ndryshme artistike që u vodhën, ju shkatërruan, u tahuajesuan e u shitën jashtë. Ndaluani shumë manifestime e festivale, të rejaq që u krijuan më tepër ishin angazhime individuale se sa institucionale. Strategjiet nacionale për zhvillim kulturor më tepër ishin partiale se sa shtetërore e kombëtare. Politikat kulturore nuk po vëreheshin askund! Trazirat puçtë të vitit 1997 gjithçka sollën në zgrip të ekzistencës. Shteti u rilind porë asesi t'i gjej fillet e një strategjie kombëtare për zhvillim institucional kulturor.

Pa dyshim, politikat kulturore nuk i munogen vetëm shtetit shqiptar, porë ato nuk shiheshin në asnjë shtet të rajonit, përjashto këtu ato politika kulturore që zhvillohen nën nga individë, shqiptarët e asociacione të pavarura kulturore.

Kjo situatë do të nis të ndryshojë sidornos pas vitit 2000, kur do të fillojë një bashkëpunim më i njësuar kulturor në mes të shteteve të EJL-së. Ky bashkëpunim nuk do të ndodhë si interesim shtetëror përsista bilaterale kulturore porë do të ndjehet nga shtytjet e jashtme, nga Këshilli i Evropës, nga Unioni Evropian, nga Kombet e Bashkuara (UNESCO), nga SHBA dhe nga fondonet dhe fondet institucionale të shteteve të ndryshme evropiane. U krijuan programe të reja, skema dhe platforma si Pakti i Stabilitetit, të cilat kërkon organizime të përbashkëta rajonale, por dërrjetëzime të asociacioneve dhe institucioneve kulturore dëj jo vetëm!

Në të njëjtin mënyrë vepruan edhe shumë organizata dhe fondacione, si për shembull, rrjeti i Fondacionit Soros, Pro Helvetia, Kontakti Kulturor, Fondacioni Kulturor i Evropës që zhvillon platforma në cilën përkrahen iniciativa të ndryshme në shtetet e Evropës Juglindore.

Ndarja e re e shteteve të tranzicion të EJL-së, në Ballkanin Lindor (Bulgaria, Rumania, Moldavia) si dhe në Ballkanin Perëndimor (shtetet e dala nga ish-Jugosllavia) me Shqipërinë (por pa Sloveninë), edhe pse shkaktoi më shumë probleme se sa që i zgjidhi ato, megjithatë solli deri te një konstatim: stabilizimi i rajonit nuk është i mundshëm përderisa shtetet e dala nga shpërbëria e ish-Jugosllavisë nuk do të krijojnë marrëdhënie të ndërsjellë, bazuar në bashkëpunim të barabartë si dhe në bashkëpunim që mbështetet në interes, sidornos në sferën e kulturore dëj artit.

Intervistë: Qëndrim Rijani, regjisori

TEATËR – BËRËSIT LEHTË MUND TË SHNDËRROHEN NË SUBJEKTE QË I “VRET” KOHA!

Na duhen laboratorë teatrorë të mundësuara nga teatrot tona, të cilat do të na ndihmojnë - mësojnë neve regjisoreve dhe trupave teatrorë, të arrijmë që dramaturgjinë kombëtarë e cila ka bërë histori ndër vite, ta risjellim në forma të reja estetike teatrorë. Kjo është një ndër nevojat më thelbësore

Avni HALIMI

Qëndrim Rijani u lind më 30 mars 1990 në qytetin e Kërçovës. Shkollimin fillorë dhe të mesëm i ka kryer në vendlinjde. Është diplomuar në degën e Regjisë së Teatrit në Universitetin e Arteve në Tiranë, me notë mesatare 9.11. Në po të njëjtë Universitet ka kryer edhe studimet master - dega: Regji teatri dhe spektakli, me temë të mbrojtur: "Kitchi dhe kthethet e tij" dhe notë mesatare 9.45. Gjithashtu ka qenë pjesë e disa specializimeve me karakter workshopi dhe është prezantuar me shfaqjet e tij në festivalë me karakter ndërkombëtar, si në Rusi, Turqi, Bosnjë, Zvicër, Kosovë, Shqipëri, Maqedoni, Serbi etj. Aktualisht është regjisori i shtëpisë në Teatrin Shqiptar si dhe pedagog i ftuar në Universitetin e Arteve Tiranë ku ligjeron lëndën e Mjeshtërisë së Aktorit dhe pedagog i ftuar në Universitetin e Tetovës ku ligjeron lëndën e Regjisë së Teatrit.

Deri më tani ka realizuar një film dokumentar, një operë dhe njëzotetë shfaqje profesionale në Shqipëri, Maqedoni e Veriut dhe Kosovë. **Këto shfaqje janë vlerësuar me mbi pesëdhjetë çmime, dymbëdhjetë prej të cilave për regji...**

HEJZA: I nderuar Qëndrim, Teatri Shqiptar i Shkupit, siqë është bërë publike, aktualisht punon në realizimin e tri dramave të autorëve të huaj (njëra tashmë e ka pasur premierën, shënëm yni). Kemi apo nuk kemi autorë shqiptarë nga Maqedonia e Veriut që shkruan një drama. Gjithnjë sipas Jush, pse kjo tendencë e mohimit këmbëngulës të autorëve shqiptarë?

Q. RIJANI: Edhe pse unë i përkas krijimtarisë së viteve të fundit të teatrit shqiptar, mund të them me plot gojë që ky teatër në historikun tij brenda vetes ka një numër të begatë të dramave kombëtarë, apo më saktë të autorëve shqiptar. Mbështet më shumë të lëvróhet veprat dramaturgjike apo letrare e autorëve të ndryshëm shqiptar dhe të ketë ilaritet. Besoj që mendimtim më të zgjeruar përkëtë do ta gjeni një përgjigjet e pyetjeve që më keni bërë më poshtë mbi dramaturgjinë, të cilat përfshijnë rreth 60 për qind të intervistës.

HEJZA: Teatrot tona kombëtarë, meqenëse shumë më tepër parapëlqen katarsisin që vjen nga motivet e huaja se sa këtë shpëllarë shpirtërore të arrjnë duke trajtuar tema originale, nga historia, folklori, mitologjia, por edhe nga e përditshmja jonë, sikur kanë ngelur pa identitet kohëve të fundit! A kemi teatër shqiptar sot, jo si objekt, por si art?

Q. RIJANI: Po kemi! Me shumë nevoja përmirësim... Por, kemi! Si regjisori i operës së parë shqiptare në historinë e institucionit të TEATRIT të Operës Nationale të RMV, operë e cila që nga shkronja e parë e libretit deri në shkronjën e fundit, që nga nota e parë deri në të fundit, që nga temat koreografike, motivet në kostume dhe estetika regjisoriale - është thllësish kombëtarë. Si regjisori i një



vepre dramaturgjike me autor shqiptar, katër veprave me ko-dramaturg dhe me mbi 20 vepra teatrale me autor të te huaj, por me kontekstualizim estetik-regjisorial në vendet ku i kam vënë, me shumë përgjegjësi mund të them se vlerën kombëtarë nuk e përcaktojnë vetëm emrat i art-bërësve të atij produkti artistik. Teatri është universal dhe kombëtar, pikërisht sepse produkti është ai i cili formëson një identitet si dhe emocioni ai që krijon motiv katarse! Në të gjitha veprat universale botërore të arrira, brenda tyre gjendet kontekstualizimi kombëtar i të gjitha teatrove ku ata mund të vihen në skenë. Kështu që vepra e punuar mirë artistikisht merr formë kombëtarë nga niveli i arrirë artistik me të cilin shfaqet!

HEJZA: Në fakt, i nderuar Qëndrim, me që dihet se në teatrot shqiptare (në Maqedoninë e Veriut) nuk funksionojnë këshillat artistike, atëherë shtrohet pyetja: kush vendos se cilat shfaqje do të realizohen, ndonëse prej kohësh dihet se ka individë që ushtrojnë ndikimin e tyre në këto teatro, thjeshtë për qëndrime personale. A duhet të ndryshohet diçt në këtë drejtim?

Q. RIJANI: Këshilli artistik është një akt-funksionimi teatror, i cili në ligjin përkulturë të shtetit tonë nuk parashihet si "organ" vendim-marrës. Kështu, mungesa e këshillave artistike mund të shihet si lëshim ligjor. Pa dashur të amnistoj përgjegjësinë e institacioneve kulturore: Ligji përkulturë në vendin tonë ka një gropë të

madhe funksionale apo krijon mundësi ose detyrime për disfunksionalitet.

Është një komision që ka ingerencia mbi krijimin e repertoreve, i cili formohet në ministri. Ky komision zotëron mundësinë ligjore për të vendosur mbi projekte artistike, i jetet mundësia që të bëjë këtë proces duke krasuar projektet teatrorë të institacioneve kulturore me të shoqatave joqeveritare apo individëve-vetëkonkurues. Ky komision vendsos për vlerën artistike dhe koston ekonomik të projekteve. Përmua kjo formë krasahuese -funksionimi lë shumë për të dëshiruar. Kjo mënyrë funksionimi krijon probleme efektiviteti dhe mundësi justifikimi për gjithçka që nuk shkon mirë në procesin e ndërtim-krijimi të një produkti artistik.

Përvjona ime personale në teatrot tona ka kaluar përmes aplikimit të projekteve artistike, bazuar në arsyetimet e platformës regjisoriale dhe arsyetimeve përmundësítet e teatrove. Patjetër që regjisori është një pjesë më të madhe autoritative mbi projektet që propozohen kudo. Por, në fund është ai komisioni që kur duhet të bëjë dallime, nuk bën dhe kur duhet të bëjë, bën.

Bazuar në përvjorat e vendeve përreth besoj që funksionalizimi i këshillave artistike duhet të bëhet duke Ju atashuar institacioneve artistike të gjitha kompetencat vendimmarrëse artistike dhe financiare. Kjo në rastin më të mirë do të krijojë fleksibilitet funksional. Në rastin më të keq, do të nxjerrë në pah përgjegjësitë e mosfunkcionimit dhe mosarritjes së vlerave artistike.

HEJZA: Viteve të fundit keni dëshmuar se jeni një nga regjisoret më produktiv gjithandje hapësirave shqiptare. Janë dëgjuar disa pëshpëritje (nga gojëkëqijë e teatrove tona) se Ju jeni i "preferuari" i partisë në pushtet, sepse jeni kërçovar, sepse drejtori i Dramës Shqiptare është kërçovar, sepse lideri i partisë në pushtet është kërçovar e kështu me radhë. Pra, ja deri ku shkon imagjinata perfide...

Q. RIJANI: Në kohë që ne po bëjmë këtë intervistë, aktiviteti im artistik si në produksione ashtu edhe në pjesëmarrje në festivalë, vlerësime etj. është më i madh në zhvillim dhe në numër jashtë Republikës së Maqedonisë së Veriut, krasuar me aktivitetin tim të zhvilluar brenda shtetit! Mund të them që janë ndoshta regjisori i vetëm shqiptar i "pell-gut" tonë në këtë shtet, që mundësia e parë për punë në teatër kombëtar, nuk më është dhënë në Teatrin Kombëtar Shqiptar. Projektin tim të parë në Teatrin Shqiptar si regjisori në ndërtim e kam fituar pasi kisha bërë produkte në teatro tjetër, përfshiri këtu Teatrin Kombëtar - Tiranë. Kujdesi mbështet që kjo është dashur të ndjek, të konfirmoheshë paraprakisht e më pas të meritoj mundësinë e parë, suksesi i produktit të parë ka sjellë të dytin, suksesi i të dytit të tretin, kështu pas 3 produktive në 8 vite dhe 8 vite pas diplomimit në Tiranë, u bëra pjesë e këtij teatri dhe bëra produktin e katërt "Tri motrat", të cilin kritika shqiptare dhe maqedonase e ka vlerësuar si mjaft apo një ndër më të suksesshmit e dekadës së fundit në vend! Puna ime regjisoriale, puna janë e përbashkët me trupat dhe teatrot shqiptare dhe jo-shqiptare në të cilat kam punuar, është vlerësuar në festivalë të ndryshme nga njerëz me meritë të mëdha në fushën e artit. Individë të dëshmuar në personalitetin e tyre njerëzor dhe krijues, të cilët mbështet që kjo është dashur të ndjek, të krijojë këtë gjithashtu do doja të ishin nga Kërçova! Premierat dhe shfaqjet në regjinë time janë ndjekur nga personalitetet të ndryshme politike: presidentë, kryeministra, ministra etj - shqiptar dhe jo-shqiptar, në Shqipëri e Kosovë, në shtetin tonë apo në Festivalë relevante ndërkombëtare jashtë shtetit tonë, ku gjithashtu të njëjtët nuk kanë qenë nga Kërçova. Nuk e di nëse do të isha i lumtur që të gjithë këta të ishin nga Kërçova! Më e rëndësishmja: Të gjithë bashkëpunëtorët e mi, aktorët me të cilët kemi arritur sukseset e përbashkëta jo vetëm një herë dhe jemi ndarë me dëshirë për të na takuar projekte të radhës. Trupa të cilat me vullnet më kanë kërkuar për të punuar bashkë për të dytën apo të tretën herë. Do doja mbështet që këtë gjithë nga Kërçova...! Nga dita që jam diplomuar nuk kam asnjë aktivitet tjetër përvjeç punës në teatër dhe punës mbi teatrin në universitet me studentët. Në punën time regjisore Ju mund të shihni një mori autorësh disident të kohës së tyre,



gjithashtu një mori veprash të cilat brenda vetes kanë kritikë të fuqishme politike. Nuk kam pasur asnjë funksion apo detyrë politike deri më sot. Kjo përgjigje nuk ishte për gojë-ligët, por për të sinqertët të cilët akoma nuk kanë parë punën time dhe mund të bëjnë prej e gojë-ligëve, përparrë se të shohin ndonjë shfaqje në regjinë time!

HEJZA: A mund të ngritet identiteti i teatrit tonë duke e mbështjellë me tradita, mentalitet, histori e ngjarje të huaja? Cilat tema shqiptare do të ishin në fokusin e politikave të teatrove të huaj!

Q. RIJANI: Teatri ka lindur si nevojë edukimi. Varësishet prej nivelit të vetëdijes mbi nevojën për pasurim shpirtëror te populli ashtu ka hapëruar sofistikimi i nivelit artistik të teatrit te popujt e ndryshëm. Më vonë te kombet e ndryshme, të cilët e njohin përmënyrë edukimi shpirtëror artin skenik. Fillesat i pati në veprimin skenik që buronte nga ngjarjet popullore, atëherë kur akoma termi komb nuk ekzistonte. Kombëtarizimi i teatrit erdhë si pasojë e krijimit të identiteteve popullore, por asesi si nevojë për konservim të artit skenik në temat popullore. Kjo bën që temat apo ngjarjet tona popullore të janë interesante nëse kontekstualizohen në skenat e huaja dhe anasjelltas.

HEJZA: Çfarë po ndodhë me publikun? Dikur një shfaqje përsëritez me dhjetëra e dhjetëra herë! Sot kemi më pak publik teatr-dashës, apo do t'ia lëmë fajin mediane elektronike që teatrin, por dhe kinemanë po na e sjellin në dhomë! Cili është sot perceptimi i të rinjve për teatrin! Cili është angazhimi i shkollave tona për dramaturginë shqiptare?

Q. RIJANI: Kohët e fundit po shoh një lloj shprese te disa gazetarë e udhëheqëse emisionesh. Revista elektronike të cilat në qendër kanë letërsinë dhe artin. Por, nëse krahasojmë interesimin e mediave

për aktivitetet artistike shqiptare në shtetin tonë, me interesimin e mediave në shtetet fqinje: Shqipëri apo Kosovë, madje edhe nëse do të bënim krahasim me interesimin e mediave të sferës artistike maqedonase për aktivitetet artistike të tyre, puna e mediave tona është tmerësht modeste. Duam - s'duam ta pranojmë, fuqia e medias për të dërguar informacionin te publiku në këtë kohë është aq e madhe sa mund të jetë një ndihmë e madhe për artin. Puna jone individuale për të dërguar informacionin te publiku, gjithashtu është mbaze tepër modeste. Sikur edhe ne si art-bërës presim që "dikush" të vijë dhe ta ndjekë punën tonë, pa e marrë vesh "Ai" që ne po bëjmë diçka! Për hir të së vërtetës duhet theksuar se shqetësim global është kriza për publik, apo kriza e ndjekësit. Kjo krizë ka kapluar qdo fushë të artit dhe kulturës: artin pamor, teatrot, e më rëndë edhe atë që quhet arti historik: muzetë apo objektit e trashëgimisë kulturore. Mbaze rendi i ri botëror po krijon modelin e ri elitar. Megjithatë, ne nuk duhet të rrimë duarkryq. Arti-teatri gjithmonë ka dëshmuar se ka ditur të gllabërojë të "renë" brenda vetes dhe ta rishfaqë si model për njeriun e kohës së re, duke e mishëruar me "heroizmin" e kohës së vjetër. Gjithashtu lënda e teatrit është domosdoshmëri të bëhet pjese e shkolimit të mesëm. Jemi vendi i fundit që nuk e kemi një lëndë kaq të rëndësishme si pjesë të kurikulës në shkollën e mesme, lëndë e cila është tepër e nevojshme për nxënësin e kohës së "teorisë së komunitimit", si në aftësimin e tij mbi teatrin, artin, krijimin e vetëbesimit, por edhe në aftësimin e tij në aspektin e oratorisë si individ i shekullit të ri!

HEJZA: Çfarë drame origjinale i duhet teatrove tona, publikut, lexuesit! Si të tejkaloher profili socialist i teatrove tona, si mos ta dëmtojmë motivin e realizmit magjik, si mos ta bastardojmë teatrin absurd..?

Q. RIJANI: Në këndvështrimin tim çdo produkt i arrirë artistik bëhet vepër origjinale e jona. Një produkt të mirë artistik teatror, fryma e gjallë e atyre që e bëjnë - lindin dhe i jasin shpirt në skenë, e bën original për ndjekësin. Deri në momentin që i njëjtë produkt vdes. Madje, "vdekja" mund të jetë aspekti që e bën teatrin, të kohëshëm dhe të pakohë. Magjik dhe në të njëjtën kohë absurd.

HEJZA: Kemi breza të mirë aktorësh! Kemi shumë pak dramaturgë të njohur e aq më pak regjisori! Pse?

Q. RIJANI: Kemi breza të mirë aktorësh, por kemi nevojë për akoma më shumë! Kemi pak dramaturgë, sepse mbaze nuk shihet nga të rinjtë si degë me perspektivë në aspektin ekonomik. Të jesh dramaturg, së pari duhet të pajtohesh që do të paguhesh për punën e bërë "Pas vdekjes".

Para 8 viteve kur hapëm degën e regjise së teatrit në gjuhën shqipe, ishim vetëm 3-4 regjisori teatri shqiptar aktiv në shtetin tonë. Tani jemi 9-10. Koha dhe puna dikë tanimë e ka verifikuar, të tjerë presin radhën me punë!

HEJZA: Çka duhet të bëjmë që të kemi një teatr-kombëtar të konkurruehëm me teatrot e rajonit, të Evropës dhe më gjërë?

Q. RIJANI: Do përpinqem ta shoh në një këndvështrim optimist, por me argumente, pozitën në të cilën ka arritur të jetë sot arti skenik. Kemi shumë probleme dhe nevojë përmirësimë, e reja shpesh herë na mbërthen e copëzuar, sepse e përqafojmë pa u çliruar nga e vjetra. Por, nëse vërtetë ky shtet është përbalur dhe ka diçka me të cilën mund të përballet denjësht në rajon dhe më gjërë është arti. Mbaze nuk fitojmë, por jemi konkurrent të denjë krahasuar me të gjitha fushat tjera, si: shkenca, arsimi, shëndetësia, drejtësia, turizmi etj. Arti është fusha e cila këtij vendi i mundëson të kalojë kufijtë pa frikën e "vetos".

Artistët janë ata të cilët këtë vend e përfaqësojnë denjësht ne rajon dhe më gjérë, ndoshta nuk kthehen fitues gjithmonë, por as nuk kanë frikë se do të shpalen "nongrata" nga kompeticionet në të cilat me dinjitet e kanë përfaqësuar dhe e përfaqësojnë këtë vend.

HEJZA: Kritika teatrale? Në botë, çdo teatër ka të angazhuar profesionalisht kritikët e vet! Te ne, kush po i zbrerthen problemet teatrale, shfaqjet, mbarëshëtimet regjisoriale, që nga koncepti, mizanskena e deri te loja e aktorëve?

Q. RIJANI: Për këtë nuk kam njohuri të mbështetur në përvojën time, jam pak i pasigurt. Besoj që kritika dhe kritikët duhet të janë "institucion" i pavarur kulturor, i mbështetur nga institucionet kulturore. Njerëz të dëshmuar në veprimtarinë-biografinë e tyre, të cilët dinë saktë zbulojnë apo të diagnostikojnë problemet apo hilet në produktet artistike dhe aq të përbushur, sa të evidentojnë dhe theksojnë zëshëm vlerat e po të njëjtëve produkte!

HEJZA: Si e shikoni fatin e dramës si tekste letarë! Drama shqiptare, si botim, si libër i botuar, nuk merret parasysh nga teatrot tona "kombëtar", nuk përfillet nga botuesit tanë! Letërsia bashkëkohore gjithnjë e më shumë po na del më e varfër për sa i përket këtij lloji letar, kurse askush nuk brengoset për këtë mjerim!

Q. RIJANI: Letërsia - libri i botuar po pëson sulmin më "atomik" në kohën e sotme të teknologjisë dhe individit të shekullit të "gjysmë-dijes". Libri është kthyer në metodën e fundit që përdorim për të dalë nga balta pasi jemi fundosur deri në grykë, në vend që të jetë udhëzuesi që do të na mësojë të mos ecim në baltë. Megjithatë, mjetet e shpëtimit janë ata që nuk vdesin kurrë edhe pse lihen të fundit për tu përdorur. Dramaturgia është fusha më e vështirë e letërsisë. Historia e teatrit numëron më shumë se dy mijë vite

dhe ne sot nuk mund të numërojmë më shumë se 200-300 autorë-dramaturg që i kanë rezistuar të gjitha kohërave. Madje, edhe popujt e mëdhenj me miliona banorë, kanë mungesë autorësh-dramaturg në historinë e tyre letrare! Sot që po flasim, dramaturgjia vërtetë është kurikulë tepër e rëndësishme e shkollave botërore të artit. Aq më tepër, në një botë me 8 miliardë banorë, numërohen me numër treshiforë dramaturgët të cilëve më shumë se një tekst dramaturgjik ka arritur ta kapërcejë eksperimentin apo katarsën teatrale dhe iu është kthyer i njëjtë tekst në vepër dramaturgjike. Dramaturgu i vërtetë është: "Modeli i kohëve moderne dhe heroji i kohëve të shkuara"!

HEJZA: Meqë teatrot tonë, fatkeqësisht, janë të prira që të kafen me tekste të autorëve të huaj, sikur po e hedhim në harresë tërë atë repertori të begatë që e kemi, në veçanti Teatri Shqiptar i Shkupit. Në botë, teatrot me renome, mund edhe të përgatisin ndonjë premierë sa përfaqësimi nëpër teatro të ndryshëm, por ama nga dramaturgjia kombëtare dhe nga repartori që e llogarisin si vlerë të jashtëzakonshme, nuk heqin dorë! Me këtë e ruajnë të gjallë frymën origjinale të identitetit të teatrit, por edhe kondicionin artistik të tërë stafit aktorial që e kanë të angazhuar. Cili është mendimi i Juaj?

Q. RUANI: Mendoj që teatrot tonë shqiptare assesi nuk kanë mundësi të vazhdonjnë me intensitetin e veprës shqiptare në vrullin e kohës së më hershme, jo përfshirë nga mos-dëshira, por sepse artisti i kohës së sotëm në vrullin e tij të dëshirës përfshirë, kërkon atë që është e verifikuar. Nuk po them që çdo vepër e huaj apo komedi "limonadë" që shpesh herë vendosim në skenë e teatrove tona, është zgjidhje e duhur, madje...përkundrazi! Por, shpejtësia me të cilën vjen informacioni në kohën e teknologjisë, arrin të depërtojë edhe në shijen estetike të artistit të kohës. Estetika teatrale realisht po ecën me hapa ekstremisht të shpejta drejt formave të reja. Që mbështetet jo gjithmonë janë më të mirat, por duhet ta pranojmë që edhe vetë teatrot më konservatorë në estetikën e tyre, bëjnë hapa të shpejta drejt estetikës së re. Mbështetet edhe përfshirë vetë ne regjisoret, një gjysmë hapi i sigurt është dramaturgia e konfirmuar.

HEJZA: Si do të dukej skena teatrale që do të paraqiste situata kombëtare nga realiteti dhe përditshmëria jonë? Si ta bëjmë të dobishëm këtë skenë përfshirë auditoriumin tonë? Ku është kufiri në mes të katarsisë dhe iritimit, zhgënjosjes, arratisjes nga identiteti...

Q. RUANI: Na duhen më shumë dramaturgë shqiptarë të dalë nga universitetet, të cilët përvèç talentit dhe dellit të tyre krijues, në shkollë pajisen me leksionet mbi strukturimin e dialogut dramaturgjik, të cilët do të na ofrojnë skenarin dhe dramaturgjinë identitare, konkurruese me rajonin. Sot në botë nuk ka shkollë përfshirë poet apo përfshirë mësuar si shkruhet romani. Fusha në të cilat Ne shqiptarët si popull i vogël kemi vërtetë figura të mëdha, të cilat frymën tonë identitare e kanë bërë të përbotshme. Na duhen laboratorë teatrale të mundësuara nga teatrot tona, të cilat do të na ndihmojnë - mësojnë neve regjisoreve dhe trupave teatrale, të arrijnë që dramaturgjinë kombëtare e cila ka bërë histori ndërmjet viteve, ta risjellim në forma të reja estetike teatrale. Kjo mendoj është një ndër nevojat më thelbësore. Të gjithë së bashku: autorë, regjisore, aktorë, përfshirë edhe skenografët, kostumografët, koreografët, kompozitorët, elementet e formës, duke filluar nga mjeshtrit e ndriçimit etj., duhet të mos rreshtim së kërkuar, përditësuar dhe përmirësuar veten. Teatri është i gjithëkohshëm, por teatër-bërësit shpesh dhe lehtë mund të shndërrohen në subjekte që i "vret" koha!



HUMORI DHE MARRËZIA

Humori është ilaci më i fortë kundër diktaturës. Inkuizicioni, si dhe shumë inkuizitorë të mëvonshëm e kanë ditur se humor i rrezikon seriozitetin e diktaturës së tyre, prandaj kanë shpikur ndalesa, censura, mekanizma të ndryshëm për ta çrrënjosur atë

Arbën XHAFERI

Me siguri, sensi për humor e ka shtyrë Erazmo Roterdamin (1466-1536) ta shkruajë traktatin e tij të farmshëm, "Lavdi marrëzisë" (1509). Humori dhe marrëzia janë anët e ndryshme të një medaljeje, të cilat shpeshherë e shpëtojnë njeriun nga kotesia, vegjetimi, depresioni, dhuna, autoriteti, pse jo edhe nga diktatura. Shkrimitari i madh Umberto Eko, në romanin e tij "Emri i trëndafilit" në esencë bën fjalë për shpëtimin nga duart e inkuizionit, të ekzemplarit të fundit të një traktati antik për humorin, duke na zbuluar kështu një të vërtetë të madhe: aty ku ka humor nuk ka regjim autoritar, nuk ka diktaturë. Humori është zonë e lirisë.

Humori është ilaci më i fortë kundër diktaturës. Inkuizicioni, si dhe shumë inkuizitorë të mëvonshëm e kanë ditur se humor i rrezikon seriozitetin e diktaturës së tyre, prandaj kanë shpikur ndalesa, censura, mekanizma të ndryshëm për ta çrrënjosur atë. Mirëpo, edhe në këto kushte krijuesit kanë gjetur forma të ndryshme të shprehjes: ironinë, aluzionin, metaforën, etj për ta shprehur mospajtirin. Filozofi i madh holandez Peter Sloterdijk flet për funksionin e cinizmit dhe të kinizmit në rrënimin e gjenjeshtrave të paraqitura si të vërteta të mëdha në shumë fusha, në religion, politikë, mjekësi, seks etj, ndërkaq para tij Kanti dhe Lesingu e vrissnin mendjen se si ta përkufizojnë humorin. Më në fund arritën ta shpagojnë burimin e humorit. Sipas tyre humori buron nga e papritura. Bie fjalë, pret që dikush të jetë serioz dhe nëse ai bën gjestikulime joserioze, atëherë nis humori. Ose pret që dikush të ecë



normalisht, mirëpo ai papritur rrëshqet mbi lëkurën e bananes dhe njerëzit në vend që t'i jepin ndihmë, gajasen se qeshuri.

Mirëpo, ky humor është elementar dhe dallon shumë nga humor i thellë që ka mision filozofik në shoqëri: humori që e konteston autoritetin. Ai është arma e fundit dhe mbasë më e forta për t'u mbrojtur nga autoritetet dhe gjenjeshrat. Të nënshtruarit, të përbuzurit shpeshherë me humor, ironi, kanë ruajtur dhe zbuluar lirinë në vete.

Shpeshherë nga kureshtja, apo të prirur nga motive intelektuale kërkohet të zbulohet dallimi në mes të mendësisë aktuale të shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre të shqiptarëve të ish-Jugosllavisë. Varësisht nga qëllimi zbulohen relacione

të natyrave të ndryshme. Me këtë rast, unë e shoh të udhës të analizoj orientimet që ndikojnë në formimin e vetëdijes, mendësisë së veçantë.

Shqiptarët e Shqipërisë janë të orientuar drejt Perëndimit, më së shumti në drejtim të Italisë. Ata i pranojnë ndikimet nga ky vend, nga kjo kulturë në shumë sfera të jetës, që nga vokabulari e deri te llojet e emisioneve televizive. Ata janë shumë pak të orientuar nga lindja, kështu që informacionet e tyre për këto mjedise janë sa sipërfaqësore aq edhe naive. Ndodh që shpeshherë shqiptarët e Maqedonisë ndihen të fyer kur i thërrasin maqedonas. Mbështetet e shumë femra shkodrane, siç shkruajnë gazetat janë martuar me maqedonas duke pandehur se ata janë njëlloj si shqiptarët. Këtë

mosnjohje, ato e kanë paguar me çmim të lartë, me vuajtje që nuk i kanë imajjinuar as në ndërrë.

Ndërkaq, shqiptarët e ish-Jugosllavisë, deshën ata apo jo, janë të orientuar nga bota sllave, duke marrë prej tyre në mënyrë të pavetëdijshme, qoftë huazime gjuhësore, apo modele të ndryshme të sjelljes shoqërore. Mirëpo, detyrimi i të jetuarit bashkë me sllavët bëri që shqiptarët e këtyre viseve t'i njojin mirë sjelljet, veset si dhe aftësitë e tyre. Në këtë mënyrë shqiptarët janë bërë njojës të mirë të psikologjisë, të të mirave, të të ligave si dhe të aftësive apo të dobësive të tyre.

Shqiptarët e ish-Jugosllavisë nuk i mistifikojnë sllavët e jugut, por për shkak të një armiqësie të vazhdueshme, me të drejtë apo me të padrejtë i nënçmojnë ata. Ndodh që shpeshherë t'i trajtojnë me humor. Ky sens i humorit u ka dhënë forcë atyre që t'i jepin fund superioritetit të autoriteteve represive sllave që merrnin haraq rregullisht nga ata. Njëkohësisht, përmes humorit ata u pajisën me një tipar të ri që e karakterizon mendësinë e tyre: arrogancën mospërfillëse. Në këtë mes ekziston edhe një element shumë i rëndësishëm. Këtë e analizon mirë shkrimit Çeslav Milosha në veprën e tij "Mendje e robëruar". Ai konstaton se kulturat lindore nuk janë kreative dhe kopjojnë rregullisht atë që prodhon Perëndimi. Qytetërimi i tyre është surrogat i qytetërimit perëndimor. Së këndejmi shqiptarët e ish-Jugosllavisë kanë qenë të rrezikuar të janë surrogat të surrogatit, kopje e kopjës. Mirëpo humor, trajtesa shpërfillëse e pushtuesve ka qenë terapija më efikase për të shpëtar nga krezik, për ta ruajtur lirinë në vete.

Vitrina e librit

PANTEONI I RRALLUAR

Dashnor KOKONOZI


Ndihem me fat që disa libra i kam lexuar në kohën e duhur. Më saktë në moshën e duhur, se është shumë e rëndësishme mosha kur i lexon. Një libër ku për letërsinë shkruhej pa qene nevoja të citoje Marksin apo E. Hoxhën! Një prej tyre është "Panteoni i rralluar" i Rexhep Qoses. Ka qenë libri i parë i shkruar nga një studiu shqiptar që më ka vlefjtur e shenjur për jetë, ku lexoja gjëra të cilave u besoja e më tërhiqin.

Munda ta siguroj aty nga mesi i viteve '80 dhe nuk e hijja nga dora. Natyrisht, fshehu razi se një botim i Kosovës (pra, i pa kontrolluar nga aparati gjigant i censurës politike në Tiranë, do të qe i mjaftueshëm për gjérat më të këqija që mund t'i ndodhnin dikujt). Një libër i


shkruar me mjaft thjeshtësi e thellësi!

Ka në të jo vetëm sprova të vogla për tipare e anë të ndryshme të letërsisë (nja shtatë, më duket), por edhe vështrime kritike mbi vepra dhe autorë të ndryshëm. Është edhe ajo eseja ku Kadarenë ai e cilëson si gjeneral në vepren e tij artistike por si kolonel në vështrimet kritike (në se e mbaj mend i referohet një shpërthimi thuajse pangjirik të Kadaresë për Migjenin). Duket aty ka hedhur rrënje edhe dashuria e tyre e madhe për njëri-tjetrin.

Kam përshtypjen se prof. Qosja këtë libër e kishte shkruar me mjaft kënaqësi dhe lehtësi. Se kjo ndihej në çdo gjë që thotë. E kutoj këtë sepse më pas kam lexuar të gjithë korpusin e veprale të tij, atyre të cilave ai u ka kushtuar jetën, e megjithatë, asgjë që ka dalë me tej nga dora e tij nuk më ka pëlqyer sa ky libër.



AUTORËT SERB PËR SHQIPTARËT E NISHIT DHE TOPLICËS



Libri "Çfarë shkruanin autorët serbë përpara 100 vitesh për shqiptarët e Nishit dhe Toplicës" është përmblledhje me tregime e fragmente të udhëpërskruesve. Në të është përfshirë edhe një vështrim sesi janë parë shqiptarët, prej një oficeri serb në vitet e pas Kongresit të

Berlinit, pra në kohën e turbulencave të mëdha sidomos të periudhës së vendosjes së kufijve të ri në Ballkanin e atëhershëm. Në tregimet e paraqitura të autorëve serbë si: Manoillo Gj. Prizrenac "Përtëj kufirit", Nikola Gjorq "Nishliu" – "Bulla", është trajtuar fenomeni i turqizimit, gjë

që autorët Prizrenac dhe Gjorq në krijimet e tyre janë përpjekur që protagonist kryesore, Fatimen nga Rahovica e Preshevës dhe Zylejkën e lindur në Beograd, por të débuar në qytetin e Leskocit, t'i kthejnë në rrënjet e dikurshme, pra të gjysheve të tyre që ishin serbe të islamizuar. Pra, sipas tyre procesit të kthimit në origjinën e mëparshme duhej t'i nënshtroheshin turqit, poturët apo të turqizuarit, por edhe shqiptarët ose arnautët – të njojur nga një pjesë e autorëve serbë të fund-shekullit të XIX – të, si arnautashë të cilët pas Kongresit të Berlinit vazhduan të jetonin në vatrat e tyre që tani iu dhanë Principatës së Serbisë.

Tregimi i radhës që po ashtu është në fryshtë e dy të lartpërmendurve, është edhe ai i autorit Ilija V. Vukčeviq "Kufitarët" ku autori nëpërmes peizazheve të afrore, sikur e bën të ditur se tani pas vendosjes së kufijve të ri, gjithçka duhet të rreshtohet në anën e fitimtarëve. Madje edhe femrat "armike" duhet t'i braktisin bashkëshortët e mëparshëm për të rënë në përqafim të "heronjëve" të rinj.

Të gjitha tregimet e lartpërmendura sikurse e kanë të njëjtin vizion dhe qëllim, pra që shqiptarët mysliman t'i paraqesin si oriental që për nga përkatësia e tyre kombëtare dhe fetare, paraqesin përjashtim në Europën e fundit të shekullit të XIX dhe se ata do të janë rezik për Ballkanin e së nesërmes, pra në Ballkanin e uesternizuar. Natyrish se një imazhi i tillë i shqiptarëve dhe stereotipat përcjellëse për ata, kanë ndikuar në rritjen e urrejtjes dhe mosdurimit, gjë që efektet e kësaj qasje janë dëshmuar sidomos në luftërat e viteve 1877 – 1912. Bile dëshmitë më të mira për këtë të sjella në këtë libër, janë ato të Mita Rakiqit, ku ai e ka paraqitur gjendjen në fshatrat shqiptare të djegura e të shkatërruara nga ana e ushtrisë serbe në vitet 1877 – 1878.

Krijimi më i plotë letrar në këtë libër mbetet poezia e Vojislav Iliqit "Shqiptarja" dhe vështrimi i Aleksa B. Bogosavljevit "Për shqiptarët" edhe pse ky i fundit herë pas here e merr guxmin dhe i shpalos edhe anët e errëta të planeve që duhet zbatuar në raportet finqnjësore serb – shqiptar. Megjithatë, përmblledhje apo manifestim të antishqiptarizmit jo vetëm në kohën e shkrimit të tregimit, por mund të themi edhe në tërë periudhën 1878 – 1999, paraqet tregimi i Velko Petroviqit, "Sefer Lushi". Në këtë tregim mund të gjenden gjurmë të qasjes, raportit, trajtimit por edhe të politikës së zbatuar ndaj shqiptarëve të projektuar në shekullit e fundit nga qarqet zyrtare dhe intelektuale të Serbisë së viteve 1878 – 1999. Libri "Çfarë shkruanin autorët serbë përpara 100 vitesh për shqiptarët e Nishit dhe Toplicës" do të mbetet një leksion i mirë, sesi nuk guxon të vendosen marrëdhëni jo të shëndosha finqnjësore dhe çdo qasje e paraqitje e imazheve të kombit finqj në rastin konkret të shqiptarëve, ashtu siç kanë vepruar pjesa dërmuese e autorëve serbë do ta mbyllë perspektivën e arritjes së një finqnjësie të mirë dhe një të ardhme më të ndritshme.

Mbresa

POEZIA SI PIKTURË

(Dy – tri fjali rreth vëllimit poetik "Gruaja me këpucët e kuqe" të poetes Lulëzime Malaj)

Laureta PETOSHATI

Jemi mësuar të shikojmë poezitë nga temat që trajtojnë dhe shpesh herë temat e një poezi janë të qarta: poetët zakonisht në vargjet e tyre kanë një histori për të treguar, një ngjarje, që u ka mbetur në mendje, ose një dhimbje për të ndarë me lexuesin. Nganjëherë sipërfaqja të gënjen, sepse po të lexosh më shumë të del një kuptim akoma më i thelli.

Nuk do të ndalem në shumë aspekte të poeziës së Lulëzime Malaj, por vetëm në dy prej tyre, sepse këto veçori përbëjnë individualitetin e saj në poezi dhe e dallojnë nga të tjerët.

E para të duket sikur në poezinë e saj sheh një pikturë. E gjitha kjo atmosferë e krijuar në shumë poezi të saj të kujton thënien e Da Vinçit se; "Piktura është një poezi që shihet dhe nuk dëgjohet, dhe poezi është një pikturë që dëgjohet dhe nuk shihet. Pra, këto dy poezi ose e thënë ndryshe këto dy pikatura, kanë shkëmbyer shqisat me të cilat duhet të depërtojnë në intelekt."

Ja le të marrim, për shembull, poezinë "Gruaja me këpucët e kuqe". Të

duket sikur kudo që shkon të ndjekin si ritëm ngjyrat, ku e kuqja, ngjyra sublime e gjakut pikturnon një tablo rrëqethëse: dashurinë dhe vdekjen.

Tema ndërthuret konform me ngjyrime kohe, melodie dhe ngjyrash reale. Po ashtu është dhe te poezitë "S'besoja te magjitet", "E kush veç agut", "Ku gjej paqe", "Vetmia ime", etj. Madje, poezia "Vetmia ime", është si një tablo brenda tablosë shpirtërore të poetës, e cila pikturnon me këto fjali tejet origjinale, të cilat theksojnë individualitetin e saj:

Kjo vetmi më ngjason me një mjegull,

me një kanavacë të ujshme të shpërvjelë ngadalë,

me një pikturë abstrakte që duket pa kuptim,

por në vetvete me thelb origjinal.

E dyta: Përveç përdorimit të ngjyrave si funksion psikologjik dhe si metafora konceptuale, Lulëzime Malaj përdor dhe dritën në poezinë e saj. Drita i jep poeziës së saj një bukuritë paqtë dhe sublime, si te poezia;

"S'besoja te magjitet", ku më shumë

dritësim shpirtëror i jatin vargjet:

Unë që s'besoja kurrë te magjitet
të besoj kam vendosur tashmë,
por hënë e plotë si skelet me dritë,
kërkon dashurinë që s'është më.

Në përdorimin e dritës në poezi, ajo bën dhe dallimin e llojeve të ndryshme të shkëlqimit, pra të gjendjeve të brendshme të saj shpirtërore. Ja për shembull këtë diferençim ajo e bën në një poezi të vetme me katër rreshta, "Atë ditë...", ku ajo thotë:

Atë ditë dielli nuk doli fare,
se nga u fsheh, nuk e di.
Befas në një kthesë të pash ty
që ndrite hapësirën me dashuri.

Drita pasqyrohet dhe kuptohet në kuptimin fizik dhe metafizik si të poezitë "U nder muzgu", "Një kartolinë për ju", "Ra muzg", ku të kjo e fundit thotë se:

Ra muzg,
por ende ndjej se dita vazhdon
dhe pse yjet si lule molle ndriçojnë.
Jo gjithnjë, muzgjet vijnë të errët, të

ftohtë...
se ca muzgje me agimet ngjasojnë!

Nganjëherë drita në poezinë e saj merr trajta trashedentale, pra kalon në përmasën tjetër si te poezitë "Kjo grua...", apo dhe "Në shtëpinë e prindërvë", ku drita merr përmasën e kujtimeve, e dashurisë njerëzore, e pranisë së tyre në formë drite në vend të pranisë fizike, si te vargjet:

U çmalla e fola me prindërit e vdekur,
ecëm tok si dikur në udhët e diejve,
në muzg ata zgjasin kokat në
dritare
dhe ikin si dritë fushës së përtejme.

Pra poezia e Lulëzime Malaj ka brenda saj nëpërmjet dritës shpresën, dashurinë dhe shpirtin njerëzor, ka konceptet e shndërrimeve shpirtërore sipas parimit nga errësira në dritë, ecja drejt së mirës qoftë edhe në errësirë derisa të duket drita në fund të tunelit. Drita është metaforë e poeziës dhe e jetës së saj si poete. Mendoj, se shpirtin binjak të saj e ka te Lasgush Poradeci.

ELEMENTET BAZË TË PËRVOJËS ESTETIKE

Gjatë përvojës estetike edhe pse njeriu nga njëra anë mbështetet në shqisat, por duke e tejkaluar atë, vetes apo objektit të përvojës së tij i mvesh një subjektivitet të veçantë. Për rrjedhojë, përvoja estetike domosdoshmërisht është e lidhur me përvojën transcedentale apo me vetë transcedencën



Nga Metin IZETI

Në botën para-moderne, me një kontrast, uniteti antropokozmik i njeriut dhe natyra kanë qenë të karakterizuar nga situata, ku, në njërit anë domeni diskursiv e në anën tjetër ai i arketipeve si të manifestuara në kozmos, kanë qenë akoma thellësisht të lidhura. Në Islam, në veçanti në botën e tasavvufit, termi ajat d.t.th. 'shenja' kozmike, të cilat u ngjajnë 'nënshtkrimeve' Hyjnore mbi krijimin dhe mbi versetet Kuranore. Intelekti ('akl) është i koncentruar si domeni themelor kontemplativ, nga shkaku se parimi është në gjendje t'i lexon këta ajete. Jobesimtari, në Kuran, shpesh është karakterizuar si ai i cili nuk është i aftë që t'i lexon shenjat e Zotit në horizont; dhe pikërisht kjo paaftësi është shkaku dhe pasoja e mos përqafimit të tij me Islamin, rrjedhimisht 'mos nënshtrimit' të tij ndaj Zotit. Kurani dhe libri i Gjithësisë, janë dy aspektet themelore të Fjalës Hyjnore. Ata janë 'poezi' në kuptimin më të lartë të kësaj fjale. Së këndejmi, logjika dhe poezia janë të lidhura ngushtë si modele komplementare të të diturit në Islam: që të dyja, manifestojnë Intelektin Hyjnor në sferën e natyrës dhe gjuhës. Koncepti i Michel Foucau-së mbi 'prozën e botës' që mund të ketë 'transparencë' semantike të librit, në fakt ne do këtu do ta lexonim si 'arti i botës', nga shkaku se kjo e fundit më së shumti e shpreh eksplicitetin e idesë së korrespondecës kualitative dhe komplementare në mes natyrës dhe përfjetimit. Sejjid Husein Nasri, kuptimin e kësaj korespondencë e shpreh kësijos:

Sipas traditës perenniale, realiteti i mbrendshëm i kozmosit, i cili ia shpalos vreten syrit të brendshëm ose vizionit intelektual (dhe për të cilin, syri i brendshëm është instrument i perceptimit), është i bazuar në harmoninë e cila imponohet bille edhe mbi domenin trupor. Kjo harmoni është, përmë shumë e reflektuar në botën e perceptimit nga aspekti i vëtmisë pozitive, i cili në vete është reflektim i dyjave: shpirtit të njeriut dhe kozmosit. Në nivelin më të lartë, vëtmia pozitive dhe bartja e saj në shoqëri, së këndejmi riprodhon rendet kualitative të kozmosit. Zoti pra, mund të kontemplohen në dy mënyrat: me anë të rendit të natyrës dhe më anë të harmonisë së strukturës së veprimit shoqëror. Derisa për shenjat e Zotit në horizont, fenomenin që përbën gjuha fetare, mund të analizohet në dy pikëvështrime: në njérën anë mund të analizohen si një seri e aparencave formale dhe e strukturave, në anën tjeter mund të interpretohen në dritë e rëndësisë së tyre të brendshme.

Të tjetra pothuase, realiteti i tij, ta të të gjitha traditatë flasin përmes vërtetësve të shenjtërisë, që më vonë nëpërmjet të veprimit shoqëror e kanë përgjithësuar të pranuarën. Në realitet lirisht mund të thuhet se vëtmia pozitive është hermeneutikë e të shenjtës. Në një ajet të Kur'anit i Madhi Allah thotë: "Kjo është 'ngjyra' që na ka dhënë Allahu! S'ka 'ngjyrë' më të bukur se ajo që jep Allahu! Ne vetëm Atë adhurojmë" (Bekare, 138).

Ajeti i mësipërm e shpreh përmasën e vëtme të shprehjes së të shenjtës, atë gjithësore. Edhe fjalë e shenjtë është shprehur në trajtë të rimuar dhe me harmoni të pashoq të fjalëve dhe tingujve të zgjedhur. Çdo qasje që në thelb nuk e ka këtë përmasë mbetet si diçka jashtë, për të cilën ndoshta mundet të flitet, por si për të përtejmen e ndjesive të imanentes, si për një botë të përtejme që do të mund ta njihnim vëtëm me një kusht: po të dalim, për t'u mbyllur në vëtmi pozitiv, nga bota ku ndodhemi tanë. Dhe më duket se për të arritur të përtejmen në fjalë e vëtmia gjë që duhet të heqim dorë

Me gjitha format ekspressive të bukurisë njerëzore dhe natyrore, ideali fetar me këtë është ajo ku objekti ka qenë totalisht i kristalizuar nga Subjekti. Koncepti sufik nuk

pozitive. Bota e jashtme për njeriun nuk
është vetëm objekt që perceptohet vetëm
nëpërmjet të përvojës, por disa herë njeriu i
qasht me marramendje, frigohet, e përjeton
si të bukur ose ndonjëherë ka mundësi që të
ketë dëshirë të ik prej saj. Në realitet të gjitha
këta janë një lloj i përvojës; një përvojë që në
brendi ngérthen kuptime, gjykime vlerore
dhe komente. Njeriu është njeri së bashku
me të gjitha këta përvoja, jo vetëm me
eksperiencën shqisore. Ndërsa një nga
përvojat më të rëndësishme që njeriun e bëni
njeri në këtë proces të trajtësimit është
përvoja estetike. Përvoja estetike elemente
bazë i ka artin, të shenjtën dhe vetminë
pozitive. Gjatë përvojës estetike edhe pse
njeriu nga njëra anë mbështetet në shqisat,
por duke e tejkaluar atë, vetes apo objektit të
përvojës së tij i mvesh një subjektivitet të
veçantë. Për rrjedhojë, përvoja estetike
domosdoshmërisht është e lidhur me
përvojën transcedentale apo me vetë
transcedencën.

Përvoja domosdoshmërisht e kërkohet subjektin njeri dhe realitetin. Nëse do të flasim për një përvojë të vërtetë atëherë gjithsesi duhet të ekzistojë pikëtakimi midis subjektit dhe realitetit. E shenja, për ata, që e besojnë, që e ndiejnë dhe emocionohen me të, e shpreh realitetin. E shenja jo vetëm nga aspekti i zbuluesës, në fetë qiellore, por edhe në mitologji ka qenë bazë e përjetimit të realitetit. Mitet janë rrëfime simbolike të mënyrës si i kanë kuptuar ose u kanë dhënë kuptim njerëzit botës dhe të shenjtës. E shenja dhe shprehjet e saj janë si melodi, ata sa herë që performohen lindin për së dyti dhe e ruajnë gjallërinë e tyre në trajta të ndryshme.

E tillë është edhe zbulesa e fundit hyjnore, Kur'anı. Çdo ajet i tij lind së dyti gjatë çdo leximi të ri dhe tradita e komentimit të tyre nuk është traditë e vdekur por e gjallë, konstitutive, që e ka të njëjtin tekst, por që në periudha të ndryshme ekzalton auditorinë trajta të ndryshme si intelektuale ashtu edhe artistike.

Ashtu si e shenja edhe veprimi shoqëron nuk i duron vetëm kufijtë e shqisave dhe të dukshmes. Ata janë melodi të përjetshmërisë dhe relacioni i subjektit me objektin tek to nuk është i ndarë por i bashkuar. Si pasojë ka mundësi të shprehet vetëm nëpërmjet të artit. Pikërisht për këtë edhe stil i gjuhës së Kur'anit është artistik dhe jo vetëm literal. Nuk dua të them se vëtmia pozitive dhe e shenja e kanë të njëjtën natyrë. Dua të them vetëm se të dyja përvojat si njëra dhe tjetra, janë me intensitet të lartë. Kur flitet për të shenjtën/zbulësën/sunnetin atëherë ajo ka të bëjë më llojin e jetës që përcaktohet e tëra nga prania e fortë e një realiteti të shenjtë brenda nesh, e një realiteti që mund të na trondisë deri në palcë. E njëjtë gjë ndodh edhe me artin. Të dyja këta emocione na e dashurojnë vëtminë, por na mbanë të gjallë me shoqërinë.

Eksperiencia e të shenjtës dhe përgjithësimi i saj nëpërmjet të veprimit shoqëror kënduar qartë në përpunimin e sistemit të Ibn Arabit, që është shfaqur në veprën e tij, të njohur Fususul-Hikem/Perlat e Urtisë. Ai jetën dhe veprimtarinë e pejgamberëve të Allahut, të prezantuar në Kur'an, e kanë paraqitur në trajtë të arketipeve universale për të gjitha kohrat dhe hapësirat. Hermetika e tij është qasje sui generis e përvjetër së të shenjtës dhe prezantimit të saj nëpërmjet veprimit shoqërorë në vëtinë e ekzistenciale. Njeriu domosdoshmërisht është i detyruar, thotë Ibn Arabiu, të zgjedhë. Zgjedhja që duhet të bëjmë fillimisht është sasiore. Sasia e të mundshmeve, po t'i shohim të tëra si të baras-vlefshme, i kapërcen mundësitet tona. Nëse e fusim nënlojë eksperiencën e gjendjeve të përtetjeje, atëherë zgjedhja para së cilës gjindemi është cilësore. Të qenit vazhdimi i hapur ndaj mundësisë që është pothuaj ajo e të shenjtës, bën që puna e mendimit t'inënsht-

rohet vazhdimisht diçkaje tjetër, diçkaje ballë së cilës pikërisht mendimi ndërpritet.

Në këtë pikë ne sot jemi të përballë me çështjen e ardhmërisë së njerëzimit, ose, mund të themi, edhe me çështjen se do të vazhdojë ose jo jetë. Vazhdimi i njerëzimit përballë kushteve rrënuese që i ka krijuar vetë subjekti njeri, do të jetë i mundshëm vetëm se nëpërmjet të rrikthimit të të shenjtës dhe bashkimit të Subjektit me objektin. Njeriu vepron si qenie alternative e natyrës që është e përcaktuar me ndryshimin dhe zhvillimin. Veprimi me vete e sjell edhe një pasqyrim të ri të qenies. Ky pasqyrim është vazhdimesia si antinomi i ndryshimit të pandërprerë. Gadameri në hermeneutikën e tij, ngjashëm si shumë më herët Ibn Arabiu, jetën e "të tashmes" e vendos si horizont të caktuar më kuadër të historisë dhe prej këtu konstaton se qenia është një spjegim dhe se nuk primbani modalitet të pandryshueshmërisë. Këta ndryshime rrënjosore të paraqitura në shkencë dhe në filozofji do të transferohen edhe në art. Edhe Umberto Eco, është i mendimit se një veprim shoqëror nuk mund të kuptohet si pasojë e një sistemi të mbyllur të ndjenjave dhe të mendimit, përkundrazi duhet të jetë e gjallë dhe e vazhsueshme. Këtë vazhdueshmëri veprimit ia mundëson vetëm e shenjta, por edhe të shenjtës vetëm hermeneutikë e vetmës pozitive.

Objekti definitiv i veprimit shoqërор тë shenjtë ёштë тë mos ndjell ndjenja ose тë komunikoj impresione; ai ёштë një simbol, dhe si i tillë ai përdor kuptime тë thjeshta dhe pimordiale. Ai në asnjë rast nuk mund jetë diç më tepër se aluzion, objekti real i tij ёштë i pashprehur. Ai ёштë engjëllor pér nga origjina, sepse modelet e tij reflektojnë realitetin e тë përtejmes. Me anë тë një rekapitulimi тë krijimit - "Veprimi Hyjnor" - alegorikisht, demonstron natyrën simboliqe тë botës, e çliron shpirtin njerëzor. Gjitha këto aspekte fundamentale тë veprimit тë shenjtëruar, në një apo tjetër mënyrë, si dhe në proporcione тë ndryshme, në secilën prej traditave tradicionale, në esencë e posedojnë тë vërtetën dhe madhështinë e plotë тë përjetimit тë përtejmes në vetmi pozitive, ashtu që secili do тë jetë i aftë, në parim, тë manifestojë cdo formë тë mundshme nga shpirtëria. Për më tepër, forma, përmes natyrës së vetë тë plotë, ёштë e paaftë т' a shpreh një gjë па mos e përjetuar një tjetër, sepse forma e limiton atë që e shpreh, dhe si rrjedhim në këtë mënyrë e ekskludon mundësinë e shprehjeve тë mundshme nga arketipi i tyre universal. Ky ligj natyrisht aplikohet në gjitha nivelet manifestimit formal; kështu që ndryshueshmëritë e zbulimeve hyjnore, në тë cilën janë gjetur religjione тë ndryshme, gjithashtu janë reciprokisht ekskluzive kur peshohen në kushtet e pasqyrimeve тë tyre formale, e jo në esencën e tyre Hyjnore, e cila ёштë Një. Nuk ka veprim shoqërор që nuk mvaret në një aspekt nga metafizika. Shkenca е

Një aspekt nga meccanika shkencore është e pakufizuar, kur dihet fakti se objekti i saj është infiniteje. Nisur nga kjo që u tha, në vijim të tyre, gjithçka që nuk na veçon e ndan nga bota, gjithçka do të binte ndesh me rregullat thelbësore të veprimit shoqëror dhe të shenjtës. Shpeshherë disiplina e industrializuar, duke na mbyllur në rrugën e punës, na largon nga përvojat e përtejme. Kështu është vërtetë, të paktën në kuptimin e përgjithshëm, por ama edhe kjo përvojë e të përtejmës e kërkon disiplinën e vet. Një gjë është e sigurt: se një disiplinë e tillë ndalon çfarëdolloj lëvdate llafazane të të shenjtës ose veprimit shoqëror. Thashë më lartë që veprimi shoqëror dhe e shenja e kérkojnë heshtjen, mirepo veprimi shoqëror e kërkon fjalën dhe bartjen e saj në vepër. Vetëm kjo është mënyra e ndërtimit të arketipeve të shëndosha dhe veprimit produktiv shoqëror si manifestim i këtyre arketipeve, në të kundërtën humbja e unit dhe pashpirtësia prodhon kufi..

Përralla e refuzimit të totemit

ROSTANIA

(Njeri qesh e njeri jam, njeri tjetër këtu s'kam)

Skënder KARRIQI

"Kjo që do t'ju rrëfej, ka ndodhur shumë kohë më parë, që kur s'mbahet mend..." Kështu e fillonte përrallën nëna jonë, Sofia, që ndjesë i pastë shpirti ku i ka rënë, atje, në Dherin e Bardhë, në Prrenjës, ku janë varrezat, edhe të fshatit, edhe të qytetit. Pastaj ajo na rrëfente se një ditë dimri ndajnate, gratë e fshatit malor, mu atje ku fillonte qielli, kishin vajtur për të bërë dru dhe se njëra prej tyre, një nuse e re një vit e martuar, pasi kishte ngarkuar drutë, nuk kishte mundur të ngrivej se kishte qenë me barrë dhe se ajo e gjora kishte pasur turp t'u kërkonte ndihmë grave të tjera, prandaj kishte mbetur aty, e kishte zënë muzgu, e kishte zënë nata, e kishte zënë terri i zi, deri sa kishte dalë një hënë dimri, e verdhë po e po, por edhe e ftohtë, e më pas kishin filluar të lëvizin nëpër pyll shtazëria. Sipas rrëfimit të nënës sonë, asaj nuses së re i kishte vajtur lepuri për ta ndihmuar. Ai i shuari e kishte pyetur se ç'bënte aty dhe nusja e re i kishte thënë se ishte me barrë dhe s'mund të ngrivej. Atëherë lepuri i kishte thënë të kapej pas bishtit të tij, por bishti i lepurit qe këputur dhe nusja kishte mbetur aty, rënë, me dy barra mbi vete: fëmijën në bark dhe drutë në kurriz. Pakëz më vonë i qe afroar për ta ndihmuar edhe dhelpra, por edhe bishti i saj qe këputur. Pas dhelprës, rrëfente nëna jonë, i qe afroar baba ARIU, që i qofshim falë, edhe ai për ta ndihmuar nusen e re, mbetur në mes të pyllit një natë të ftohtë dimri, me një hënë të verdhë, por edhe ajo shumë e ftohtë. Edhe baba ARIU e kishte pyetur nusen e re se ç'bënte aty dhe ajo e shkreta ia kishte qarë hallin. Pastaj, ashtu si lepuri dhe dhelpra më parë, baba ARIU i kishte thënë të kapej pas bishtit të tij dhe hopa, e kishte ngritur menjëherë. Pasi e kishte ngritur, i kishte thënë që, nëse do të lindte djalë, t'i rronte dhe ta kishte me shëndet e jetë të gjatë, ndërsa po të lindte vajzë, emrin t'ia vinte Rostani dhe t'ia falte atij, baba ARIUT. Mirë, i kishte thënë nusja dhe, nëpër drithën e hënës, kishte drejtuar rrugën për t'u kthyer në fshat.

Ne e dinim që këtu mbaronte pjesa e parë e përrallës. Dinim gjithashtu se në përfundim të kësaj pjese, nëna jonë Sofie i hidhte një sy zjarrit, e ushqente atë me ndonjë shkarpë dhe rregullonte shaminë e kokës. Edhe ne pas saj të bënim dy-tri lëvizje çmpirëse, për t'u përqendruar përsëri tek sytë e zinj në fytyrën e saj të bardhë. Mu në këtë moment ojo e kuptonte se duhet të fillonte rrëfimin e pjesës së dytë të përrallës dhe merrete përsëri pozicionin e rrëfimtares. Atëherë ne e dinim se nëna jonë Sofie do tëna fliste me ritëm dhe stil të veçantë dhe kur na fliste kështu, me ritëm dhe stil të veçantë, nëna jonë Sofie ishte ndryshe, sikur kishte ardhur nga ndonjë kohë dhe vend tjetër, të na tregonte përrallën e saj për Rostanisë dhe të ikte përsëri.

Në pjesën e dytë nëna jonë Sofie na rrëfente se, pasi kishte kaluar shumë kohë dhe Rostania ishte rritur, ajo dilte të luante kasollash me fëmijët e tjerë të fshatit. Një ditë andej kishte kaluar baba Ariu, i cili ishte ndaluar përpara saj, e kishte pyetur si e kishte emrin dhe ajo i kishte thënë se e kishte emrin Rostani. Ai e kishte uruar: "Më rrofsh moj bijë!", siç urojnë prindërit e gjyshërit dhe e kishte porositur që, kur të shkonte në shtëpi, t'i kujtonte nënës bisedën me atë, baba Ariun, kohë më parë, në një natë të ftohtë dimri, kur ajo ishte nuse e re, me barrë, dhe kishte mbetur e vetme në pyll. Rosta-



nia nuk i kishte thënë gjë nënës atë mbrëmje, nga që kishte vajtur e lodhur në shtëpi, kishte harruar dhe e kishte zënë gjumi. Edhe baba Ariut ashtu i kishte thënë ditën tjetër, se kishte vajtur e lodhur në shtëpi, kishte harruar dhe e kishte zënë gjumi. Pasi Rostania kishte harruar edhe herën e dytë, rrëfente nëna jonë Sofie, baba Ariu i kishte dhënë asaj tri kokrra mollë që t'i fuste në brez. Kur ta hiqte atë për të fjetur gjumë, do të gjente mollët dhe do të kujtohej për porosinë e baba Ariut. Herën e tretë, kur kishte hequr brezin për të fjetur, Rostania kishte gjetur mollët që i pat dhënë baba Ariu, ishte kujtuar për porosinë dhe ia kishte thënë nënës së vet ç'i kishte thënë baba Ariu. Nëna ishte kujtuar për atë bisedë kohë më parë, në një natë të ftohtë dîmri dhe i kishte thënë Rostanisë që t'i thoshte Baba Ariut: "Ku ta gjejë, le ta marrë". Nëna jonë Sofie e mbyllte pjesën e dytë duke na rrëfyer se, me të dëgjuar atë përgjigje, baba Ariu e kishte marrë Rostanien dhe e kishte çuar në shpellën e tij, ku ajo kishte jetuar qëndri lëkjdësi, siatë boshkë me

Jetuar per një kohë të gjatë bashkë me të.

Gjatë rrëfimit të pjesës së dytë ne gjenim momentin të merrnim pak frymë, kur nëna jonë Sofie rrëfente në mënyrë të përsëritur, fjalë për fjalë, dy harresat e Rostanisë për t'i kujtuar nënës së vet porosinë e baba Ariut, kohë me parë, në një natë të ftohtë dimri, kur ajo, nëna e saj, ishte nuse e re, me barrë, dhe kishte mbetur e vetme në pyll. Ajo që ne nuk e kapërcenim dot ishte lehtësia (nga ato lehtësitë e papërballueshme, për të cilat flet Kundera në romanin e vet) me të cilën nëna i thotë që ajo vetë, Rostania, t'i thoshte Baba Ariut: "Ku ta gjejë, le ta marrë". E shkreta Rostani, nuk e dinte që fjalë ishte për vetë atë; ishte ajo vetë që diku do të gjendej dhe atje ku dhe kur të gjendej, do të merrej (do të rrëmbehej). Pra, në thelb, ishte ajo vetë porosia e baba Ariut, kohë më parë, në një natë të ftohtë dimri... Ndërkokë që ne e përjetonim në këtë mënyrë mospërputhjen e figurës së nënës së Rostanisë me figurën e nënave të tjera, nëna jonë Sofie ishte bërë gati të fillonte rrëfimin e pjesës së tretë, që do të thotë së ajo ishte vënë në pozicionin e

rrëfimtare dhe ne, me ndjesinë e ritmit
dhe stilit të veçantë të rrëfimit, ishim
shndërruar përsëri në dëgjues, gjithë sy e
veshë.

Eçüp të zi për shkencat shqiptare nuk ka kënduar e në të gjëzuar: "Rostani a bi/Hape derën ti/Solla capr e zi", ajo luga e vogël që kishte mbetur e papërmbysur, mezi kishte drejtuar llafet dhe kishte arritur të thoshte: "Mori vlai e koi" ("E mori vllai e shkoi"). Në fillim baba Ariut i

"Plejad" 2003, ku në faqen 187 të tij thuhet: "Në fillim ky emër Ardem ose Ardam i perëndeshës (Artemisë-s-hënimi im, S.K.) krijoj një sërë vetish shtesë dhe një cikël të dytë mitologjik, do të guxonim të thoshim. Bie fjala, në Arkadi, por edhe në Atikë, Artemisi dhe kulti i saj lidhen me ariun, ndaj janë krijuar shumë variaçione për ariun e shenjtë të perëndeshës dhe përmëtësuar e saj të ndryshme. Përsa i përket Arkadisë, a do të mund të supozojmë se emri kombëtar Arkadi, që ka lidhje me Arkadët e Ilirisë, lidhet me ariun...". Në fjalorin e tij mitologjik, shtëpia botuese "8 Nëntori", Tiranë 1987, doc. Todi Dharma, ndër të tjera, thotë se kafshët e kultit të

perëndeshës Artemis ishin kryesisht dreri dhe arusha. Ndërsa Barbara Colonna, në fjalorin e saj mitologjik, "Toena" 2005, thotë se Artemisa ishte perëndi e gjuetisë, e kafshëve dhe e hënës dhe se kapërcente malet e Arkadisë e shoqëruar nga nimfat e saj, por se kafshët e shenjtë për të ishin dreri, qeni dhe derri i egër.

Viset ku është rrëfyer dhe ndoshta rrëfëhet edhe sot përralla e Rostanisë, përkonjë me malësinë e Sopotit, Polisit, Stravanit, Farretit, Stranikut, deri poshtë Luginës së Shkumbinit, në Karkavec, Bërzeshë, Qukës, Xhyrë, Dardhë dhe janë pjesë e Nënprefekturës së Librazhdit. Banorët e lashtë të këtyre fshatrave dhe zonave kanë qenë kandavët ilirë, për të

cilët arkeologët dhe historianët thonë se i besonin kultit të Dianës, përndryshe Atremisë në mitologjinë greke, së cilës i kishin ngritur edhe një tempull ku i faleshin asaj. Në vitin 1916 arkeologët austriakë Prashniker dhe Shober zbuluan në Babje të Librazhdit një pilakë me mbishkrimin: "Diana Augusta Candavensis" (Diana Mbretëresha e Kandavëve), e cila mendohet se është pjesë e sanktuarit të tempullit të Dianës, përndryshe Artemisë në mitologjinë greke, që si kafshë të shenjtë të saj, ndër të tjera, kishte edhe ariun.

Nisur nga të dhënat e mësipërmë mund të thuhet se hija totemike e baba Ariut ka rrënjetë vjetra, antiqe, që lidhen

me kultin e Artemisës, perëndisë së gjuetisë, të kafshëve dhe të hënës tek ilirët kandavë të këtyre trevave dhe që më vonë, gjatë pushtimit romak, del sipas mitologjisë romake, me emrin përgjegjës Diana. Përralla e Rostanies përkon me momentin e refuzimit të këtij totemi, ndër të tjera, edhe për shkak të nevojës së brendshme përfundimisht nuk mund të jetë pothuajse të shkrirë me natyrën, çka është arsyja pse njeriut i duhej ta shquante veten. Në këtë kuptim, përralla për Rostaninë është një akt i lashtë shquarë dhe diferençimi, fiksuar nga memoria njerëzore në një trajtë të tillë përralle, mu në ag të qytetërimit.

Përsiatje

VDEKJA VJEN PËRTEJ SË MARTËS

(Mbi romanin "Asnjëherë të martën", i Bashkim Hoxhës, botim i shtëpisë botuese "Onufri", Tiranë)



Agim BAJRAMI

Për të nisur leximin e librave të Bashkim Hoxhës, një lexues ka njëmijë e një arsy, por arsyja më e fortë është, se librat e këtij autorit janë si një skenë teatri, ku personazhet luajnë dramën dhe tragjikomedinë e tyre, me një sinjeritet deri në vetëmohim dhe përmë tepër, pa kërkuar prej askujt duartrokite. Në këtë kontekst nuk bën përjashtim as libri i tij i fundit, "Asnjëherë të martën", roman që e pasuron edhe me shumë opusin e tij letrar me temat e nxehta të bashkëkohësisë. Edhe pse në pamje të parë të krijohet ndjesia se kemi të bëjmë me një histori policëske, me vrasës dhe të vrasë, e vërteta është ndryshe. Është një vepër ku personazhet janë modeluar në bazë të raportit kohë - hapësirë, po ku nacionet formale të kortezi, ku kohë që janë prishur, ose janë kthyer në të kundërtën e tyre. Është ky realitet që i jep veprës së këtij autorit një shpërfaqe përtej të zakonshmes. Eshtë ky shkaku, që kufijtë mes narrativës së jashtme të shkrimit tarit dhe narrativës se brendshme të personazheve, të janë të padukshëm, ose në rastin më të keq krejt formalë, duke dalë kësijoq nga stereotipet dhe formatet tradicionalë të diskursit. Bashkim Hoxha jo pa qëllim zgjedh kohë tranzite, dhe situata gjë në kufijtë e absurdit. Ai e di se prej tyre mund të nxjerrësh krijesa hibride dhe material po që interesant. Shumica e heronjve të tij sikur kanë dalë nga një album të sëmurësh depresiv. Edhe pse shpesh herë shfaqen para nesh me pamje të zakonshme, ose me kostume të

shtrenjtë filozofësh provincialë, bren-dia e tyre e padukshme le vend për tu mëshiruar. Shumica e tyre janë të implikuar në vrasje, ose veprimtari kriminale dhe janë të dënuar të ndiqen nga mbrapa nga turma e hixjeve të viktimate të tyre. Edhe pse bëjnë gjithçka për të shpëtar, dalja e tyre nga metafora e fatalitetit është e pamundur. Jo më kot fatthënat që kundrojnë dhe parashikojnë jetët e tyre në këtë vepër, kanë zakonisht ftyra të ngrysura dhe shohin çdo natë ëndrra horror. Nga ana tjetër, Bashkim Hoxha nuk e kundron personazhin e tij vetëm si viktimi rrëthanash shoqërore, por edhe një si viktimites të pamëshirshëm të saj. Në sinkron me këtë, ai pikton edhe ambientet urbane, ku rriten dhe zhvillohen ata. Ndofta është ky çelësi magjik, me të cilin ai arrin të motivojë ngjitet e përkohshme dhe rrëzimet e tij. Denis P (alias Vladi) në fillim ishte një njeri i rregullt, gjersë një ditë të bukur kthehet në një vrasës profesionist të rrezikshëm. Mendimi i parë që mund të vijë në këtë rast, është se brenda tij mund të ketë ngjarë ndonjë shkarje, apo shok i rëndë psikologjik, pasi në jetë ndodhin shpesh trauma të tilla. Por mbasi bëhes vetëm pak kohë bashkudhëtar i ambienteve të frikshëm, ku është rritur dhe formuar ai, bindesh për të kundërtën. Janë koha dhe aksesorët e saj të përbindshëm shkaktarët kryesore të këtij transformimi. Jo më kot gjatë gjithë aktit të leximit, lexuesi ndjen një mungesë të vazhdueshme ajri dhe një ankth që të vret pak nga pak. Pika e shkurtit ky ka qenë edhe qëllimi parësor i autorit. Depërtimi në substratin e së keqes dhe trajtimi sa më i thellë artistik i saj. "Vdekja si fillim, vdekja si fund".

Ashtu siç e thamë që në krye, ky roman fillon me një deklaratë të pazar-kontë për një vrasje të pritshme: "Te martën e kam pushim, nuk bëj vrasje. Të mërkurën po. Pastaj do iki". Edhe pse ngjan se Denis P, i ka shpëtar pa dashje kjo gjë, një që përfundon me një mjet artistik mjaft i gjetur nga ana e autorit, për t'i dhënë veprës së tij që në krye, një fillim intensiv. Detaje të tillë që autor i përdor herë pas herë si pjesë e teknikës së tij narrative, janë të aftë ta gjallërojnë dhe ta bëjnë më të lëvizshëm dhe më dinamik rrjedhën romaneske. Protagonisti dhe hija e tij fizike, ecin krah për krah njëri tjetrit, për një kohë të gjatë, por që nuk e pyesin njeri tjetrin, se ku do mbërrinë, pasi ata e kanë të qartë destinimin e tyre fatal. Vizatimi i një peizazhi të tillë gri shoqërohet

patjetër me një muzikë të trishtë të tipit funebër dhe aq më shumë kur plotësimi të peizazhit i shërbën edhe dalja herë pas here në skenë e simbolikës së Shën Kozmait, shenjtit me një kokë të prerë në duar. Si një vepër me pohime të fuqishme, të tillë detaje e përforcojnë më shumë faktin se ne, të gjithë, udhëtojmë gjatë gjithë jetës sonë, me vdekjet dhe kafkat tonë në duar, pavarësisht lumturive dhe humba-mendjeve tonë të përkohshme. Synimi i autorit për të treguar se ç'pjesë te vyera shpirtërore humb individi, kur bëhet pjesë e së keqes, jepet nëpërmjet kurbave të herëpashershme të një jete njerëzore, gjithnjë e në rënje, çka një lexues i mirë mund t'i ndjekë vazhdimisht hap pas hapi Ajo çka të bie në sy në shumë romane të këtij autori, është autenticiteti i rrëfimit. Shumica e heronjve të tij, kanë një dëshirë të lindur, për ta marrë vët përsipë narrativë e veprimeve të tyre, duke u rreshtuar kështu në një vijë paralele me autorin e veprës, në një duet interesant. Nëse do të hidhni një paralele me këngët polifonike të jugut, në këtë roman kemi të bëjmë më dy lloj narratorësh: Narratori A (ose marrësi) që është shkrimtar, dhe Narratori B (ose kthyesi që i takon të jetë Vladi. Zhvillimi i veprës varet natyrisht nga harmonizimi i zërvave të tyre, pa interferuar dhe pa i hyrë njëri tjetrit në pjesë. Në kontrast me tonet e buta dhe të jetës të Narratorit A, tonet e larta dhe ndonjëherë të pakontrolluara të Narratorit B, janë këq të nevojshëm. Së pari i shërbenjë autorit për të prishur linearitetin e narrativës, por më së shumti i shërbenjë Narratorit B që ka një etje të tmerrshme për të rrëfyer historitë e trazuara të jetës së tij të trazuar dhe për tu lehtësuar disi. Duke i mbledhur në një shumësinë e ngjarjeve dhe historive, pohimi bazë i të dy narratorëve është se: në kohë të qëndrueshme askush s'habitë më me habinë. Duke qenë një autor që e njeh gjer në detaje periudhën e tranzicionit të pamëshirshëm shqiptar, dramat dhe tragjedji që ka prodhuar dhe vazhdon të prodrojë ai, autorit i mëshon fort idesë se kur njerëzit mësohen me të keqen për një kohë të gjatë, shndërrohen padashje edhe vëtë në mbrojtës dhe kalcifikues të saj. Personazhi kryesorë i romanit ka kohë që vuan nga halucinacionet. Që mbas vrasjes së parë, Vladi nisi të bëhej i verbër si plumbi, sepse historitë e tij të mëparshme ia vodhi mijegulla. "Nuk ka kohë të shohësh qellin, nëse vret një njeri", thotë ai me trishtim përpara aktit

të vetëvrasjes. Diskordancat e dukshme mes kohës së reflektimit dhe kohës së rrëfimit janë të shpjegueshme. "Me sa duket, kolona zanore e kujtimeve, mund të jetë e trishtuar, thotë ai". Ose "Në luftë shkohet për të vrarë, nuk shkohet për vallëzim". Intriga e thyerjes se Vladit kalon nëpër një trajktore të gjatë dhe të ndërlidhur katarsit. Një proces i tillë që ndeshet kaq shpesh edhe në shumë vepra të letërsive të mëdha, në romanin "Asnjëherë të martën", ka një specifikë të veçantë. Ai u shpall që në momentin kur ai kuptoi këtë ambient për rrugëdalje. Rendja nëpër natë, në kërkim të Marinës, të "dashurës" së tij mbas grindjes për abortin e foshnjës, vrasja e ndërgjegjes dhe dëshira e çuditshme që e pushtoi, për ta pasur atë pranë bashkë me fëmijën, humbja e saj sëbashku me trashëgimtarin e mundshëm dhe më në fund vetëvrasja. Edhe pse mund t'ë ngjajë pakso e çuditshme për dikë veprimi fatal, vlerësoj se autorika vepruar drejtë. Një individ si Vladi, që hyn aksidentalish në një rrugë të shtrembër, dikur do kërkonte për të dalë prej andej, duke marrë mbi vete edhe kostot. Shfaqja e herëpashershme e imazhit të nënës birësuese dhe asaj të vërtetë kanë lozur rolin e tyre. Në kuptimin metaforik, Denis D ndihej këq i vëtmuar larg tyre, ndaj dhe shkoi për t'i takuar ato. Bashkim i t'ë intrigon që në titujt e veçantë që u vendos librave të tij. Janë ata që t'ë orientojnë, për t'ë hyrë sa më shpejt nga porta kryesore e veprës dhe jo nga dritarja. Relacionet e këndshme mes elementit publicistik dhe atij romanesk, i kanë sjellë risi dhe veçanti të spikatura veprës së tij. Kjo gjë duhet thënë edhe për mënyrën e thurjes se subjekteve dhe tipologjinë e larmishme të personazheve, njeri më interesant se tjetri, si dhe kurthet e shumta artistike nëpër të cilat ngjecin ata. Është ndofta kjo një arsy me shumë që fiksioni të ushqetet nga realiteti dhe dallimet mes tyre të janë këq pak të dallueshmë. Në këtë vepër spikat tendencë e autorit për ta shqyrtuar heroin e tij nëpër disa fazë vëzhgimi, si dhe një rikthim më këmbëngulës "drejt se brendshmes" së tij ekzistenciale. Ndaj, nuk është rastësi që mbasi ke kthyer edhe faqen e fundit "Asnjëherë të martën", të të mbetet në duar skeleti prej kartoni i një individu pëtë nesërmë dhe pyetja se deri në ç'shkallë mund ta katandisë atë perversiteti dhe imoraliteti i një shoqërie të helmuar.

DISKURSI I DHIMBES SË PASHMANGSHME

(Halil Matoshi "The Lils's poem", botoi "Littera" Prishtinë, 2023, fq. 166)

Kemajl ALIU

Libri më i ri i poetit Halil Matoshi "The Lils's poem" (Poema për Lilin), marrë në përgjithësi është libër me të cilën poeti shënon ngritje cilësore në kontinuitet e krijimtarisë së tij letrare-poetike. Këtë shënim evident ai ka arritur ta sendërtoj përmes tematikës së shtjelluar, mjeteve shprehëse stilistike, densitetit figurativ si dhe gjuhës specifike, çka e bën një libër poetik, kushtimish përmbytjesor. Libri "Poema për Lilin", siç cekëm më lart, dallohet jo vetëm për nga mbarë shtrimi motivor dhe tematik, por edhe për nga qasje dhe perceptimi i materies lëndore; (burgu, lufta, ndarjet, vdekjet, të zhdukurit), që e mbajnë koshient lexuesin fund e krye leximit. Në pjesën dominante të vargjeve poeti vë thekse dramatike nga momentet ekalmit-përfjetimit - mbijetimit të këtyre situatave dramatike, të cilat nuk marrin fund asnjëherë. Ato do të na shfaqen përsëri, tash më të reprodukuara në pasojë.

Dhimbja si lajtmotiv kryesor i poezisë


Dhuna nuk është ajo që shihet, nuk është ajo që ka ndodhur. Dhuna në faktështë ajo që vazhdon të ndodhë, edhe pasi të ketë pushuar. Ajo manifestohet e reprodukuar në forma dhe trajta të ndryshme, përmasat e së cilës poeti do të arrijë të na i shpërfaqë vetëm nëpërmjet shtyllimit artistik. Sepse, siç thotë ai me plot të drejtë, në një rast: / Nuk fotografohet dhimbja!... Poezia, "P'ej sh'pie apo return to Ithaca", Fq. 130. Përmes këtij vargu poeti sikur paralajmëron, një diskurs tjetër të ligjërimit mbi dhunën, përbijetësën dhe për dhimbjen: /Nana e shtangun/ m'i kish ngulë sytë nemitun/ si me pa dekën e djalit/ The Lils's poem", fq. 54.

Mesazhi që del nga kjo poezi është fare i përtë se dhuna është antinjerëzore, gjegjësisht se nuk ka, dhe nuk mund të ketë diçka më antinjerëzore se dhuna. Ajo është dhe mbetet gjithnjë e përmasave tragjike. Është poli dimensionale, konsistente, dhe gjithëpërfshirëse. I përfshinë të gjithë, pa përshtatim: /Baba 84 vjeç / shihe ne sy milicët/ i patrazuam sikur talje me kohët që i ringjalleshin/. Po aty.

Pas kësaj drame pa epilog siç thotë poeti, ai do të nxirret jashtë shtëpisë, i përpire nga tmerri se: / Mund të ishte shaekspere-ane/ ata mund të ktheshin mrena/. Po aty, fq. 55. Revolja e drejtuar mbas kresë së tij, nuk do të shkrepë... Por në fakt ajo tashmë ishte e zbrazur... Armët e mbushura që plot një shekull qenë zbrazur po atë ditë mbi Lilin, qenë zbrazur mbi gjithë botën e tij./Mas meje metën njerëzit/ e mi hala të gjallë/dhe tymi dendur me erë mishë/ që dilte nga mbarmendja/ fq. 56, "The Lils's poem".

Marrë në tërësinë librore "Poema për Lilin", është realizimi më i plotë artistik. Shquhet për kronologjinë e rrëfimin, dramacitetin e vargut, si dhe për përshkrin tipik psikologjik të personazheve: Nënës, babës, fëmijëve dhe serbëve me "menime të zeza". Është poezi e shkurtër, që le mbresat e leximit-kalimit nëpër një poezi shumë të gjatë. Është një dramë në vete.

Duhet vënë në pah se kjo tematikë si dhe motive tjera të ngjashme të përafertë me të, edhe pse kanë një trajtim jo të pakët në letrat tona, si përmbytje vazhdon të



mbetet gjithnjë shumë e kërkuar. Me këtë rast më duhet të theksoj se sa i përket poezi, me tematikë të burgut, dhunës, luftës, të zhdukurve, dhimbjes, te poetët Xh. Bajraj dhe H. Matoshi-është e një spektri ligjërimor të veçantë, me kënd-vështrimë dhe qasje tjera, me një dramacitet të theksuar të vargut çka mund të konsiderohen lirisht prurje të reja në letërsinë shqipe /Kjo poezi s'është e imja/ Këto vargje i kanë shkruar ushtarët e armikut/ E imja është veç dhimbja / Xh. Bajraj "Copa ime e Qiellit", fq. 65.

Burgu, ku t'burguemit nuk thyhen...

Në librin poetik "The Lils's Poem", është një numër sosh i poezeve, ku jo vetëm për nga numri por edhe nga përmbytja poeti trajton temën e burgut, apo për të burgue-mit siç shprehet ai, ku përpës me një përshkrim të detauar me shprehje fine artistike, do shquhet për atmosferën që e krijon me ngjyrimet më të errëta, ku pellgjeve të errësirës danteske do të shpërthejnë fuqishëm dhe pathyeshëm ndjenja qëndrese dhe mbijetese.

Burgjet e okupatorit dallojnë esencialisht nga burgjet e një shteti nacional. Ato karakterizohen me faktin se bën përfashëtim rregulli, se ato nuk janë ngrehina për të vuajtur i privuari nga liria për shkak të një dénimri të caktuar, por ato bëhen kryesisht për ta burgosur lirinë nëpërmjet të burguem've. Përderisa çdo burg, përcaktion lirinë e lëvizjes brenda hapësirës së qelisë dhe hapësirave tjera më të hapura, te këto burgje kjo nuk do të ndodhë kurrë. Konsideroj se këtu poeti ka arritur me një përshkrim të rrallë poetik të përshkruaj anën aq të errët, aq mizore të këtyre burgjeve, ku: /për shkak të lëvizjes së duarve dhe kambëve/ I burgosuri dërgohet/ Me u marrë në pyetje në zyrat e milicës sekrete/, Zingjirë Burgu -I- fq. 40, ku siç po shihet është fjala përfarëdo lëvizje (madje edhe me cm), (Kujtoni, problemin e cm të lëvizjes për shpezë që ngrit Harari në librin "Sapiens". Natyrisht pas marjes në pyetje,

pason tortura ku i burgosuri mund të jetë i gatshëm të dal nga burgu bashkë me shpirtin e tij, (vdekja si liri)... Por jo... një kovë uji do ta kthej përsëri në ferrin gjallërues, ku ai bëhet, ndihet i gjallë në saje të vullneti të vrasësve të tij: Dhe do të zgjohet i burgueri, tashmë i njallur në një mjedis edhe më trishtues : /Rethue isha nga fantazma/ Me këmisha t'përgjakuna/ "Zingjirë Burgu" -I-, fq. 51

Ëndrra përliri, është ëndrra më e bukur që ka projektuar njeriu. Është ëndrra për lumturinë e miliona miliona njerëzve. Këtë privilegji, mbaze nuk e kanë njerëzit e lirë. E kanë vetëm të robëruarit. Apo siç do të thoshte Markezi "Racat e gjykuara me 100 vjet vetmi." Racat që kérkojnë një mundësi të dytë mbi tokë...!

Në këto burgje, të cilat janë fati kolektiv i shqiptarëve (çdo i treti shqiptar pati trajtim policor.), gjithçka është nën mbikëqyrje. Edhe lëvizjet e duarve dhe këmbëve nën pranga. Ne këto burgje do të humbet edhe sensi për jetë. Aty edhe vdekja është e kontrolluar. Të burgosurit janë hekur që nuk mund... nuk guxojnë të thyhen. /T'burguemit nuk thyhen/Lëmonë?/ Shina bahan me të cilët kalojnë trenat e pushtuesit ngarkue me urrejtje. Po aty, fq. 42.

Janë këto vargje kulminante, që në mënyrën më të plotë sqarojnë fatin tragjik të të burgosurve të ndërgjegjes. Burgu i tyre zgjatë pafundësish gjatë. Zgjatë derisa të kalojnë mbi ta trenat e gjatë me urrejtje shekullore. Të burgosurit do t'i përçojnë fund shekullit, atë më njerëzoren, ëndrrën, kërkësën përliri, përderisa pushtuesi do të vazhdoi të ju transformojtë urrejtjen shekujuve, edhe pse fundi i shekullit që po shkonte e kishte bëre tërësisht gjenocidal. Në vazhdim të trajtimit të kësaj pjese të librit, gjithashtu konsideroj se poezia "Ushtime stilistike me Visar Zhitin", fq. 49, është ndër poezitë më të realizuara të librit në tërësi; Është poezi e përshkrimit të thellë artistik, imaginatë të bujshme dhe dimension të gjërë të mendimit. Sa është poezi lirike, po aq është poezi e mendimit, e që shquhet

edhe për erupcionin karakteristik të vargut, që vetëm sa e kulmon vlerën estetike të kësaj poezie në tërësi : /Kur rash vet atje poshtë/ Nisa me pa mas të dukshmes/ Njerëz të dashtun /te kafkat e hedhuna në gropë/ që në vend të syve kanë gaca fq. 49.

Tragjediciteti pas burgut do të vazhdoj, sepse nga lufta si dhe burgu, nuk do të kthehen të gjithë. Janë të dy poetët (Matoshi) si dhe Zhiti i matanë kufirit të cilët pas përfjetimit të golgotës së burgut, arrijnë të dalin... Por ka edhe shumë tjerë që nuk ia kanë dalë... Janë zhdukur dhe me ta mund të çmallimi vetëm nëpërmjet fotografisë.

/N'prani të mungesës Visari ndërkohë u step/po shikonte plot habi tue i ferkue sytë/ Më prit më tha të qafëm/ Me Ukshin Hotin/fq. 50

Prandaj, kjo dhimbje siç thotë poeti duhet përsëri dhe patjetër të merr përmisasat e rishfaqjes; /në një kohë ma t' qetë se kjo e jona/.../në një kohë poetësh të tjerë/.../ /nga një emën me e majtë men/ Me u qafë me ta me ren'/ në shekuj që vijnë / Si Visari me Ukën /fq. 51

Poezi nga më përmbytjesoret e dhënë në kërkim /të një kohe poetësh të tjerë/, ku përmes imaginatës së bujshme dhe mjeshtërisë së rrallë artistike poeti arrin ta rikrijoj realitetin e ri të një kohe në pritje...!

Fundi i luftës... kthimi në shtëpi dhe vrasja e ëndrrave të fëmijëve të shpëtar

Atdheu, dhe kthimin në shtëpi në librin poetik "Poema për Lilin" është i përmave mitike. Ky kthim në njëfarë mënyre është fundi i atij rrugëtimi dramatik me mbijetësën triumfiale. Kthimi në shtëpi është rrugëtimi më i mirë që mund të bëjë njeriu. Është rruga e ëndrruar që një shekull. Por, kur lufta merrfund nuk do të kthehen të gjithë... Do të kthehen vetëm të mbijetuarit... Rruga e kthimit të tyre sikur kalon në labirinthin e pafund, të pritjeve të pafundme, pyetjeve pa përgjigje dhe dilemave kryekëput dramatike: /ditën që odiseja u nis p'ej shpie/pati një vegim se kishin dekun/ të gjithë njerëzit e tij dëritaret ishin mshelë/ me therë/ E s'kish as ku as pse mu kthyse / Poezia/... dhe shtëpia/fq. 58.

...Nuk do të kthehen të gjithë... Një të diel i kishin thënë edhe Ukshin Hotit; Je i lirë. Mund të shkosh në shtëpi. Por ai nuk ishte kthyer sot e atë ditë. Kështu ankthi i pritjes vazhdon ndër shtëpitë tonë... Deri në gjetjet mortore. Të tjerët shkruajnë dhe rishkruajnë historinë, përsërisin fitoret ... Në shtëpi përsërisim dhimbjen. Kështu Ali Podrimja dikur në Itali në Maki të Kalabrisë, kishte bërë një foto me De Radën. E pas gjysmë shekulli, Visari kishte përqafuar Ukën në Prishtinë.

Në vazhdim të leximit të librit "Poema për Lilin", do të ndeshim absurdin e një luftë e cila ka përfunduar madje edhe është fituar, por prapë vazhdon: /në botën e fëmijëve të Kosovës/ erdh një flokëthimë me emrin Peter/solli ankth/ "Letërsia vret fëmijë" fq. 117. Për të vazduar më tej me vargjet kulminante të kësaj poezie / e vjen një letrar i shthihavt/ ... /u përgjakë andrrat fëmijëve/që nuk vdiqen atë ditë në Obri/. Po aty, fq. 119.

Poezi e një guximi të veçantë intelektual do të thosha, me vargje të spikatura metaforike. Vërtetësinë e misionin e tij, sa poetik aq njerëzor, H. Matoshi, do të vazh-

doj ta dëshmoj bindshëm gjithashtu me poezinë "Po pritoj me shkru pë luftë", fq. 89, që ndërlidhet me luftën më të re në Ukrainë, ku do tu drejtohet mëkërkësë-lutje shkrimitarëve: / Tolstoi, Pushkin, Jesejin/Dostojevski/ E ti Ana Akhmatova /.../Cohuni veç edhe kësaj herë/Nga shtrati i juej i kalbun/, dhe për të vazhduar më tej, sepse:/Krymat po vlojnë në faqet e librave si në katascombe/Po aty.

Është poezi që mbanë kronologjinë e narratives në vazhdim, dhe të nivelit estetik të saj përgjithësisht. Kur jemi te referimet që autorë ua bën personallitetëve, patjetër duhet cekë se autorë shquhet për portretizime të shumta që i sjellë në librin e tij poetik. Është për tu theksuar se këto portretet e trajton në kuptimin bukval të portretizimit, por gjithnjë duke marrë pikë orientimi të bërrat, porositë, apo fuqinë e personalitetit të tyre, për çka edhe sjell mesazhe të fuqishme poetike: psh. "Lekcion nr.1", fq. 31, "Jeta jote ishte kërkim Bekë Lumi", fq. 34, "Vaj për Brahim Rugov-

ën"/"Spac (Memento për poetin Visar Zhiti)" fq. 52, "... dhe shtëpia (për poetin Xhevdet Bajraj)", fq. 58, etj. Mjafton tureferohemi me këtë rast vetëm vargjeve: /dita u pushtue nga fuqia/ e një të dekuni/poezia "Vaj për Brahim Rugovën" fq. 32. / u çaktivizuan bombat/ kurthet fjalët e idhta/ u kthyen në grykë/për të vërejtur fuqinë dhe përbajtjen e kësaj poezie figurative, e cila shquhet, për shtrirjen e gjerë të mendimit, dhe që arrin të zgoj te lexuesi, asociacione kuptimore tekstore dhe nëntekstore, nga më të begatshmet.

Kujtesa si determinuese e ekzistencës dhe shtegu i yjeve

E kaluara është petku të cilin nuk duhet zhveshur, pa marrë parasysh se krejt çka rezultoi deri në ditëtona kryesishët është mbijetesë. E kaluara është realitet i pash-mangshëm, ështëjeta jonë që mbanë vulën e përpjekjeve shekullore për Liri dhe dinjitet, prandaj ajo duhet revalorizuar. Lajbnici dikur thoshte: "Historia është

nënë e së kaluarës dhe bijë e së ardhmes". Prandaj, amnezia është sëmundje, thotë poeti: "Edhe guri thahet/ nëse nuk i kthehet kujtesa/ e ujut." Melankolia", Fq. 67.

Mesazhi i kësaj poezie është shumë i qartë: Është kujtesa ajo që ndriçon rrugë bëren tonë.

Sikur çopoet, që është në kërkim të një bote jo vetëm më të mirë, por edhe ideale. domosdo që është edhe në natyrën krijuese të poetit H. Matoshi, të cilin synim e shpërfqagë bindshëm në poezinë "Sy që keshin -I-/ ku thotë: /Sytë që keshin/janë shteg /nëpër të cilin i bijnë yjet /Derisa të shtymën/. Po aty, fq. 16.

Edhe pse këtij idealiteti poeti nuk i rikthehet asnjëherë në mënyrë të drejt-përdrejtë, poezia në fjalë është dhembetet drita më vezulluese, e kërkimit të kësaj bote, si dhe besimit në të botë, edhe pse së duket, yjet do të vazhdojnë të shtymen larg e më larg dhe fare të pavarëjtshëm nga ne, për shkak të, të dhimbjes, për shkak të mungesës së buzëqeshjes në Sy. Ky nuk është vetëm diskurs, nuk është

as vetëm mesazh, apo èndërr poeti. Është shumë më tepër, është besim. Besimi nuk është e thënë apriori të vërtetohet, pas besimit shkohet, dhe pikë. Në një farë mënyre sikur e le lexuesin të angazhuar në këtë idealitet. Asocionon me vargun e Shopenhauerit të kërkimit të një bote ideale; "Një Botë ku muzika, drita e hënës dhe ndjenja të jenë një."

Krejt në fund libri "Poema për Lilin", është libër i veçantë, përfaktin se autoria ka dalë mbanë të ligjeroj me mëvetësi artistike për trajtë e shumëfishuara të dhimbjes duke e vendosur atë në kontekste të ndryshme; individuale, kohore, tekstuale dhe intertekstuale, gjithnjë me një dendësi figuracioni.

Duke u nisur nga fakti se vargu i H. Matoshit përmban gjithashtu nuancime të fortë të natyrës filozofike, e kësaj kur t'i shtohet edhe fakti i ligjërimit dramatik që e arrin sukseshëm poeti, jo vetëm në "Poemën për Lilin", por pothuajse në pjesën dërrnues të librit, mendoj se këto veçori e bëjnë një poet të mvetsishëm me një identitet tashmë të formuar artistik.

Rilexime

"MOS MA TRAZONI VETMINË" E LAZËR RADIT

Poezia, si art, mbetet frymë, mbetet palcë dhe për një komb mbetet èndërr nga ku ngjizet e ardhma

Rei F. HODO

Nëse çfarëdolloj gjëje mund të jetë aksidentalishët një shkak i mundshëm shprese ose frike, tek uni i L. Radit ato janë padyshim shkak i dëshirës për liri, për vetëbesim dhe universalitet. Ndërsa mund të kalosh ndër duar veprën "Poetika", në përbajtje të së cilës gjenden "Muret e muzgut", "Shpresa vdes e fundit" dhe "Anzave të Sharrit", do të mund të përballesh me një njeri të veçantë, me një kriesë, një qenie që ngjashmërisht nuk është dhe nuk mund të jetë e njëllojtë me asnjë tjetër sepse mbetet vërvetja, ajo çka është palcë humane. Autori e fton lexuesin nëpërmjet vargjeve të tij të bëhet pjesë e një sfondi muzikaliteti të pashqoqë, të nxitur nga dëshira e jetës, e lirisë dhe e dijes. Ngase është Kant ai që na bind se "Vetëm prej një edukimi të shëndoshë lind çdo e mirë në botë. Kurre nuk duhet t'i edukojmë fëmijët në funksion të nivelit të tanishëm, po në funksion të gjendjes eventualistik më të mirë të mundshme për humanitetin, domethënë se duhet mbajtur parasysh ideja e humanitetit dhe e fatit të tij universal."

Tek L. Radi gjen të jetëzuarë më së miri fjalët e A. Pipës, sipas të cilit "Kanë prangosur trupin tim por nuk kanë mundur të prangosin mëndimin tim. Dhe - gjë vërtet e mrekullueshme - kur trupin tim e kanë bërë pothuajse një kufomë, atëherë mendimi ka fituar lirinë." Në këtë moment, na vjen në ndihmë vetë poeti ku nën lëkurën e një kalorësi ai tenton horizontin: "Kalorës i Jetës./ kalorës i jetës./ vraponte qiejve/ me kalin e shpresës". Lazër Radi guxon të



thyejë lëvozhgën e mendimit të tij, guxon të nisë fluturim këtë mendim.

Së dyti, në gjithë atë çfarë përfaqëson, poeti, fillimisht, vepron dhe më tej mendon. E bën këtë duke e parë mendimin as më pak e as më shumë si pasardhësen e veprimit. Thënë ndryshe, e sheh mendimin si vendosjen e reales në horizontin e së mundshmes. Kjo, më së miri duket në vargjet si vijojnë: "Andrra m'shyntë përpara/ guri n'shpirt m'randonë,/ njomza ma mbronte dëshpërimin/ e ura më kalonte ku s'mundja. Gjithashtu, gjurmë të parashtrimit të sipershënuar mund të gjejmë edhe tek vargjet e mëtejme: "Jo, s'ishin gjurmët e kambve të mia,/ gjurma mendimesh ishin/ i lexonin veç dallgët/ e nji për nji thellësive/ ua nisin....

Në debatin midis vetes dhe së vërtetës, poeti ia del të fitojë atë. E

arrin duke e parë dhe pranuar atë para së gjithash si personale, si të tijën, duke e konsideruar si fitore të një personi njerëzor, si njerëzore. E poeti na mëson se "Kjo kala s'ka m'u rrzuje kurrë:/ e mbajnë gurtë lidhë në besë/ e mbajnë kreshtat rrokë për qiell/ e mban shpirti kallë n'shpresë/ e mban stralli zjarr nén shtresë... duke vijuar për ta betonizar të vërtetët e tij në këto vargje: "Ngjeshë mbas kalasë,/ qëndroni si shkamb ngulë,/ kohnat as mënxyrat/ s'mbrrijnë dot me e zhgulë. E mbi të gjitha duhet kuptuar se e vërteta njerëzore është e vërteta e një vlere, e vërteta njerëzore është një terti harmonike e çdo vlere.

Lazër Radi poet e më së pari njeri, nuk mjaftohet vetëm duke jetuar, por ngjeshet pas arsyesh më të lartë, ndërgjegjes më të lartë për të zotëruar kuptimin e jetës duke, paraprak-

isht, e pranuar se është e denjë për t'u jetuar e më pas për të përcaktuar vlerën e saj. E në këto hudhë, poeti shprehet: "E s'di,/ ma parë m'duhet me lindë,/ apo të vdes." (fq. 43). Në shëtitjen nëpër vargje mund të krijosh udhë të gjata, udhë të cilat duket se shërbijnë si copëza për atë, universalen, për shpirtin, për rezultantet e veprimit në jetë. L. Radi na shprehet se "Eci në bregun e zbrastë/ pa e dijtë ç'kérkoj/ në bregun e zbrastë/ ku andrra e gjurmë, n'rancë flenë bashkë..." (fq. 44). E në jo pak raste, poeti gjen fuqinë t'i drejtohet dhe me shpresë të marrë përgjigje prej Zotit duke iu lutur: "O zot, o na merr/ kështu mos na len gjallë." (fq. 46).

Sipas Visar Zhitit, "pozitë janë një mozaik i bukur, tronditës, nën baltën e kohës që iku." Ato nuk mbeten vetëm këq. Ato kanë unin e poetit si shëmbëlltyrë të çdo vargu, mbështeten fort pas njëri-tjetrit dhe ia dalin të krijojnë jo një por disa dhjetëra nyje pazgjidhshëmërisht të zgjidhshme.

Poezia, si art, mbetet frymë, mbetet palcë dhe për një komb mbetet èndërr nga ku ngjizet e ardhma. Sikurse edhe vetë poeti, në fragmentin "Lindi kombi" parasht-ron krijimin e një jete të re duke e vendosur ngjarjen midis harmonisë, valles, melodisë e këngës së rapsodit mbi lahitë, në poezinë e tij, Lazër Radi krijon një komb të ri, kombin që del prej dhimbjes që "me vesë mëngjesi ndër grushte, me flakë rrrezesh n'zemër/ muret e muzgut i çava." Lazër Radi ia del ta mundë shtypjen, ia del të kremitojë mbi të fitoren e tij, fitoret e tij e duke i bekuar këto të fundit, ai arrin edhe tek hyjnorja.

KUFIRI MES REALES DHE LEGJENDËS


(Rreth poezisë së Bekim Muhaxherit)

Zyrafete SHALA

Ndër ata pak krijues të viteve të fundit që kanë kultivuar vargun poetik për dekada me radhë, por që nuk e kanë pasur prioritet botimin e shëtë edhe poeti ferizajas Bekim Muhaxheri, me profesion gazetar, që zgjodhi të dilte para lexuesve si poet i formësuar. Sado e thjeshtë në dukje, një qasje e tillë e shëtë e rrallë për kohën tonë, kur janë të pafundme tendencat për ta përdorur poezinë përfshirë qëllimi tjetër, por jo për të shprehur një emocion fisnik, si qëllim parësor i saj. Se prej nga buron ky relacion i veçantë me poezinë te Bekim Muhaxheri, nuk duhet shumë mund për ta kuptuar sapo të lexohet cilado poezi e tij; e shëtë përgjegjësia e lartë ndaj fjalës së shkruar që e bën të veçantë jo vetëm Bekimin si krijues, por edhe vargun e tij si krijim. Kemi të bëjmë me një poet të vetëdijshëm për kufirin ndjeshëm mes shkrimit dhe krimit, përgjegjësi kjo që e shëtë brumosur me kohë dha që vihet re në të gjitha poezitë, të përfshira në vëllimet Ëndrrat bëhen pranga (Koha Print, 2020) dhe Në zemrat tona dimri ka mbetur (Armagedoni, 2021). Vëllimi i parë, Ëndrrat bëhen pranga, përfshin varjet e krijuara në një periudhë të gjatë kohore, në mosha të ndryshme të autorit dhe rrjedhës, edhe me forma të ndryshme të reagimit ndaj realitetit. Vështruar nga momenti kur Bekimi ka vendosur të dalë para lexuesve, poezitë e tij nga njëra anë mund të shihen si përbledhje e përvjave dhe përfjetimeve jetësore individuale, ndërsa në anën tjetër edhe si mënyrë e perceptimit të botës nga një subjekt poetik i mbrujtur me kujtesën kolektive kombëtare.

Gjerësia kohore e krijimit të poezeve të këtij libri, rezulton me shumëlojshmëri temash e motivesh, që ngërthejnë jetën si tërësi; por edhe preokupimet e njeriut, i cili duke qenë déshmitar i ngjarjeve e kthesave të mëdha, merr përsipër t'i përfjetësojë ato në vargje. Në tetë ciklet e këtij vëllimi, ku poezitë janë ndarë në varësi nga temat që trajtonë, gjejmë të ndërthurur realitetin me të kaluarën, qoftë me të kaluarën historike, si në ciklin Histori apo me trashëgiminë shpirtërore si në ciklin Legjendat, kategori këto, gjurmët e të cilave i mbart në vete çdo pjesëtar i popullit që ëndrra iu kthye në makth (Të lidhur me lidhjen, f. 20). Prandaj, shpalosjen e unit të tij lirik, autorit e nis pikërisht duke iu kthyer të kaluarës, që nga kohërat antiqë e deri më tani. Mirëpo, ky kthim nuk ka si qëllim vetëm riprodhimi i faktave tanimë të njohura, ai kthehet për të dialoguar me shekujt, për t'i rishikuar vuajtjet, për të gjetur arsyet e tyre dhe për t'i mëkuar vragët që ato kanë lënë në kujtesën kolektive e individuale. Doemos, në mesin e plagëve të mbeturë e të pambyllura janë edhe ato të luftës 'mesjetare' të zhvilluar në kohët moderne, me eksodin biblik dhe kthimin, por edhe me dhimbjen për jetët e këputura, nga ato që u futën në histori, apo të tjera që mbetën pezull mes dy botëve.

Në rrugëtimin lirik që autorit e bën nëpër kufirin mes reales dhe legjendës,



shohim se përmbrasat e kohës që po e jetojmë na ofrojnë një perspektivë tjetër të vlerësimit të trashëgimisë kulturore kombëtare, ku tani na shfaqet e përbysur çdo gjë, madje edhe frazeologjitet, edhe mitet e legjendat: Qengji i urtë më s'i thith dy nënë / Mbetet pa thithur / Çdo gjë po ndryshon / Vetëm njeriu për njeriun / Vazhdon të jetë ujk (Ndryshim dhe njëjtësi, f. 30). I gjendur mes një përbysjeje të tillë vlerash, njeriu e ka të vështirë të ndjekë transformimet aktuale, të gjej një kod moral që do t'i përshtatet trendit të kohës dhe kërkesave të tij. Në poezitë e tjera autori duke reflektouar mbi realitetin e përditshëm, fokusohet në sekuenca të veçanta të dukurive të zakonshme, duke shpërfaqur idenë se kjo kohë që refuzon të ndjeshëm mitik të jetës, e shëtë kohë e njeriut të zakonshëm, jo e heronjve dhe e madhështisë.

Përsiatjet rrith natyrës dhe ligjshmëri të saj, ashtu si edhe përsiatjet mbi jetën, vdekjen dhe dashurinë, janë një segment i veçantë në universin poetik të Bekim Muhaxherit. Metamorfozat e natyrës në soditjen e poetit shpesh marrin trajta befasuese përmes figurës së personifikimit: Vjeshtës i bie të fikët / para vdekjes / dhe dimri pastaj / vetëm hedh mbi të / qefin e vdekjes (Vdekje e vjeshtës, f. 54). Ndërsa jeta, që në këndvështrimin e autorit mund të jetë aq e thjeshtë, komplikohet vetëm nga tendencat e njeriut për të dominuar apo për t'u qenë në qendër të universit. Derisa krijesa të tjera më të thjeshta, si pëllumbat, na mësojnë artin e të lartësuarit përmes dashurisë, njerëzit synonjë të arrijnë atë me ngrehinat e larta, përmes të cilave në fakt vetëm e thellojnë inferioritetin e tyre. Paradokse të tillë përgjatë rrugëtimit nëpër kohë sjellin në një çast kur doemos kërkimet mbërrijnë përparrë dilemave fondamentale të jetës, përparrë ridimensionimit të koncepteve të vjetra të lirisë, shpresës e dashurisë që shpalosen varg pas vargu nga autorit.

Vëllimi i dytë Në zemrën tonë dimri ka mbetur i botuar një vit pas të parit,

solli poezi të krijuara gjatë periudhës kur bota u trand nga pandemia dhe kur njerëzimi që pandehte se tanimë kishte arritur kaherë ta mbizotërojë natyrën, u spraps nga një gjallesë mikroskopike. Nga një këndvështrim i tillë e kundron edhe poeti këtë situatë në poezinë Planet i pabesë ku shprehet me një dozë cinizm: Nuk mund të themi / "Ky e shëtë një hap i madh për njerëzimin"/ Siç thamë kur u lëshuanë në Hënë / Nëse jashtëtokësorët ekzistojnë / Po qeshin diku në hapësirë / Me planet tona / Për të zbritur në Mars (Planet i pabesë, f. 19). Mirëpo, nuk e shëtë kjo tema e vetme që i përshkon poezitë e këtij vëllimi, përkundrazi, secili nga dhjetë ciklet shtjellon tema dhe motive të ndryshme, por që të gjitha janë reflekse ndaj jetës, botës, njerëzve dhe realitetit që e krijojnë atë. Eshëtë vështirë të thuhet se poezitë e cilit cikël janë më të realizuara, sepse poeti Muhaxheri jo vetëm ka investuar emocion dhe mjeshtri në secilën prej tyre, por edhe i ka trajtuar ato me një qasje kryekëput origjinale.

Në ciklin Shkretëtirë autori i qaset relacionit mes kohës dhe të jetuarit; sa më shpejt që rrjedh koha aq më intensive bëhen përpjekjet e njeriut për të vrapuar pas saj (apo dëshira për ta arritur atë), për t'i lënë prapa të tjerët, për t'i arritur lartësitë dhe vonë, shumë vonë e kuptojnë se në fakt gjatë tërë kohës vetëm sa kanë rrëshqit: Në greminat e jetës së vogël / Të përditshme / Si zogj të vrarë / Pa e provuar më ecjen përparrë (Egoizëm, f. 37). Ky mashtrim që njeriu i bën vetës gjatë të ngarendurit pas kohës, e bën që të harrojë procesin e të jetuarit: Nganjëherë duhet të shkundi / Nga qishtat e këmbëve te majat e flokëve / për ta kuptuar se jemi gjallë (Heqje pluhuri, f. 53). Harrimi i vetes doemos sjell në shëmangje nga esenca e qenësisë së llojit, prandaj: Eshëtë koha të qëndrojmë në tokë / E të mësojmë nga kafshët e bimët / Si të jemi njerëz (Heqje pluhuri, f. 53). Ndërsa në ciklin Pronarë lirie autori i bën një radiografi lirisë njerëzore apo asnjë ne e quajmë të tillë, pa çka se aty hyn edhe liria për të

shpikur e përdorur armët më shkatërrimtare ndaj njëri-tjetrit, liria për të vrarë, për të përdorur helme kimike, për të shkatërruar planetin, lirinë, për ta kthyer në ferr të vetmen jetë që patëmundësi ta jetonim si njerëz në tokë. Prandaj poeti nuk ndihet rehat në kohën e tij: Për vete do të doja / Kthimin prapa / në një kohë tjetër / Për ta gjetur dhe zhbërë / Çastin kur zumë në thua / Derisa po ecnim nëpër mjegull (Shpallje, f. 71). I vetëdijshëm se shqetësimë të tillë kanë pasur edhe shumë njerëz përparrë tij, në kohë të ndryshme, madje shumë prej tyre edhe janë sakrifikuar në rrugën e kërkimit të së vërtetës, ai u bën homazh atyre me vargjet: Ende nuk kemi asnë mjet / Për zbulimin e eshtrave / Të të pushkatuarve / Pa gjyq e pa varr / Anekënd globit / Mund të na dalë shumë punë / Por ndoshta duhet të gjermojmë / nën se cilën lulëkuqe.

Padyshim, poezitë më të ngarkuara emocionalisht janë ato të ciklit të parë, Gjumë pa zgjim, të cilat autori ia dedikon vëllat të ndjerë, llirit, portretin e të cilit e ghind mjeshtërisht në poezinë Turbull me ngjyrime të fuqishme elegjike: Buzëqeshje do të ketë / Por jo si jotja / Me ata sy që bëheshin diej të vegjël / E shpërndanin rreze dashurie... Ëndrra do të ketë / Por jo si jotja / Për të ecur / Për t'u ngritur në këmbë / Embajtur aq gjatë brenda (Turbull, f. 11). Paralelizmi mes figurës së vëllait dhe Gjergjej Elez Alisë në poezinë Vertikale, e shëtë një gjelje e jashtëzakonshme, që përban në vete edhe një akt rebelimi ndaj simboleve të kishetizuara mitike, qofshin ato simbole të vuajtjes apo të heroizmit, përdorimi i të cilave sikur i lë në hipe përfjetimet e stërmundimshme të jetës së përditshme. Klithma e poetit që në vargun e parë: Gjergj Elez Alisë nuk ishte asgjë / Përbullë teje (Vertikale, f. 13) e përgati lexusin për krahasinët vijuese mes dy figurave, për shpërfaqjen e virtuteve të njeriut që jeta e vuri përparrë një sprove të rëndë, por ai mbeti njeri: Ti nuk shkele asnë buburec / Gjysmë shekulli i lidhur për karron me rrata / Kurrë nuk u ngrite në këmbë / Por askush nuk jetoi / Më vertikalish se ti (Vertikale, f. 13).

Me një përkushtim dhe përgjegjësi të lartë ndaj fjalës e krijimit, me shtyqjen për të depërtuar në misteret e jetës, me durimin për të lëmuar në vijimësi stilin, me shprehjen e kultivuar dhe thellësinë e mendimit, Bekim Muhaxheri hyn në leturat shqipe me hap të sigurt dhe me synime të qarta për të ofruar kontributin e tij, në momentin kur rikthimi i vlerave e shëtë çështje prioritare në letërsinë tonë. Tani kur fjala e shkruar nëpërkëmbet pa mëshirë, shpeshherë duke mos e marrë mbrojtjen e duhur as nga individët e as nga institucionet që do të duhej të përkujdeseshin për të, vetë respekti ndaj saj e shëtë vlerë. E kur ky respekt gjështetohet edhe me lëndën e pasur të përpunuar nga një pendë me dhunti e pjekuri krijuese, atëherë mund të thuhet se lexuesi ka në duar dy botime serioze me poezi nga një krijues i kultivuar që prenton të bëjë edhe hapë tjetër të suksesshëm në terrenin e vështirë të poezisë shqipe.

RUAJTA E NJERIUT TE VETJA

(Shënim për tregimin e Dino Buxatit "Te mjeku")

Vzedin HIMA

Tregimi i Dino Buxatit "Te mjeku" është një tekst me të gjitha shenjat e estetikës së realizmit magjik, drejtim letrar ky i praktikuar nga shkrimitarët e Amerikës së Jugut si Miguel Anhel Asturias apo nobelisti Gabriel García Márquez. Në tregimet e tjerë të Dino Buxatit estetika e realizmi magjik si metodë letrare është më e pranishme se sa te ky tekst. Pikërisht, përvaja e gjatë si gazetar e Buxatit ka bërë që te ky tregim të kemi një lloj hibridizimi të tekstit. Nga fundi i tij të ndeshim kalimin nga një tekst me funksion estetik, në një tekst eseistik. Me gojën e personazhit të doktorit, Buxati artikullon disa mesazhe në mënyrë të drejt-përdrejt. Rrëfimi është në vetën e parë. Kjo formë rrëfimi e bën tekstin më tërheqës dhe siguron vëmendjen maksimale të lexuesit. Emri i rrëfyesit shfaqet disi vonë, në fund të tregimit. Ai quhet Enriko.

Teksti nis në formën e një bisede të thjeshtë: "Shkova te mjeku për vizitën e kontrollit semestral, zakon që e ndjek që kur mbusha dyzet vjeç. Mjeku është një mik i vjetër imi, Karlo Tratori."

Enriko ndihet shumë mirë me shëndet, por e përgatit lexuesin për enigmën që fshihet me pëershkrimin e pasdites kur ndodh ngjarja: "është një pasdite e pabesë, e mjegullt vjeshte, pas pak duhet të zgresë mbrëmja."

Në pamje të parë, rrëfyesi e vesh me një tis mjegulle enigmën që do të zbulojë: "Sapo futem, Tratori më vështron në një fare mënyre dhe buzëqesh: -Ti deni përmes kur ndodh ngjarja: "është një pasdite e pabesë, e mjegullt vjeshte, pas pak duhet të zgresë mbrëmja."

"është e vërtetë. Nuk mbaj mend të keni qenë ndonjëherë më mirë se tani."

Enriko rrëfen më poshtë se te mjeku shkohet zakonisht kur ke shqetësimi, ndërsa ai sot ka shkuar pikërisht se ndihet shkëlqyeshëm, në një farë mënyre përmes kur ndodh ngjarja: "Ndihem shkëlqyeshëm, ndjej një ngazëllim të ri, thua jse hakmarrës përparrë Tratorit."

Po pse ndihet pak hakmarrës Enriko?

Sepse që paraqitur "i zhveshur" para mjekut, të cilit kurrsesi nuk mund t'i fshehim dobësitetona fizike apo shpirtërore. Mjeku e kishte njohur personazhin tonë, sikurse ai rrëfen, "...gjithmonë si një nevrotik, të trembur, të kapur nga ankthet kryesore të shekullit...Nuk më përsëriten më synime vetëvrasëse, gjatë zgjimit në mëngjes, teksta filtron përmes grilave të tendës dritha funebre e zgjimit metropolitan."

Dialogu midis doktorit dhe Enrikos nis i thjeshtë përmes njësuar me shkëpiriane:

"A ka nevojë të vizitoj? - më pyet Tratori. Kësaj here do paguhem pa e



merituar, vetë e kërkove." Pastaj Enriko tregon me intesi diagnostikimin e kujdesshëm të doktor Tratori, matjen e tensionit, dëgjimin e zemrës dhe mushkërive. Doktori e pyet përfisimet e mëparshme, ankthet, manitë, përjashtimin dhe izolimin nga të tjerët, alienimin e tij të famshëm, bezdinë përtë vozitur me makinë, ndjekjen e Tv. Doktori ka një shqetësim të dukshëm në fytyrë, tekxa merr përgjigjen se pacienti i tij ka ndryshuar krejtësisht, është bërë më i hapur dhe më i përfshire me shoqërinë, është çliruar nga të gjithë makthet, pasiguritë, fiksimet. "Sikur të jem tjetër njeri"-shprehet Enriko. Pas një sërë pyetjesh, Enriko fillon të shqetësohet. "Mos vallë doktori ka zbuluar ndonjë sëmundje të fshehtë vdekjeprurëse?" Doktor Tratori sa vinte e bëhej më enigmatik.

"Je më i lumtur tani se më parë?" - vazhdon serine e pyetjeve doktori.

"Po, sigurisht që jam shumë më i qetë tani" - përgjigjet Enriko i shqetësuar.

- Por, a s'më tregon "përse-në" e gjithë këtyre pyetjeve?"

- Do të dish se c'të ka ndodhur?

- Atë që më ka ndodhur? Më ke gjetur diçka që s'shkon?

- Një gjë të thjeshtë fare. Ke vdekur.

Dialogu ka arritur nivelin surrealist. Enigma sa vjen dhe zbulohet. Pikërisht pas konstatimit të vdekjes, rrëfyesi shfaqet me emrin e tij. Ai e di mirë se doktor Tratori nuk është njeri i shakave, sidomos në studion e tij mjekësore. Dialogu sa vjen e bëhet më absurd:

- Kam vdekur? - belbëzoj unë. Si kam vdekur? Një sëmundje e pashërueshme?

- Po qfarë sëmundje thua. Nuk të thashë që ti duhet të vdesësh. Thashë vetëm që ti ke vdekur.

- Pa kuptim kjo! Po ti vetë më the më parë që jam portreti më i mire i shëndetit?

- I shëndetshëm, po. Plotësisht i shëndoshë. Por i vdekur. Je përshtatur tashmë, je bërë pjesë, je homogjenizuar, je njësuar me trup e shpirt rënë rrethin shoqëror, ke gjetur ekuilibër.

qetësi, siguri. Dhe kjo të bën kuformë.

- Ah, falë Zotit! E gjitha kjo një metaforë, një kuptim figurativ. Për pak më pushoi zemra nga frika.

- Jo dhe aq figurativ kuptimi. Vdekja fizike është një fenomen i përhershëm, e tek e fundit, në thelb jashtëzakonisht banal. Por ka një tjetër vdekje, që ndonjëherë është akoma më e keqe. Anulimi i personalitetit, varësia imituese, kapitullimi ndaj mjedisit, heqja dorë nga vvetjet... Hidh një sy rrëth e përqark. Bisedo me njerëzit. A nuk e vë re që janë të vdekur gjashtëdhjetë përmindës?

Dhe nga viti në vit numri shtohet. Të shuar, të zbehtë, të bindur. Të gjithë dëshirojnë të njëjtat gjëra, bëjnë të njëjtat diskutime, të gjithë thurin të njëjtat mendime. I pështirë ky qytetërim masiv.

është një dialog tipik ekzistencialist. Autori, nëpërmjet zëdhënës së tij, doktor Tratori, shfaqet si humanist i pashermbullt.

Nëse kemi parasysh esenë e njohur të Zhan Pol Sarrit "Ekzistencializmi është humanizëm", doktor Tratori (autor), me përfundimet e tij shpreh një ndijesi të thellë keqardhjeje përmindës, të cilët po humbasin vvetjet përmindës, të shkak të dhunës që vjen nga shoqëria dhe modifikon çdo individ sipas shijeve të saj, duke e zhveshur nga të gjitha tiparet individuale. Pikërisht, ky modelim i njeriut është përcudnimi i tij, çnjerëzimi i individit dhe formimi i turmës me njerëz parafabrikatë apo njerëz tulla, që stigmatizon artistikisht kënga e famshme e Pink Floyd "Another brick in the wall" (Një tjetër kullë në mur).

Doktor Tratori nuk kujdeset vetëm për shëndetin fizik të pacienteve, por edhe për shëndetin shpirtëror dhe atë të personalitetit të tyre.

Enrikoja është artist, skulptor. Për të hedhur poshtë përcaktimin e doktorit, Enrikoja sjell këtë argument: "Po, atëherë, nëse kam vdekur, si e shpjegon që nuk kam shitur asnjëherë më shumë sesa këtë vit skulpturat e mia? Po të isha i squllur siç thua ti..."

Doktori e ka gati përgjigjen e tij: "Jo i squllur. I vdekur. ... Dhe në lidhje me

skulpturat e tua, është pikërisht suksesi që ke sot, që dikur nuk e kishe, që tregon se je i vdekur. Je një trajtësuar, ke marrë përmasa të njëjtë, je përditësuar duke ndjekur hapin e turmës, i preve gjembat, i ule flamujt, hoqë dorë nga çmenduria, nga rebelimi, nga iluzioni. Dhe prandaj tanë i pëlgjen publikut të madh, publikut të madh të vdekurve."

Doktor Tratori, veç ekspertizës si mjek, si sociolog, na shfaqet edhe si estet. Në këtë pjesë të tregimit kemi hibrizimin e tij, përzierjen e tekstit letar me tekstin eseistik. Në të njëjtin tekst të tregimit shfaqet shkrimitari dhe gazetari. Dino Buxati, në një rast është shprehur se përmendimin e tij gazetaria nga shkrimitaria nuk ka kufij të qartë. Argumentimi i tij përmendimin e tij gjithë së përfundon e Enrikos si njeri dhe si artist është rrethuar interesant. Vdekja e njeriut ka sjellë si rrjedhojë edhe vdekjen e artistit. Modelimi i tij nga shoqëria, duke i rrafshuar individualitetin, ka sjellë një sinkron të shijeve të tija artistike me shijet e turmës. Skulpturat e tij prodhohen si nevojë e turmës përmindës, që ajo shijon. Nëse krijuesi, artisti do të ndjekë shijet e turmës, ai shpejt do të vdesë si artist. Artisti i vërtetë krijon shije të holla dhe të epërmë artistke te bashkë-kohësit e tij, krahas veprës, krijon edhe shijuesin apo lexuesin e saj.

Në përgjithësi artistët e shquar kurrë nuk janë kuptuar dhe shijuar nga bashkëkohësit e tyre. Piktori i madh Visent van Gogh shiti vetëm një vepër në gjallje të tij me çmimin qesharak prej katërindësh frangash. Sot veprat e tij shiten në dhjetëra apo qindra milionë dollarë përmindës.

Pamja e krijuar nga doktor Tratori është tejet e zymtë, por që i shërbën tragjikisht tablosë së botës së njëmendës së tij, kohës së sotme. Rrafshimi i shijeve estetike, njëjtësimi i modelit të tij ushqyerit, të veshurit, mënyrës së tij jetuarit, operacionet plastike duke vrarë fytyrat e krijuara nga Zoti, duke krijuar dy tre fytyra në modë dhe duke zhdukur miliona fytyra të bukura, janë pamje të shkullit XXI. Ajo që është edhe më tragjike, është rrafshimi i mendimit, krijimi i modeleve klishe të tij menduarit, janë vdekja jo artistike, por reale e njerëzimit të sotëm. Leximi i këtij teksti është tronditës. Arti i nyjëtimin të tekstit i pazakontë, punë mjeshtri. Tregimi në fund të tij ka një dialog-epilog domethënës:

- Po ti, atëherë? - e pyes i tërbuar. Si ka mundësi që nuk flet përmindës?

- Unë? - tund kokën doktori. - edhe natyrish. I vdekur. Prej shumë vitesh, si të rezistoja në një qytet si ky yni? Kuformë edhe unë. Veç më ka mbetur një...spirale. Nga kryeneçësia profesionale, mbështetje... një spirale nga ku mundem të shoh, - përfundon doktori dhe dialogu në këtë tregim.

Tregimi si ky i Dino Buxatit, krahas kënaqësisë estetike, na ndihmojnë të njohim veten dhe të tjerët, na ndihmojnë që, edhe me shpirt ndër dhëmbë, të ruajmë njeriun te vetja në një botë që sa vjen e çnjerëzohet.

"Procesi" i Kafkës

DEFINICIONI I NJERIUT NË UDHEKRYQ

Njeriu, në veprën e tij, nuk vjen thjesht dhe vetëm si një qenie e pushtuar nga e keqja; autori di që në mënyrë tepër fine të apelojë për njohjen e vvetvesës dhe përpersosjen e jetës, së pari individuale. Këtë ai e bën nëpërmjet një simbolike që josh brenda kompleksit krijues

Majlinda RAMA

Franz Kafka, lindur në Pragë të Austro-Hungarise, sot Republika Çeke, është padyshim një nga shkrimitarët e padiskutueshëm që i dha prozës së gjatë një tjetër ritëm. Edhe pse jeta e tij krijuar një kështjellë të re perceptimi mbi ekzistencën e njeriut. Kafka u bë autori më original, origjinalitet që lexohej njësoj në të gjitha vendet e botës e përkthehej në realitet bashkudhëtues i çdo shteti, qyteti apo regjioni. Përshtrimet, idetë, qasjet, sjelljet hapur e pa korniza zbuluruese, do të tundnin themellet e memories botërore në shek. XX.

Romani "Procesi" u bë shtylla kryesore ku do të mbështeteshin më pas dhjetëra autorë e që do të studiohej me etje nga kritikë e studiues. Kjo vepër u botua në vitin 1926, dy vjet pas vdekjes së autorit nga miku i tij (sekretari) Maks Brod. Ky i fundit e përgatiti vëtë librin për botim, megjithëse Kafka kishte kërkuar që ai, romani, dhe shumë të tjera krijime të tij, të digjeshin, të zhdukeshin. Brod, ndër të tjera u deklarua se vetë autori e konsideronte në fakt të papërfunduar, pasi romani në formë dhe përbajtje ishte tërësisht i mbyllur dhe, për këtë, ai do të shprehet: "Kur mora dorëshkrimin e 'Procesit', e lexova me një frysë. Nuk kishte titull, por Kafka kështu e quante sa herë binte fjala për të. Këtë libër, vetë Kafka e quante të papërfunduar, pavarësisht se e kishte kreun e fundit. Ai mendonte se duhej të shtonte disa anë të tjera të atij procesi misterioz. Por, megjithatë, po të mos e dija se Kafka ka pasur ndërmend ta vijonte punën me këtë roman, unë nuk do të gjeja asnjë mangësi në të". Kafka, edhe pse vetëm 41 vjeç (vdekja), ka njohur mirë funksionimin e jetës në një realitet të zyrtë. Ai, në mënyrë gati-gati të frikshme, paraqet një tablo të qartë ku njeriu hidhet në luftë me drejtësinë.

Në sinops i "Procesit": Jozef K., një nëpunës banke në një qytet thuajse të panjohur, një njeri në kufijtë e së rendomtës, arrestohet një mëngjes nga dy policë. Akuzohet për një krim, por që nuk i bëhet me dije as vetë të arrestuar dhe as lexuesit. Ndaj Jozef K.-së nuk ka një akuzë të përcaktuar, si dhe cfarë krimi ka kryer dhe procesi i tij mbetet pezull. Në pritje të asaj që do të ndodhë më pas, Jozef K. njeh funksionalitetin e një sërë komponentëve, që nga format absurdë të gjykatave, hierarkinë e posteve dhe mekanizmat vepruese. K. imagjinon marifete nga më të dëshpëruar, që zbulojnë para tij ingranazhe të pakuptueshme dhe mbytëse. Ai nuk di kujt t'i besojë, kështu që ulet vetë të përpilojë mbrojtjen e vet në të cilën kërkon falje për cdo gjë që ka bërë, duke firmosur, në këtë mënyrë, aktin e fajësisë dhe dënimin e vet. Në fund, atë e vrashin dy policët që e kishin arrestuar në fillim. Jozef K.-në e vrashin "si një qen" dhe me këto fjalë, me të cilat



personazhi përcakton veten, mbyllët libri.

Njeriu, në veprën e tij, nuk vjen thjesht dhe vetëm si një qenie e pushtuar nga e keqja; autori di që në mënyrë tepër fine të apelojë për njohjen e vvetvesës dhe përpersosjen e jetës, së pari individuale. Këtë ai e bën nëpërmjet një simbolike që josh brenda kompleksit krijues.

"Josef K. jetonte në një shtet ligjor, kudo mbrerëtore paqja dhe në fuqi ishin ligjet. C'ishin ata që guxonin ta canonin në shtepi e tij?". Mjafton t'i referohemi këtij fragmenti të romanit, për të bërë një vertikale të përbajtjes e tematikës përmes penës së ashpër e fshikulluese të autorit. Në një realitet të rraskapitur, ku njeriu i thjeshtë, i mirë e pa shumë pretendime, përbaltet, përbuzet, denigrohet deri në marjen e jetës. Kjo është një skenë e dhimbshme, por njëherësh edhe ironike, sa vetë kauza për të cilën lufton vepra kafkiane.

Po ashtu, sikurse është lënë e hapur edhe më herët, mundësia e një përthyerje teologjike brenda "procesit" është gjithmonë prezente. Në tërësi, tezat themelore fetare apo doktrinat fetare janë një element i logjikës për një jetë më të mirë në të përtejmen; "belbëzoi K. dhe iu duk sikur trupi do të mbijetonë edhe pas tij", shprehet Kafka në qastin e fundit të jetës së personazhit të tij.

Pra, ajo që ndoshta e mundon Kafkën, është mosbindja e rregullave fetare, që sillte edhe pasoja dhe, pikërisht për këtë, ai ngre krye duke mbrojtur tezën se qenia njerëzore është qenie njerëzore dhe jo të gjithë i njohin këto rregulla e kuptojnë këtë logjikë ligji.

Kështu, K. parashtron historinë e një individu si trashëgues i mëkatit, që dëbohet pamëshirshëm nga Paraaja a për t'u nënshtuar pasojave si mëkatar i ligeve burimore. K-ja nuk gjen asnjë shpëtim, nuk di dhe as i thotë kush se ç'faj a krim ka bërë. Tek ai vepron tanimë ndëshkimi kolektiv, si e mirë e përgjithshme. Ky paradox nis si dramë-dyshim dhe mbyllët si tragjedi e fatit njerëzor.

Fakti që Kafka ishte me prejardhje çifute, bëri që ai të kthehej në një prijës i fatit njerëzor të popullit të tij, gati-gati në parashikues... K., ky qytetar i ndershëm e nëpunës banke, duket se po

pushtohet e po anatemohet nga forca të errëta që as ai e askush tjetër nuk do të mund t'i përcaktonte apo t'i sillte si trajtë, për të gjetur me tej një zgjidhje. Problemi me njeriun që dergjet pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, nuk vjen thjesht si një e keqe për popullin e Kafkës, por për të gjitha qeniet e rruzzullit, të cilat do të përjetonin parallelisht dhimbje të formave të ndryshme. Kafka, më shumë se kushdo, do të duhej të shkruante jo për t'u bërë divert, por për të përshkuar me transparencë letrare e reale atë që shihej në sfond me fakte tronditëse e me fate të destinuara të shuheshin, përdiqeshin e shpërndasheshin anekënd botës, me dëshirën e madhe të shfarosjes masive. Ky motiv i qenësishëm, nuk kish se si të mos kapej nga vëzhgimi i hollë i Kafkës.

Pra, si një pararendës, Kafka udhëhoqi mendjet njerëzore, duke i paralajmëruar për gjëmën e zezë që mund t'u vinte më pas. Jozef K. ishte njeriu i parakohshëm i dënuar të vuante, pasi, më vonë, me miliona njerëz do të dënohen me vdekje e do të internoheshin pa kryer krim.

Kafka këtu arrin të përcaktojë qartë një motiv tërësisht të dukshëm në këtë kohë të mbrapshtë, ku logjikja nuk të çon në ndonjë zgjidhje konkrete në një vend ku sundon ligji i më të fortit, si nevojë për të jetuar. Problemi që bëhet strumbullar rreth figurës së Jozef K. mbetet vetëm fati i tij i keq që ka lindur si i tillë, pra është ai që është dhe që ka lindur njeri.

Pra, autori sqaron në mënyrën më të qartë, më lineare, se fatet e njerëzve nënshkruhen nga fuqitë mbi ta. Ato vendosin nëse ai, njeriu, jeton, vdes dhe si vdes. Kjo ide teçohet mbi sistemet e ndërtuara që e bënin çdo individ të kishte si destinatë të qenit fajtor pa faj. Kjo damkë dukej e ndihej kudo.

Jozef K., hero i viktimit, nuk është udhëheqës i fatit të vet, ai është një njeri qytetar, njeri që bindet, edhe pse s'i paraqesin asnjë argument. Ai është populli, është masa, është turma. Por ai është njeri. Si një ekzistencial i lindur në letërsinë e atij harku kohor, Kafka rend pas misionit të përgjithshëm për të shpëtar botët: "Vetëm kur shkrimitari rastësinë mund ta kthejë në ligj dhe ta bëjë njeriun të pavdekshëm, vetëm atëherë ai ka një rol në art dhe vetëm

atëherë roli i tij është profetik". Po, në fakt, çfarë ishte ajo që e bënte të lirë një njeri në një vend ku "sundonte" ligji?

K-ja është vendosur në thundër të pushtetit absurd, ku njeriu si qenie, mjedisi, arsyja, gjithësia, dhe të ekzistuarit si tërësi, nuk kanë asnjë kuptim të qartë dhe nuk mund kurrsesi të krijohet një relacion mes të gjitha këtyre elementeve. Njëra operon në mënyrë injoruese ndaj tjetrës. Kafka jep përshtrim të detajuar të zymtësisë që ka kapluar atë botë, pa na dhënë ndonjë version zgjidhjeje e ndëshkimi.

Në rrethin e Perandorisë së Habsburgut, ku shtrihet kjo vepër letrare, çdo individ mund të gjendej përballë drejtësisë së munguar. I akuzuar, i pambrojtur, fajtor për gjëra që askush nuk ua gjente dot arsyen. Por, në çdo vend ku regjimet totalitare nuk flinin, padyshim që do të kishte të tilla produksione fatkeqe. Jo më kot Kafka do të shprehet: "Njerëzimi bëhet një masë e përhime, pa trajtë dhe anonime, kur heq dorë nga ligji që i jep trajtë".

Përsa i përket ndërtimit, Kafka, edhe pse ka tri personazhe realizues të ngjarjes tragjike, xhelatët i trajton sikur të janë një individ. Kjo, për të theksuar edhe më shumë fytyrën e institucionit. Pra, ata nuk janë njerëz që vrasin, por institucion që vret në ernët të absurdit.

Madje, autori i vendos këta të ndërlidhur e ndërvarur me njëri-tjetrin, a tha se vërtet ekzekutori dhe viktima duhet të bashkëjetojnë, se nuk bëjnë dot pa njëri-tjetrin. Kjo është pikërisht ajo që e bën më therëse këtë filozofji të jetës njerëzore. Të dyja anët e medaljes sjellin përkrah qenie njerëzore, por lufta pëmbijetesë i klasifikon në të mirë e të këqipi... Njeriu vret njeriun...

Fati i viktimit së xhelatëve, "të zbehtë e të shëndoshë", sic përshkuar autorit, për të paraqitur fytyrën e vdekjes, ka një tragjicitë shumëplanësh. Personazhi dënohet pa bërë krim, por, si të mos mjaftojë kjo, ai vdes i vetëm fare, në një natë pus, ku askush s'mund t'i shkojë në ndihmë, përtatë hequr nga këto kthetra. E vetrnja dritarëz që hapet tinëz, e bën K-në të shpresojë, duke gërmëzuar: "Kush ishte? Ndonjë mik? Ndonjë njeri i mirë? Ndonjë që donte ta mbronte?... Mos vallë mund të bëhej gjë?"

Por mënyra e ekzekutimit është një tjetër fakt tronditës që njeriun e zhvlefëson si të tillë, e trajton si të jetë objekt, pa shpir, pa të drejta, pa asgjë. E gjithë shoqëria është e heshtur, e shurdhët, e verbër, e largët, një bashkëfajtore e ekzekutimit.

"Procesi" mbetet kryevepër, si për tematikën e sjellë, ashtu edhe për veprimin, përshtimin, dialogun, lakonik, elementet stilistike. "Procesi" gjendet në çdo kohë, te çdo komunitet a rracë njerëzore, pasi përqon mesazhe të qenësishme mbi ekzistencën e njeriut, si një frysë që duhet t'i sigurohen të drejtat dhe liritë, pa kushtëzime, pa ndërligje, pa kërkuar haraç, si një nder që i bëhet. Ky realitet vazhdon të jetë një kërcënim serioz për popuj të pambrojtur, me të cilët shoqëria ka shkëputur fijet.

E PADUKSHMJA NË POEZINË E NIKO KACALIDHËS

(Mbi vëllimin poetik " Heraldiket e borës", Onufri, 2022, Tiranë)


Nga Fatmir MINGULI

Të shkruash për poezinë e Niko Kacalidhës do të ishte privilegji për çdo kritik letrar sepse ai është një zë krejt i veçantë i poezisë shqipe që prej viteve '70 të shekullit që lamë pas e deri në ditët tona. Eshtë pikërisht vëllimi me poezi "Heraldiket e borës" që u botua vitin e kaluar ku shfaqet trajektorja poetike e këtij autori të brishtë. Një trajektorë, ekuacioni i së cilës është i panjohur, një ekuacion enigmatik, ashtu siç është vetë poezia e poetit Niko Kacalidha. Prandaj dhe nga titulli i kësaj analize pér poezinë e Kacalidhës kuptohen se do fitet pér disa padukshmëri në thelb të poezeve të tij në dhjetë vjeçar. Ashtu si dhe Moikom Zego i ndjerë, edhe Niko diti të mbikalojë lumenin e turbullt që mbyste letërsinë shqipe dhe doli i palagur në tokën e shenjtë poetike të shpirtit të tij. Duke qenë eruditë të pashqo, ata të dy mes njuhurive të jashtëzakonshme, dëgjonin më shumë oshtimat e trumpetës së mitologjisë. Në të dy sistemet Niko Kacalidhas mbikaloi edhe shumë lumenj të tjerë. Ai kishte dëgjuar të atin e tij kur në të gjallë i thonte: "Qëndro larg klubeve, sepse aty do dëgjosh gjëra pér të cilat do të duhet të dëshmosh dikur diku. Po fole, do bëhenj njeri i urryer nga të tjerët por dhe nga vetja jote, po nuk fole, do flasin të tjerët pér ty gjëra jo të vërteta, që do t'i vërtetojnë me "tre dëshmitarë".

Ishte kjo udha e mbrothësisë, udhë që sot e shohim në faqet e librit poetik "Heraldika e borës". Nëse do të përcaktoja profilin e poetit Niko Kacalidha, do ta mendoja mirë se për të janë bërë studime të shumta nga studiues shqiptarë e grekë, ku profil i tij shpaloset buruk në të gjashtë pamjet e mundshme. Ky poet që përballoi dy jetë, jetën e para '90- tës dhe atë të mbas '90- tës është ngadhënjes jo vetëm në poezi, por dhe në zhanrin e prozës e aq shumë në atë të përkthimeve. Është kjo arsyesa që unë nuk pretendoj të ribej ato që kanë shkruar të tjerët, por duke lexuar me vërnendje poezitë e Nikos ngazellehem për nga sinqeriteti i quditshëm, një sinqeritet i një shpirti delikat, një shpirti që emeton drithë. Ky është shpirti i poetit. Se poezia nuk është as filozofi, as shkencë e as teologji, por është duf i emocioneve të shpirtit të poetit. Dhe poezia e Niko Kacalidhës nuk është aspak robëreshë e rimave fundore e mesore, as lineariteti në formë e përmbytje. Poezia e Nikos, edhe pse në dukje duket delikate, si një fllad i lehtë pranveror, në të kundërtën ajo është shtjellë e erërave turbulentë që prek çdo cep të tokave dhe ujërave shqiptare dhe greke. Ai të trondit me getësinë e tij.

Kam vënë re edhe guximin e fuqishërm që Niko ka në poezitë e tij, është një guxim që duket sikur konfrontohet me delikatesën e vargjeve të tij. Por, këtu është bukuria dhe forca e poezisë së tij. Në poezinë e Kacalidhës ndesheni me një sistem original teosofist. Nëse Helena Petrovna Blavatskij hodhi themellet e doktrinës filozofike të teosofizmit, ku kërkohet koordinimi i njojhes mistike me kërkimet shkencore, Niko Kacalidha ndërton "doktrinën" e tij të ngjashme teosofiste ku koordinon mrekullisht poezinë me religjionin e origjinës së tij, duke derivuar poetikisht nga realja e natyrës për të shkuar drejt esencës të së shenjtës. Ai, me poezitë e tij zotëron ndriçimin direkt të shenjtores kudo që ajo ndodhet. Këto ndriçime janë shprehur në poemën brilante "Epifania e hënës". Kjo është e padukshmja e parë në botën poetike të Kacalidhës dhe jo vetëm kaq. Duke qenë rast unikal për futjen moderne të religjionit në krijimtarinë e tij ai është ashtu siç veproi dhe poeti ynë i madh Naim Frashëri që intersektoi botën bektashiane në poezitë e tij.

Ja se si shprehet Timo Mërkuri në një



analizë të tij për poetikën e Nikos: "Poezia e Niko Kacalidhës nuk është varg, është frysma, frysma e shenjtëuar e A(r)tit poetik. Unë ju them se Niko Kacalidha është thjeshtë Biri i A(r)tit që solli Frymën e tij të Shenjtë te ne në formën e vargjeve poetike. Pa shikoni pak me vëmendje se mos vallë ky libër është ungjilli (poetik) sipas Niko Kacalidhës Ungjillorit të 6-të, se unë përvete do ta lexoj përsëri dhe do ju them." Dhe vetë Niko Kacalidhas shkruan përveten e tij, përatë jetë të fëmijërisë që unë si bregdetas i Jugut e admiroj: "Gjithë ajo botë mistike shpesh më bënte të besoja pa e ditur dhe rëngethesha pa e kuptuar. Kur nëna me afronte të puthja Shën Marinë, ajo, e përdel-luara në ikonë, ngjante me gjyshen time. Kur gjyshja më konte të puthja ikonën e Shën Nikollës, më ngjante se puthja emnakun gjysh Nikolla që e prisnim dhe nuk ishte kthyer ende nga Amerika. Përnatë para gjumit bënim kryqin. Kuptohet se kjo e tërë në kompleksitetin e saj është një bote iashëtëltrare."

Dhe për të mbyllur trekëndëshin e shenjtërisë ortodokse po sjell një pasazh nga studiuesja Alisa Velaj: "... Këtu mbizotërojnë shënjesit mitikë, të përzier me shënjes biblikë si: uji i bekuar, apokalipsi i guvave dhe fashikujt e ungjive. Ndërthurja e lëndës mitike me lëndën kristiane, si një nga tiparet themelore të poetikës deklarohet edhe nga vetë poeti, i cili i mëshon shkakut biografik të kësaj ndërthurjeje në laboratorin e tij krijues. Në një intervistë të botuar në revistën "Exlibris", Kacalidha shprehet: "Unë kam lindur në Leshnicë në kufirin midis Shqipërisë dhe Greqisë. Gjithë bota ime që kishte lidhje me tokën, me drurët, me gurët, me yjet, me gurrat, me zogjtë dhe gjethet përreth ishte pagane dhe ajo tjetra,

shpirterorja, me Ungjillin, me kishat e vjetra, altaret, hieroret, qirinjtë dhe varret, qellin e shpirtrave, engjëjt, ishte një botë e krishterë”

Uñë jam dakord me krahasimet që studiues të ndryshëm bëjnë duke thënë se Niko Kacalidhas është si shumë poetë të Mesdheut. Por, duke mos dashur të përmend emrat krahasues dua të theksoj një fenomen negativ që ndeshet në letërsinë shqiptare, në kritikat analitike ku ka një vruл të ethshëm për të krahasuar krijimtarinë e aksh autori me dhjetëra autorë të huaj apo dhe shqiptarë, mundësishet shumë të famshëm. Niko Kacalidha nuk ka nevojë për këto krahasueshmëri. Ai është vetvetja dhe është ai që e ndërtoi teosifizmin e tij poetik dhe asnjë tjeter poet i Ballkanit apo përtëj Ballkanit. Dhe ja studiuesi grek Qiria-kos Harallabidhis tek flet për Nikon dhe poezinë e tij: "Niko Kacalidhas vjen midis nesh si një poet që ruan të drejtën të shikoje me sytë e një "të huajti atë që në fakt është thellësisht e tija". Edhe kur isha student në inxhinieri në Universitetin e Tiranës, e pak më vonë në jetën e përditshme, aroma e poeziave të Niko Kacalidhës vinte e këndshme, pa pathose partiake e atdhetares milittantiste, si ndër shumë poetë të asaj periudhe. Thjeshtësia ishte e para e aromës së atyre poeziave, brishtësia e forconte akoma më shumë emrin e tij si poet të vërtetë.

S'kishte si të ndodhët ndryshe! Një poet i vërtetë nuk është rob i pushteteve, por intutivisht i shmanget poezie sloganë, puthador ndaj pushtetit politik. Në diskutimin e vazhdueshëm që kam bërë me shkrimitarët e ri durrsak Pol Milo përmes poezitës së librit "Heraldiket e borës" kam theksuar dhe atë pjesë të padukshme tjetër.

të poezisë së Niko Kacalidhës, një e padukshme që e quaj "e fshehta e hënës". Shkak ishte pikërisht kjo pjesë e një libri të Polit ku shkruan: "Hëna sheh gjithçka prej mijëra vjetësh. Ajo i ka parë të gjitha misteret. Të gjitha që i janë thënë asaj, i ka ruajtur aty. Vetëm kurre s'do të merren vesh. Për këtë arsy, ajo tregon vetëm njërin anë, atë me drithë. Anën tjetër, atë të errëtën, do ta mbajë gjithmonë të fshehtë!" Dhe Niko Kacalidhas operon me hënën, operon rëndshëm duke na sjellë emocione të jashtëzakonshme jo vetëm metaforike por dhe sureale.

"Aborti i hënës, klepsidra e hënës, përskuqur e përgjakur gjysma e hënës/protezë e poshtme e dhëmbëve të nënës, llambadari i hënës, ulërijnë ujqt duke kafshuar hënën mijëra vjet, dhe e njëjtë mabetet. Por, unë kam në irid të njërit sy diellin përbrenda një monokël që ua kam fshehur perëndive dhe në iridin tjetër kam hënën natën, o të uruar, hëna si një sorkadhe, etj. Këto janë figurat që Niko i qëndis në faqen e padukshme të hënës. Hëna është personazhi i fshehtë i poetikës së Niko Kacalidhës, është një aktore të cilës ai i jep role në teatrin absurd të cohës së kaluar dhe të tashme, shpesh sureale. Jo vetëm kaq. Hëna në poezinë e tij është së bashku me shumë figura të tjera si drurët, gurët, bora, etj, por marrëdhëni me hënën janë të lidhura me padukshmërinë e parë, atë të teosofizmit të Kacalidhës.

"Ajo hëna është pjesë e kishës ku ai pagëzohet, turtujt janë fshehur në folenë e perënduar të hënës...Psalte oshënari mes orakujve në dritën e hënës...Hapen orakujt mbrëmjes në kupën e hënës...Hëna i mbuloi me degët e ullinjve të mos diktoheshin puthjet, Hëna i lë përqafuar barit dhe iku herët. Më zhytën lakuriq në baptisterin e hënës duke më larë me krezmë e ujët e pranverës".

Këto citime janë në vëllimin 'Blatimet e borës' që ka poezitë e pabotuara. Sonte të vdekurit/do t'i varrosojn lakuriq/mbështjellë me qefin e hënës. Drapri i hënës i priste kërthizën; altari brilant i hënës që kullot në limonishtë... Metafizika e hënës". Poezia "Hënë njëzet vjeçë" një ode e jashtëzakonshme që i këndohet hënës ku fantazia dhe realja udhëtojnë së bashku. Vetë poezia e Nikos është një labirinth që e merr ndriçimin nga ana e pasme e hënës, një ndriçim që shumë pak, shumë pak poetë e marrin. Ai dhe hëna kanë Besëlidhjen e shenjtë mes tyre. Kjo Besëlidhje është e ngjizur nga oshënari Niko që bisedon me hënën netëve. Bukuria e hënës është poezia, sepse falë dritës së saj arrin të ndriçojë natën dhe në të njëjtën kohë të japë atmosfera emocionuese. Dëshira, misteri, pyetja, malli, janë ato ku poetët në botë kanë gjetur fryshtësim për t'i kushtuar veprat e tyre magjike Por goditjet përfundimtare nuk kanë munguar edhe pse vjen nga futuristët: Marinetti e bën atë objekt të një invektivi (fjalë e ashper) i tij i famshëm, kur në mënyrë programore bërtet "Ta vrasim dritën e hënës". Eshtë hëna e përdhosur, një reagim i tepruar ndaj teprimeve të romantizmit sipas kërkesës. Por sa larg është Niko Kacalidhns nga futuristët e nga vetë romantikët. Ai është impresionist i hënës, është surrealisti që e pikturën hënëri ashtu si nuk e ka pëershkruar asnjëri. Ai i ka bërë skanerin pamjeve të saj të prapme, se të përparmes i kanë bërë shumë poetë e shkrimtarë. Oshënari, poeti dhe hëna janë një e të pandarë Ky është Niko Kacalidhns!

pandaré. Ky éshtë Niko Kacalidhas!

E ndérkohë ai bën qéndisma me yjet në qiell e i qep jakén hënës. Dhe poezia e plotë pér hënën që në 1973 botohet pa kurrfarë frike nga i brishti guximtar Niko Kacalidhas. Poezia "Doli hëna, sikur digjet pylli" nuk éshtë e pakët pér një poet klasi, e sidomos e botuar në kohën e monizmit.

VETMIA



Xhabir AHMETI

Dikush therriti te dera, e ishte terr.

"O Pal!"

Maria e hapi pakëz dritaren ta hedhë një sy, të shohë po të ketë mundësi ose ta njohë zérin. Asgjë nuk pa, asgjë nuk dëgjoi. Ajo deshi ta mbylli dritaren, po s'e mbylli. A e hapi a s'e hapi dritaren, a e mbylli a s'e mbylli, krejt njësoj do ta kishte. Thirrma i hapi shtegun frikës e cila kanosej me thonjtë e saj të padukshen.

Vapa e verës i kishte dalë si mur përparrë grykës dhe s'e lejonte freskinë e malit të depërtojë, kështu që gruas së shkretë i shkonin djersët palë-palë. Por ajo dritare në shtëpinë përdhese që kishte nuk ishte ndonjë mburojë. Gruaja e fshinte qafën e gushën e saj të njomë me shami mëndafshi. Pastaj mendoi: më mirë ta mbyll. Sa e shtyu krahcën e dritares pak për ta mbyllur zëri u përsërit.

"O Pal!"

Frika dhe kërvshëria bënin gara kush do ta merrte fitoren dhe e kështu e mbanin Marinë mbi krahët e pasigurisë, por edhe të gozhduar pranë dritares. Ankthi buronte prej saj dhe depërtonte nëpër xhamin e mbyllur, rrëshqiste përmuri dhe bëhej pjesë e oborrit dhe kopshtit duke u fshehur në terr i cili mbulonte pemët, barin, kurse vija e ujut në oborr e heshtit

gurgullimën e ëmbël. Dhe, rrinte Maria në një pozitë mbrojtëse "gatitu" të nxitur nga instinkti. Në atë çast gruaja kishte dëshirë të paraqitet dikush, ndonjë fqinj, t'i thoshto, mos u shqetëso Mari, jam unë Gaspri, ose Ndreu. Më së miri do të kishte qenë të ishte fqinji i parë Gaspri, mëépo prej shtëpisë së tij u dëgjuja një këngë e Qamilit të Vogël:

Konstantineeee, herët po më vjen...

Kënga i erdh mire gruas, i erdh si një krah i padukshëm mbrojtjeje, por nuk zgjati shumë. Si mbaroi kënga heshtja u ul në fron dhe i ndali edhe muzikën e bulkthit, edhe të zogjive të natës dhe Qamilin e Vogël e hodhi në harresë. Maria mbeti të qëndronte në pozitën "gatitu", e gozhduar midis frikës e kërvshërisë: a tha do të dëgjojet sërisht thirrja? Çfarë plani kishte rjeriu a fantazma që thirri te dera.

Pas disa minutash priteje pranë dritares që dukeshin si orë, përsëri u dëgjuai ai zëri te dera që po e thirrte emrin e burrit të saj:

"Ooo Pal!"

Pas kësaj thirrjeje qetësinë menjëherë e prishi fëshfërima e gjethive të manit të madh e cila u dëgjuai si muzikë e frikshme. Terri në oborr e kopsht, rrëth e më rrëth shtëpisë ofronit vetëm verbëri. Natë me uffëm. Tashmë nata po e kalonte vijën ndarëse dha po e bënte hapin e parë drejt agimit, prandaj vapa nisi të lëshojë pe para freskisë që po rrymonte nga ahishta mbi të dy anët e grykës së malit e cila ditën dukej madhështore përballë shtëpisë. Grua e ndjeu freskinë si ia ledhatoi ëmbël qafën e djersit, por ajo nuk ishte e qetë. Pusia i zemrës iu shpejtua dha ajo e ndjente çdo të rrahuar të zemrës së saj. Një zot e di sa të rrahu ra zemra kishte brenda minutës. E si të mos ishte kur ky zë po thërriste "O Pal" ishte krejtësisht i panjohur. Madje kishte diçka frikësuese në atë zë. Çfarë të bëjë? E kroi pak qafën ku djersa kishte lënë gjurmët e veta. Më në fund e mblodhi veten dhe tha vet me vete:

"Çohu moj Mari, dil te dera! Nuk do të vdesësh pesë herë, moj e gjorë!" Iu kujtua nëna e vet, e cila pa martinë e me martinë në krah i dilte përballë rrëzikut. "A jam e bija e Lajdes?" tha Maria. Pastaj e hapi pak dritaren dhe dëgjoi. Nata vazhdonte të mundohej ta mbaqë nén kontroll qetësinë, mëépo bulkthat e kishin filluar koncertin e tyre. Edhe në këtë muzikë Maria e ndjente marshin e frikës. Po kah t'ia mbante e shkreta grua. "S'ka gjë", i dha gjajt vetes Maria. "Po dal", tha. E ndezi fenerin dhe doli nga dhoma. Kur po ecte shtegut drejt derës së madhe era nisi të luante me njëren krahcë të derës dhe e detyronte

krahcën e harruar hapur të vajtonte pikëllueshëm. "Kjo mund të jetë ndonjë lojë me sherr", mendoi Maria. Frika e shpejtoi turrin e saj dhe sërisht u bë ndjekës i pamëshirë i gruas së shkretë. Të kthehej, do të ishte më keq, sepse bisha gjithmonë e sulmon ikësin. Këtë e dinte Maria. Ajo vazhdoi të ecë përparrë kah dera, kurse feneri luhatej para e prapa në dorën e saj të majtë, në të gjathtën ajo e mbante një shkop me kërrabë, të cilin e mori në fund të shkallëve kur u nis të ballafaqohet me zërin që thërriste:

"O Pal! Paloo!"

Maria u ndal. Heshtja e rëndë e mbante peng hapësirën. Gruaja e ngriti kryet dhe i pa yjet që dridheshin dhe i erdh sikur atë ia tërhiqin vërejtjen të ketë kujdes. Tash deshi edhe më shumë të ishte ndonjëri nga fqinjët ai që kishte thërritur. Jo, jo, ata kurrë s'do të kishin bërë ndonjë gjë të tillë. Ishin burra të kujdesshëm atë, burra që i respekton përturti e për kanun. Ajo e zgjeloi fitilin e fenerit, të cilin e la pas një guri që e kishin skaj shqetës që shkonte nga shtëpia kah dera. I bëri një dy a tre hapa dhe u ndal. Rrinte qyqe vetëm me bastunin në të cilin mbështetet si luftëtarët e moçëm kur të lodhur mbështeteshin në shtitat e tyre. Dikur e dëgjoi një rrapomë nga një anë e kopshtit të vogël rrëth oborrit. U kthyte në majë të gishtave te feneri. E ngriti pak fitilin me dorën që i dridhej dhe përsëri tha vet me vete: "A jam a s'jam e bija e Lajdes?" U nis me kujdes andej nga vinte rrapoma. Asgjë. Kishte qenë dega e dardhës kanare e cila e lakuar nga pesha e fryteve, ishte dorëzuar dhe ishte thyer duke i shpërndarë kokrrat në tokë.

Atë pak dritë që vinte nga yjet tash e mbuloi frika, e cila u tregua se nuk dorëzohet lehtë para vendosmërisë së një gruaje. Maria po dridhej. Deshi ta ngrëjë pak fenerin të shikojë kah degë e dardhës, por ndërroi mendje. Mund t'i dilte më keq. Ku ta dish se çfarë mund të fshihet në ato degë të dardhës. "Më duhet të jem e kujdesshëm", mendoi ajo. "Se më këto veshë e dëgjova kur e thirri Palin. Dhe, jo vetëm një herë, por disa herë", shtoi. "Çfarë të bëj? Zgjidhja më e mirë do të ishte të kthether në dhomë. Dhe, u kthyte prapa. Atëherë, sa ecte shtegut, filluan t'i ushtojnë veshët dhe Maria nuk i dëgjonte hapat e vet mbi zhur i cili kërcëllonte nën këmbët e saj të gruas së re.

Kur u afrau te dy -tre shkallët e shtëpisë përdhese, prej së largu u dëgjuan cijatje qensh. Maria mendoi se ujqt kanë zbritur në fshat.

Ndërkokë, pa e ditur si hyri, ajo e pa veten në dhomë. Pastaj e zuri veten si e kishte

mbuluar kokën me të dy duart që të mbrohej nga ndonjë goditje e paparashikuar që mund ta befasojë në çdo minutë në terr. Në atë gjendje iu lut perëndisë ta ndihmonte. Qetësia që e rrethonte s'e linte të qetë. Edhe qetësia prodhonte do zukama të tmerrshme në veshët e saj. Ajo gjatë kohë ndenji në atë pozitë. Në fund e pa se ishte e kotë të ruhej në këtë mënyrë. Përsëri tha vet me vete: "A jam a s'jam e bija e Lajdes?" U ngrit me kujdes dhe u vërtetua a eshtë e mbyllur mirë dera. E mbylli atë dhe e shtyu edhe dritaren. E mori shkrepësen që e mbante në dollap dhe e ndezti llambën me vajguri. Shikoi me kujdes përreth. Në çdo skaj rrezatonte pastërtia, çdo gjë ishte vendosur me kujdes në vend të vet, që nga filxhanët nëpër rafte e deri te arka. Por mungonte gjallëria. U ul në karrige, i vuri bërrylat mbi tavolinën ku i mbante të renditur nga një libër të Mjedës, të Naimit, të Esat Meklit dhe të Gavril Darës, pastaj e mbështeti kokën mbi dy duart e saj të bardha e të buta. Atëherë e pa se zukaste vetrnia në veshët e saj dhe iu bë e qartë se sa i rëndësishëm ishte Pali i saj, i cili shkoi për dy-tre muaj në kurbet në Raguzë të silitë ndonjë lek së andejmi. Dy-tre muaj Marisë iu bënë sa dy-tre shekuj. Nga lodhja tensioni i ra dhe pulsi iu rregullua. Dhe, Marisë zuri gjumi.

Rrebet e para të diellit që e prekën kuroën e manit hodhën driten e parë të mëngjesit edhe kah dritaret e saj dhe e zgjuan. U ngrit, ndjeu dhembje të fortë të kokës. Doli te pusë që e kishin midis oborrit dhe kopshtit dhe i lau sityt. E vuri një xhezve me kafe, e piu një herbë dhe përsëri u ul në karrigen pranë tavolinës. Pëshperëti diçka dhe bëri me dorë në shenjë "hajt se punë e madhe". Duhej ta harronte natën e mbrëmshme. Iu dhimbësën vjehrri dhe vjehrra që shkuan njëri pas tjetrit. Të kishin qenë ata sigurish se nuk do të ndodhë ajo që i ndodhi Marisë.

Ajo e pa sa i rëndësishëm ishte Pali i saj.

"O zot, nuk dua para... edhe me lira të ma shtronjë oborrin, nuk i dua. Më duhet Pali im, tha.

Pastaj e pa fqinjën Drane që po vinte oborrit me një tufë lule drejt shtëpisë. Maria i doli përparrë.

"Erdha ta pirmë kafenë e mëngjesit bashkë. Ka ditë që s'jemi parë, e vetëm një mur na ndan, tha Dranja.

Maria e vuri xhezven sërisht dhe derisa priste të piqet kafeja, e pyeti Dranen:

"Drane, a mos dëgjuat mbrëmë diçka"?

"Jo", tha Dranja. "A mos ka pasur ndonjë tërmët, a?"

Monolog

ALETEREGO

Albulena KRASNIQI

E vetme! Errësirë! Dritat janë të fikura qyshkur. Një gotë venë më shqëron në këtë dhomë të vockël, që t'nxë frymën! Po flas me të, fundja kam kujt t'i qahem! Atëherë kur duartrotkitjet mbarojnë, unë kthether këtë dhomë në shtëpinë time t'vjetr. Kthether aty, ku s'gjej veten, por aktoren zëvendësuese që shumë mirë di të luaj me jetën time, dhe nuk përtor ta djallos edhe më shumë, duke perifrazuar etpat e skenës sime! Si çdo natë, edhe sonte pi venë, dhe ende s'po gjey arsyen për pirjen e venës! Ha ha ha, ironike! Vetëjeta e artistit pushtohet nga ironia! I di

arsyet, por s'dua t'i flas! U fikën dritat, tashmë as pluhurin s'po mund ta shihja. Zhvishja rrobat, dhe shikoja kuletën e vyshkur, që sikur të personalifikohet me unin tim, qëmoti do kishte ikur nga xhepi i artistes. Zgurdullova sytë dhe gjeta veten të shtrirë në dhomën time t'vockël!

As errësira vrastare se fshihte dot realitetin. Rrotulloja fletoren nëpër duar, s'kishte gjë me vlerë, përporsa disa shënimëve të mia, që i kam shkruar kur kam qenë esell! Artiste: "shumë dashuni e pak jetë!" Mirazh i turbullt paraqitej para syve të mi; jeta ime në relacion me atë skenike! Atëbotë ku më lejohej të isha vetja. Rrobat shumëngjyrëshe s'po

arrinin të më krijonin më atë ndjesinë e mëparshme. Dje isha e lumtur, pa pirë, çudi! Shiko këtu ti, unë di të lumturohem me palumturin! Utopik! Kam luajtur nënën, pa qenë dot nënë! Koka ime e koklavitur po më gjerryen kokën! Ahh, po, tani e kuptova, thashë që s'dua t'flasë për arsyet, por rrëshqita, defekt profesional; ngatërrim rolesh! Merimanga më shkonte me dhembshuri, ngase nuk arrija dot ta lëkundja as strofullin e saj! Andaj ajo më sheh si të dobët! Plakën e Joneskos e bëja konfuzë! Dashuria ishte plagiaturë e unit tim! Dritërimë! Fantazmat dialogonin ndërmjet vete, kryepersonazhja isha unë! Ngjyra e verdhë e ndritur i jepte pamje kuforme, mos ik, mjaft u fshehe nga vetja! Citim nga pasqyra. Mos e vrit heshtjen. Mora frymë thellë, shkëmbinj shembeshin e derdheshin. I ndërtova, shembeshin! Rrugë e njohur e panjohur! Rendisja karrigjet në kështjellën e pluhurit!

Dëgjoja nga larg, por jo nga afër!

Formoja buzëqeshjen e mësuar! Eja tek unë, mos ki frikë nga vetja! Mjaft u fshehe! Më humbe prapë! Një vajzë e vogël duke luajtur me kukulla, klishe. Një vajzë e vogël me èndrra të mëdha, unlike! Fëmijëri e pasur, plot art, e shpresë! E njëjta je prapë, por shpresa të èshtë venitur! Po qan?! Pse? Ti nuk bëre asnjë gabim, ty të duan, në fakt duan atë që duartroksin, jo ty, por të duan ty! Ti din të luash në të gjitha rolet, vetëm në tëndin dështon! Qaj, pastaj eja në përqafimin tim. Qëmoti s'kam shijuar kësilloj momenti me ty. Ashtu.....vë muzikë të qetë, më të trishtë se kjo natë, e lumturohu me trupin tënd të pasur. Duaje se cilën rrudhë në lëkurën tënde të njomë, ngase kanë dëshmitë e tua! Lëvize trupin ngadalë, shjoi dritat e makinave, dje vazhdo të luash me shpirt të padjallëzuar, ashtu nuk e harron fëmijërinë. Të dua, sepse po të mos isha unë, do të dashurohesha në dëlirësinë tënde.

POEZI: Aziz MUSTAFA

AUTOPORTRET FUTURISTIK

Nëse unë Aziz Mustafa
e mashtroj vdekjen deri në vitin 2062 pas Krishtit
torta ime e ditëlindjes nuk do të mund t'i zë 95 qirinjtë
Në retrospektivë do të mendoj se
si nuk paskam pasur kohë të vdes
Kërrusur do të jem nga ecja vertikale
sytë 95% të dëmtuar
me ca syze sa fundi i shishes së "Coca-Cola"-s
Veshët me një aparat auditiv digital
Do të urinoj nëpër një kateter silikonë Folley 20 mm
Nuk i paramendoj gjérat ireale a do të jenë ende të tilla
Do këm veshur blue jeans të shekullit njëzet
Do të lexoj poezi në orë letarë
nëse nuk do të ma kenë hequr laringun
e zemrën do ta mbajë gjallë me karditonikë
nëse nuk do të ketë më dashuri
Do të shkruej ende poezi apo
një prototip të saj për lulet e akuariumeve dhe për fluturimin
Do të shkruej përmijët që plaken në moshën 20 vjeçare
për delet kibernetike
klonimin në lagjen e poshtme
dhe armën gjenetike
në vend të fushave të minuara
në luftërat mes popujve të vegjël
në një qoshe të gadishullit që dikur quhej
me një emër të çuditshëm Ballkan
Dijarti im do t'i ketë atëherë 63 vjet i vdekur dhe
nuk do të plaket si unë dhe mëma e tij e mirë
Do të filloj të pi duhan sepse do gjendet bari
për kancerin mushkëror me qeliza të vogla
Do të kem kaluar një luftë
një meningjët viral dhe
kushedi sa labirinte sallash operacioni
Tërë arna do të jem pos shpirtit
Ende nuk do ta kem shkruej traktatin për amshimin
Deri atëherë nuk e di a do të më duhen testiset
Ndoshta do të jem klonuar për hatër të një gjeni të lashtë arian
Kohës do t'i nxjerri gjuhën
Nuk e di a do ta kemi kapërcyer vetveten
Nuk di a do të kenë kuptim
gruaja gota dhe gjithçka që fillon me germën "g"
duke mos futur këtu gomarët
Ne do të vazhdojmë të bëjmë dashuri të zjarrtë në internet
me vetminë tonë të thellë
Fëmijët në kushedi çfarë valësh do të na thërrasin
Nga cili planet vallë do të eksplorojnë të kaluarën e botës
Nuk e di a do të jam ky që jam sot
Nuk do të jem ndoshta fare njeri
Do të jem poezi

TË DIELËN NË MËNGJES

Ngrihu ashtu e virgjër
Pi ujë dhe merr frymë
Përjetë mëngjesin
Ai le ta sjellë kafen te shtrati
Ti pije dhe ëndërrro ngrohësinë
e gjymtyrëve të mia
Mendo pastaj se në arabi
është ditë pure është si e martë
dhe vikendi është larg
Shiko majat e alpeve nga dritatet dhe
ndonjë fluture të vonuar hapja dritarët dhe e shpirtit
Shkruej në tastaturë për éndrrat e pacenzuruara
Le të kenë afshe kafshime dhe klithje le të kenë
Gaz jetë dhe dritë si mëngjesi i të dielës
Pastaj kur të marrë malli për frymën time
Vëj duart para gojës dhe fryj fort
Ajo që të kthehet dhe t'i mbush mushkëritë
Është fryma ime dhe puthja dhe shija e jetës
Së të dielës në mëngjes

LETËR DARDANËS

Është tmerr
është më shumë se tmerr
se si gjérat e mira janë përherë të huaja
psikoanalistikët e trentë frojdi sidomos
përherë kanë të drejtë
e ti Dard-Ana nuk e don atë
Edhe unë kam filluar ta urrej shkaku yt
ti nuk i don këto vargje e edhe unë
kam filluar t'i urrej
Çuditërisht po më dukën disi
si pula të nukta dhe vërtetë
nuk kam dashur kurrrë t'i besoj epshit
së paku jo në rastin tend
Dardana pasha sytë e mi të përgjakur
flutura ime
nuk është turp të puthësh hijet e natës
as të pështysh jetë nuk është turp besomë
është tmerr i thjeshtë se si në mua po fiton djallë
e engjëlli po më rri struktur në një varg
që kurrë nuk do të botohet
Të kam paralajmëruar
ruaju nga gjenitë dhe budallenjtë
ruaju më shumë vetes
dhe mos u fut në vorbull
Marramendja është një sëmundje e keqe
më e keqe se AIDS dhe se ethet e minjve
të merr mendtë e humb drejtimin
rrëzohesh dhe keqas përgjakesh
të çmend
e ti Dardana nuk ke nevojë për çmenduri
Më mirë çmendu në letër shkruej poezi të çmendur
gënjë veten dhe të tjerë
më lehtë e ke
në këtë botë më së miri kalojnë
rrencat hajnat dhe të pafytyrët
Këndoje përditë „Yesterday“ përherë do të ketë një dje
për një nesë nuk jam i sigurt këndoje pra
e të të sjellë në një pikë dhe në një vend të caktuar
ku ne nuk kemi qenë kurrë
kanë qenë shpirrat tanë
shpirrat e prindërvë tanë kanë qenë
djallë e marrë
vetëm hijet tonë kanë qenë
Të betohem për sytë e mi
nuk do të ketë kurrë më sot
ekzistojnë vetëm nesër dhe dje
e dje do të jetë dy mijë vjet më parë nën një dardhë të Dardhanisë
e ngulfatur nga terri
e unë e ti Dardana do të jemi të zhberë në një hiç eterik
do të jemi tmerrësish të lirë nga njëri-tjetri
padurueshëm të lirë

KREJT ÇKA TË DUHET ËSHTË DASHURIA*

(për J.L.)
Dje ishte e diel me shi qershori
dhe pos dashurisë që ishte
një "lojë aq e lehtë për tu luajtur"
nuk kishtë asgjë për të qenë
as verë as gra as det
rëra e shkretëtirës nuk llogaritet
Për zotin asgjë pos tingujve dhe puthjeve tua
Ishte si duket 14 qershor 1967 e unë isha
një fetus i çuditshëm shtatëmuajsh
shkelmak i parehatshëm thotë Shifa
aso kohe doja të isha binjak me ty
Ishte po ojo e diel pasdite me ajër
qind për qind lagështi
e unë dégjoja po këta tinguj
Dhe derisa sillesha rrëth sistemit tënd diellor
ëndërroja parajsën
pastroja shpirtin dhe sytë
nga ndyrësirat dhe gjaku
Dhe vargjet mesatare
Nga dritarja me grila kërkova atë pamje
të atij këndi të lënë të Dardanisë
ku asgjë nuk na duhej
pos ajrit dhe dashurisë
që ishin bërë një
si unë dhe ti

*vargje të këngëve të bendit "Beatles"

KUR CHINASKI TAKOI SALLYN

Sally ishte në fund të barit
dhe dukej e shkalafendur,
ndonëse po t'i picërrroje sytë drejt
do të mund të shihje se si fytyra e saj
dikur kishte qenë têrheqëse,
dhe po ashtu ende ishte
e hajthme. Pra, kjo ishte për merak.

Ajo i rraste pijet që i qelepiroste
me atë trukun rënkuar
për të cilin ishte e famshme.
Ishte bindëse dhe disa thoshin
se ndoshta vërtet
kishte telashe
herë pas here.

Chinaski ishte atje shumicën e netëve
dhe kjo mund t'ju duket e habitshme
ama në pëgjithësi ai i këqyrte
punët e veta.

Në këtë natë të veçantë,
Sally po ia dilte goxha mirë dhe ishte e zëshme
Ndërsa pijet po i vinin vërtet.

Më në fund, Chinaski nuk mundi të duronte më.

Kjo ishte grua perfekte, e kuptoi ai,
kjo do ta bënte një burrë që të qetësohet
dhe të ketë një punë të rregulltë.
Ndoshta të ketë edhe fëmijë.

Pikërisht atëherë, ai vendosi
për të hequr dorë nga pirja
dhe të bëhet njeri më i mirë.

Ai donte të bisedonte me Sallyn,
ta largonte nga e gjithë kjo.
Ama pastaj Sally u rrëzua përrpara,
dhe më pas anash,
dhe ra menjëherë nga stoli i saj.

Ndoshta ishte sulm në zemër. Ndoshta një goditje në tru.
Sido që të jetë, ajo ishte e vdekur.

Chinaski porositi edhe një turrë pije.
Ai i kishte shpëtar një plumbi
dhe i tha banakierit
t'u jepet të gjithëve nga një pije.

"Për të gjithë miqtë e mi", bërtiti ai.

"Qepe atë dreq gojë" tha plaku
që ishte ulur në anën e djathtë të tij. "Na lodhe
guxhën e karit me këtë vaki
që po e thua me bërtimë
e që po rrahesh
me banakierin
për çdo natë të hamamtë."

Chinaski ngriti supet.

"Mos i jep pije këtij çorodi", i tha banakierit.

Pjesa tjetër e natës ishte si gjithmonë.
Rrahje, gjak, birra.

Kaluan disa orë
para se dikush të kujtohej
të thirrte ndokënd për ta marrë Sallyn.

Chinaski mendonte ta merrte
e ta mbante atë
në banesën e tij për pak kohë,
por kjo i dukej si punë e tepërt.

Ai e dinte se do të shkruante për këtë.

Ky ishte një bar i përdreqë
që ende herë pas here të befasonte.

Ai ishte i kënaqur.

Kjo ishtejeta dhe gjithçka
ia viente.

NJË POEZI E PASHPIRT

Kush vendosi që arti i të gjitha llojeve
duhet të jetë i mërzitshëm? Ai farë personi - komisioni? -
ka nevojë për t'ia futur një shkerm të mirë bythëve.
E lexova librën që erdhë në postën e sotme
(nuk do të them se kush e ka shkruar dhe as si
më ka ndodhur të bëj blerjen)
i cili ka të bëjë me një jetë rurale të lustruar për merak
në metaforë të kargatisur dhe diksion të lartë,
ama e cofët si troftë e qëruar.
Kjo do të thotë se ajo lexohet si çdo poezi
që e gjeni e që mund të jetë e lakmuar
nga profesorët e anglishtes apo nga redaktorët
në The Georgia Review.
E di që i gjori që ka pasur qëllime të mira,
dhe botuesi ka bërë çmos që libri të ketë
dizajn të pakundshoq. Ama ta ofendon intelektin.
Nuk do të kërkoja nga poeti të jetë i gënjeshtërt
apo që botuesi të kërkojë ndonjë veprimitari tjetër.
Kështu që m' duhet t'ia kujtoj vetes se më duhet të jem
më i kujdesshëm kur ia mësyj të blej libra me poezi.
Unë kam fëmijë, pasha Zotin,
të cilët lehtë mund të ndikohen dhe janë ende të paformuar.
Unë nuk mund t'i mbroj ata nga gjithçka,
ama, për besë, kjo farë vakie
nuk do të jetë ajo për të cilën ata do të vrasin
mendjen kur të mendojnë mbi poezinë.

TË GJITHA RRUGËT

Ti m'je bashkudhëtare
e edrrave të mia
misteri im më intim
dhe ti i ke harruar
të gjitha gjërat që i dua fort
kjo jetë duhet të jetë e sjellshme
me disa
ose përndryshe ti nuk do të ishe
gjithë ato këngë të lumturë
ama kush janë ata
të lumturit
nuk është zbuluar
sall këto edrra
që më mbajnë
dhe jam i sigurt
se nuk do ta kuptoj
kurre jetën time
e bukurime
as edrrat
që më kullojnë gjak
dhe as pse je
kaq larg

Ç'TË THEM

Në Universitetin e Misisipit
shefi i departamentit të anglishtes
tundte kokën
derisa më thoshte
se nuk mund të besonte
që New York Times
kishte botuar një recension për antologjinë
që kishte një dy poezi të mia,
ama ai këtë mosbesimin e vet
e shprehte në mënyrën më të keqe
të mundshme.
Ky ishte momenti
kur kuptova
se isha në vendin e gabuar
në kohën e gabuar
për arsyen
krejt të gabuara.
Pyes veten se çfarë
do të kishte menduar ai halabak me tapi
mbi LA Times
po ta quante një nga poezitë
e mia në atë libër
margaritar klasik,
gjë që edhe e ka bërë
meqë ra fjala.

PROVIM

për Xhevdet Bajrajn

Ja ky është një test
për të parë nëse je
ende gjallë:
A mund bukuria
të të bëj të qash?
Prano çfarëdo
që të jetë e vërtetë.
Mos pusho së menduari.

Përktheu: Fadil Bajraj

TEORIA LETRARE PSIKOANALITIKE

Mund tē jetë e dobishme tē bëhet dallimi midis tre llojeve tē ndryshme tē kritikës letrare psikoanalitike



Atle KITTANG

Marrëdhënia midis psikanalizës dhe teorisë letrare është e ndërlikuar. Nga njëra anë, pak rryma idesh kanë pasur rëndësi më të madhe si për letërsinë ashtu edhe për studimet letrare gjatë shekullit të XX-të, sa psikanaliza; dhe anasjelltas, ndoshta pak aktiviteti jashtë observirive klinike kanë ndikuar më shumë në teoritë e psikanalizës sesa vetë letërsia. Nga ana tjetër, vështirë se dikush mund tē pretendojë se ka arritur të zhvillojë një teori konsistente psiko-analitike tē letërsisë. Për shembull, koncepti qendror i psikanalizës, ndërdija, ka rezultuar se është jashtëzakonisht e vështirë për tu përfshirë më një teori dhe metodologji letrare.

Afërsia midis letërsisë dhe psikanalizës është bërë e qartë që në kryeveprën e parë të Sigmund Freudit Die Traumdeutung (1900). Këtu janë përdorur shembuj nga Mbreti Edip dhe Hamleti për tē ilustruar pikat qendrore në teorinë e ëndrrave dhe në atë mënyrë që tregon teorinë bazë të psikanalizës mbi kompleksin e Edipit dhe fazën edipore në zhvillimin e fëmijës. Dhe gjatë gjithë shkrimit të tij, Freud i kthehet vazhdimisht letërsisë për tē ilustruar dhe sqaruar teoritë e tij. Por në mënyrë rigorozë, vetëm në një artikull tē vogël tē vitit 1908, "Der Dichter und das Phantasieren", ai përvizuan një teori psikoanalitike cështë krijimtaria: një aktivitet kompensues i imaginatës, i krahueshëm me ëndrrat, fantazitë dhe lojërat e fëmijëve, në tē cilat shtysa tē pavetëdijshme (shtysa seksuale dhe shtysa e egos) çlironët dhe pranohen si objekte identifikimi falë efektit zbutës ose transformues të arteve. Kjo skicë, në kërmim, ka qenë pikëniqja për një seri tē gjatë përpjekjesh për tē teorizuar në mënyrë psikoanalitike rreth artit dhe letërsisë dhe për shumë kritika letrare psikoanalitike.

Mund tē jetë e dobishme tē bëhet dallimi midis tre llojeve tē ndryshme tē kritikës letrare psikoanalitike. Më e vjetra (dhe metodologjikisht më problematikja) e konsideron letërsinë si shprehje tē dëshirave tē ndrydhura tē autorit/traumave dhe konflikteve. Duke përdorur analizën e ëndrrave tē vetë Freudit si model, elementët në tekstet letrare interpretohen si shprehje tē transformuar tē pavetëdijes së autorit dhe materiali biografik merret si dëshmi

plotësuese aty ku është e mundur. Resultati është zakonisht një psikobiografi, e cila ka ngashmëri me përkushtimet e rasteve të vetë Freudit. Shembulli klasik është Edgar Poe (1933) i Marie Bonapartes, për tē cilin vetë Freud shkroi parathëni. Studimi i vetë Freudit për Leonardo da Vinci, "Eine Kindheitserinnerung des Leonardo da Vinci (1910), është një shembull i qartë i konstruksioneve të tilla psikobiografike.

Një tjetër strategji analitike njeh natyrën problematike të përpjekjes për tē rindërtuar pavetëdijen e një autori duke lexuar tekste letrare nën dritën e tezës që do tē vërtetonin në mënyrë ideale dhe zgjedh tē kënaqet me "vetë tekstet", që do tē thotë para së gjithash personalat dhe konstelacionet e personazheve, që shfaqen në tekste. Edhe këtu, vetë Freud ofron modele të caktuara, për shembull përmes mënyrës së tij të interpretimit të personazhit të Hamletit dhe hezitimit të tij në Die Traum deutung. Kur Hamleti heziton t'i marrë jetën xhaxhait të tij, kjo ndodh sepse ai në mënyrë të pavetëdijshme identifikohet me veprimet e Klaudit - tē vrasësh vëllain (babain) dhe tē martohesh me kunatën (nënën). Kritika psikoanalitike është e pasur me një psikoanalizë të tillë të personave të trilluar. Jo më pak brenda traditës psikanalitike, e cila shpesh quhet "shkolla e relacioneve me objektin" dhe që, ndër tē tjera, ka Melanie Klein si figurë qendrore në plan të parë, gjëjmë kontributë tē rëndësishme në këtë formë të interpretimit të veprës psikoanalitike. Pyetja nëse është e arsyeshme tē konsiderohet se personat e trilluar mund të kenë diçka "në ndërdije" që mund tē interpretohet, megjithatë, është një kundërshtim i ndërlikuar ndaj një kritike të tillë. Këtë e pranon, ndër tē tjera, ndoshta analisti më i sofistikuar i teksteve brenda kësaj tradite, francezi Charles Mauron. Në librat e tij si Des métaphores obsédantes au mythe personnel (1963) ai zhvillon nën nozioni "psikokritikë" një analizë të rafinuar të rrjeteve dhe modeleve që krijojnë midis imazheve dhe konstelacioneve të figurave në veprat që ai i studion. Këto rrjete, të cilat në një farë kuptim duhet tē korrespondojnë me "asociacionete lira" në një terapi psikoanalitike, organizohen kështu në një "mit personal", që interpretohet në mënyrë psikoanalitike, eventualisht me mbështetjen e informacioneve biografike për autorin

që ka krijuar tekstet. Edhe këtu fundamenti psikobiografik bëhet i domosdoshëm.

Lloji i tretë i kritikës psikoanalitike kthehet drejt polit tē tretë në procesin e komunikimit letrar, pra lexuesi. Përfaqësuesi kryesor i kësaj teorie psikologjike tē receptionit është amerikan Norman N. Holland. Në të vërtetë, në librin e tij të parë botuar më 1968, The Dynarnicks of Literary Response, Hollandi përpinqet tē bashkojë një teori tē re tē frysmezuar kritisht tē veprës letrare me një teori psikoanalitike të mbrojtjes dhe identifikimit, në një mënyrë të tillë që magjepsja dhe përfjetimi e lexuesit mund tē shpjegohet në funksion tē vetë strukturave të veprës.

Qasjet klasike frojdiane (për shembull teoria e fazave tē ndryshme psikoseksuale) dhe metodat e interpretimit (kryesish që rrjedhin nga teoria e endrrave) përdoren për tē shpjeguar përvojën e lexuesit dhe efektivitetin e letërsisë. Në veprat e mëvonshme si Five Readers Reading (1975), Hollandi braktis teoritë e tij rreth korrespondencës midis strukturës së veprës dhe përvojës së lexuesit në favor të një hetimi thjesht psikoanalitik tē asaj që ndodh kur lexojmë. Resultati është një seri skicash psikobiografike të pesë lexusve individualë, të cilat do tē vërtetojnë tezën se është konstituimi psikologjik i vetë lexuesit, tema identitare e tij, që e vetme përcakton receptimin e letërsisë, ndërsa vetë teksti letrar pothuajse merr statusine stimulit tē pastër. Në mënyra tē ndryshme, këto tre qasje tregonë disa nga problemet që lidhen shumë me një teori psikoanalitike tē letërsisë.


Megjithatë, psikanaliza i ka dhënë impulse tē rëndësishme teorisë moderne letrare. Me Paul Ricoeur-in, mund tē thuhet se psikanaliza ka revolucionarizuar mënyrën tonë tē tē kuptuarit dhe tē interpretimit tē "kuptimit"; na ka dhënë një kuptim tē ri se çfarë janë fantazitë: ajo ka sfiduar pikëpamjet tona tradicionale se çfarë është subjekti dhe vetëdija; dhe kemi-plot shembuj se si kritikët letrarë kanë qenë në gjendje t'i përdorin impulsit e tilla në premisat e veta teoriko-letrare.

Kritikja letrare franceze Marthe Robert, për shembull, ka zhvilluar një teori tē romanit, në Roman des origines et origines du roman (1972), ku, duke u nisur nga një ese e shkurtër e Freudit mbi "romanin familial", ajo përvizuan pikëpamje emocionale si mbi historinë e zhanrit, ashtu edhe për raportin midis fiksionit dhe realitetit në teorinë e romanit. Studiu i Amerikan i letërsisë Peter Brooks është frysmezuar në mënyrë tē ngashme nga psikanaliza në esetë e tij mbi teorinë narrative dhe poezinë narrative, tē përbledhura në Reading for the Plot (1984). Duke u mbështetur në teoritë e Freudit, si dëshira narrative, detyrimi i përsëritjes, shtyja e vdekjes dhe mekanizmat e transferimit, në terapinë psikoanalitike, Brooksi zhvillon një pikëpamje tē re tē "shtysës" narrative, që ia mundëson atij tē jepë shgyrtojë dinamikën e strukturave narrative dhe tē paraqësë një konceptim më fleksibel tē komunikimit narrativ sesa e gjejmë shpesh në sintezat thjesht letrare. Interesi teoriko-letrar i 20 viteve tē fundit për psikanalizën në veçanti lidhet me rileximin e Jacques Lacan-it dhe zhvillimin e mëtejshëm tē teorive të Freudit. Pika tē rëndësishme në teoritë e Lacan-it janë ideja e tre "rendeve" (imaginare, simboliqe dhe reale), theksimi i tij mbi rëndësinë themelore tē gjuhës si në psikanalizë ashtu edhe në zhvillimin dhe jetën njerëzore, dhe këndvështrimi i tij për dëshirën si një dinamikë "metonimike" gjuhësore dhe imaginative rreth një mungese a zbrazëtie që nuk mund tē plotësohet. Ai ka pasur një ndikim të madh në teorinë letrare evropiane dhe amerikane. Ndërsa ata që përfaqësojnë një vazdimësi tē pavarur tē impulseve lakaniane, duhet përmendur Julia Kristevën, semiotisten dhe psikanalisten franko-bulgar, e cila, veçanërisht në vitet 1980, ka botuar libra dhe artikujt ku këndvështrimi bazë për letërsinë dhe artin është psikoanalitik. Në Pou voirs de l'horreur (1980) trajton rolin që luajnë refuzimet si diversione psikike gjatë tranzicionit të vështirë nga faza pre-edipale në atë edipale; Histoires d'armour (1983) trajton dashurinë nga një kënd psikoanalistik; Soleil noir. Dépression et melancholie (1987) përqendrohet në përvojat e pikëllimit dhe depresionit. Në të gjithë këta libra, arti dhe letërsia luajnë një rol qendror për argumentimin teorik. Një studiu i Amerikan e cila gjithashtu është frysmezuar nga teoritë e Lacan-it është Shoshana Felman. Artikulli i saj kryesor "Turning the Screw of Interpretation" (1977) paraqet një kritikë inteligjente tē interpretimit letrar klasik psikoanalitik dhe një demonstrim interesant se si një këndvështrim lakanian i dëshirës mund ta mbarsë analizën letrare moderne, Felman, përndryshe, ka shkruar gjithashtu një hyrje në teoritë e Jacques Lacan-it (shih bibliografinë). Ndonëse shumica e impulseve psikoanalitike në teorinë moderne letrare rrjedhin nga teoritë frojdiane, edhe teoritë e thella psikologjike të C.G. Jung-ut kanë ndikuar pjesërisht në studimet letrare. Vetë Jungu ishte rxënës i Freudit, por u shkupët nga ai për shkak tē një mosmarrëveshjeje rreth rolit tē seksualitetit në psikikën njerëzore. Ai zhvilloi teorinë e tij, ku konceptet e ndërdijes kolektive dhe arketipet gradualisht morën rol qendror. Artikulli i Jungut "Psikologjia dhe Letërsia (1930) është, në shumë mënyra, një përgjigje polemike ndaj artikullit të Freudit mbi krijuarin dhe fantazitë dhe tërheq edhe tiparet kryesore tē teorisë së arketipave.

Ndërsa studimet e kritikës letrare tē frysmezuar nga Jungu mund tē përmenden Psychanalyse de l'art (1929) të francezit Charles Baudouin dhe Archetypal Patterns in Poetry në poezi të anglezës Maud Bodkin (1934). Përndryshe, impulset Jungiane mund tē gjurmohen në pjesën më të madhe tē kritikës së re amerikane (shih këtë kapitull). Në Skandinavi, studimi i Egil Nyborg-ut për H.C. Andersenin përfaqëson një nga analizat e pakta tē letërsisë tē frysmezuar nga Jungu.

(Përktheu: Qerim RAQI)

DASHURIA



Carlos FUENTES

Në Jukatan (Yucatán), ujët nuk duket kurrë. Rrjedh nën tokë, poshtë një manteli të brishtë dheu dhe guri gëlqeror. Herë-herë, kjo shtrojë delikate jukatanase shfaqet me sy uji apo me pellgje uji - puset shpelllore -, që dëshmojnë ekzistencën e rrymave të nëndheshme misterioze. Besoj se dashuria është si lumenjtë e fshehtë dhe burimet e papandehshëm të Jukatanit. Jetët tonë ngjajnë shpesh me humnerat e thella, të cilave nuk do t'u gjendej fundi, nëse në shtratin e zbrazëtisë së tyre nuk do të rriddhe një lumë, i qetë e ndonjëherë i lundrueshëm, mundet i rrëmbyer, i gjërë ose i ngushtë, por gjithmonë përqafim uji që nuk na lë të zhdukemi përgjithmonë në hapësirën e asgjësë. Mundësia dhe rreziku i të shpresurit në vend të rrezikut pa asnjë shpresë.

Në qoftë se dashuria është lumë që rrjedh dhe ushqen jetën, kjo nuk tregon se dashuria dhe cilësitet e saj më të çmuara - mirësia, bukuria, ngrohtësia, solidariteti, kujtimi, miqësia, dëshira, pasioni, intimiteti, shpirtgjerësia, vetë ëndja për të dashuruar dhe për të qenë i dashuruar - e përjashtojnë atë që duket sikur e mohon: të keqen. Në jetën politike është e mundur të bindesh se veprohet nga dashuria për një popull dhe përfundon duke e shkatërruar atë popull, duke ndërsyer urrejtjen - nga brenda dhe nga jashtë. Për shembull, nuk e vë në dyshim që Hitleri e donte Gjermaninë. Por qysh me Main kampf-in e tij bëri të ditur se dashuria për Gjermaninë ishte e pandashme nga urrejtja për ata që Hitleri i shikonte si armiq të Gjermanisë. Kjo dashuri, e ushqyer nga urrejtja për të tjerët, u shpreh qartë në një politikë të së keqes më të pashembullt në histori. Qysh në fillim, Hitleri deklaroi se, për të arritur të mirën, do të praktikonte politikën e së keqes. Ndryshe nga Stalini, i cili nuk do të guxonte ta quante me emrin e saj dhe do ta mbështilte të keqen me flamurin e një ideologjje perëndimore - marksizmin - për të bërë tmerre, po ashtu si Hitleri, ky i fundit nuk e maskoi aspak të keqen. Dashuria e Hitlerit për të keqen e çoi atë drejt një apokalipsi flakadanësh vagnierian, mu në mes të Berlinit. Ndërsa dashuria e Stalinit për të keqen u shfaq me rrënimin e ngadalët të një Kremlini prej rëre të shpëlarë nga valë, të lehta por të vazhdueshme, të së njëjtës histori, që Diktatura e Proletariatit mëtonë të mishëronte. Ndërsa nazizmi u shemb si një dragua i tmerrshëm i plagosur, komunizmi sovjetik u zvarrit drejt vdekjes si një krimi i sëmurë Fanfer dbe Ohllomov.

Markezi de Sade, po ashtu, propozon një dashuri të së keqes që lyp kënaqësinë e trupit pér të shkaktuar dhimbjen e trupit dhe deri zhdukjen e tij mortale. Dashuria sadiste, na thotë Markezi de Sade, mund të jetë një e keqe pér viktimin, por është një e mirë supreme pér xhelatin. Megjithatë, Sade nuk pretendonte ta çonte vizionin e tij monstruoz të së keqes si të mirë në praktikë. Ai nuk ishte politikan, ishte shkrimtar, pothuaj pérherë i burgosur, pra i paftë pér të vepruar, veç i lirë vetëm në mbretërinë e fantazisë. Atje ishte mbret i krijimit. Ai na

paralajmëron: «Jam shthuranak, por nuk jam delikuent e as vrasës.»

Ka edhe një formë tjeter të maskuar të së keqes të paraqitur si dashuri. Kjo konsiston në imponimin e vullnetit tonë ndaj tjetrit "për të mirën e tij", domethënë, nga dashuria për të, ia ndryshojmë fatin atij dhe e zhveshim prej lirisë, gjithnjë në emër të dashurisë. Temë e vazhdueshme në letërsi që, përmua, askush nuk e ka trajtuar me aq qartësi sa Francois Mauriac (gazetar, kritik dhe shkrimtar francez. Nobelist në letërsi (1952). Njihet si një nga shkrimtarët e mëdhenj të shekullit XX), një autor që më ka çuar peshë në rrininë time. Thérèse Desqueyroux, Le Désert de l'amour, Le Noeud de vipères, Le Baiserulépreux, Le Mal, janë romanet e tij përfshirë të keqen zvetënuar që, duke tentuar të bëjë të mirën, shemb apo shkatërron aftësinë përfshirë dashur, e manipuluar nga feja, nga parat e, mbi të gjitha, nga normat shoqërore dhe fariseizmi. Thérèse Desqueyroux, në kulmin e dramës së shtrimit të rrugës drejt ferrit përfshirë qëllime të mira, vret në emër të një faji të vjetër përfshirë shpëtuar hybris-in familjar me çmimin e shëndetit të vet. Shoqëria, familja, nderi, përcaktojnë kështu, në emër të dashurisë ndaj këtyre institucioneve, skllavërinë erotike dhe krimin plot pasion të heroinës.

Lëvdata e dashurisë si realitet apo aspiratë supreme e qenies njerëzore nuk mund e as duhet ta harrojë vëllazërën e së keqes edhe pse, në thelb, nuk shumicën e rasteve, e kapërcen atë. E fashit po kurrrë nuk e mposht dot përfundimisht. Dashuria lyp patjetër një mjegull dyshimi kundër së keqes që i zë prit. Vec jo vetëm kjo mjegull, por vetë zemërimi i qellit, davariten te kënaqësia, ëmbëlsia, nganjëherë, pasioni i verbër, lumturia, qoftë kjo edhe kalimtare, e dashurisë, ashtu siç e përjetojnë si burrat dhe gratë. Pasiioni më i fortë e më i dhembshur mund të degjenerojë në monotoni, në bezdisje, me kalimin e kohës. Një çift fillon njohjen me njëri-tjetrin, sepse, mbi të gjitha, nuk njiheshin. Gjithçka është e papritur. Kur nuk ka më të papritur, dashuria mund të vdesë. Nganjëherë, synon të rifitojë mrekullinë fillestare, por në fund kupton se, herén e dytë, mrekullia tashmë është vetëm nostalqji. Përshtatja me të përditshmen mund të shihet nga disa si një ngarkesë e rëndë - një fund i shkretë, i përsëritshëm dhe i mërzitshëm, oaza e vëtrme e të cilit është vdekja, televizori apo dhoma veças. Por, po ashtu, sa çifte nuk kanë zbuluar dot te kjo rutinë dashurinë e vërtetë e më të qëndrueshme, që mban dhe ruan shumë mirë paninë dhe mbështetjen, të cilat gjithashtu, janë emra të dashurisë. A nuk është një tjetër shkretëtirë, përvluese gjatë ditës dhe e akullt gjatë natës, ajo e pasionit të pareshtur, e mundimshme deri në atë shkallë sa protagonistët e mëdhenj të dashurisë romantike preferojnë më mirë vdekjen e re dhe të apasionuar në kulmin e vet, se sa humbjen e pasionit në grinë e jetës së përditshme? A mund të plakeshin së bashku Romeo dhe Zhulieta? Ndoshta. Por i riut Werter nuk mund t'i përfundonte ditët e tij duke parë Big Brother në televizor si e

vëtmja mënyrë pjesëmarrëse zëvendësuese
në pasione më pak gjumashe se të tijat.

Dashuria kérkon që të jetë kënaqësi e plotë, sa më gjatë të jetë e mundur. Kjo ndodh kur dëshira lulëzon nga brenda dhe shkon deri te duart, te gishtat, te kofshët, te beli, te mishi i ngritur dhe te mishi i hapur, te ledhatimet dhe te pulsi i dorës që rreh, tek universi i lëkurës së dashur, kur të dashuruarit janë të kthyer në botën e tërë, janë kthyer në zérat që pëshpëritin në heshtje, janë kthyer në bekim të brendshëm të gjithçkaje. Ndodh kur nuk e mendojmë fare se kjo do të marrë fund. Ose kur mendojmë përgjithçka, për të mos menduar tek ajo apo përt'i dhënë lirinë dhe shkurtësinë e vet më të gjatë kënaqësisë mishtore dhe i japid të drejtë San Agostinit që thotë se dashuria është more bestiarum, por me një ndryshim: vetëm ne qeniet njerëzore (lër ménjanë pozicionet e ndërlikuara) bëjmë dashuri duke u parë në fytyrë. Për kafshën nuk ka përjashtime. Për ne, përjashtimi kafshëron është rregulli njerëzor.

Kur është më e madhe lumturia e dashurisë? Në aktin e dashurisë apo në hopin përpara, apo në përfytyrimin e asaj që do të ishte lidhja dashurore që vjen? Apo hareja sfilitëse e kujtimit dhe përséri dëshira e plotë, e shtuar nga etja për një akt tjetër dashurie, është lumturi? Kjo kënaqësi e dashurisë na lë pa mend. Si është e mundur që e tërë genia jonë, me gjithçka ka, përhumbet në mishin dhe vështrimin e qenies së dashur dhe, njëherazi, në dashuri, duke humbur kuptimin e botës jashtë dashurisë? Si është e mundur? Si paguhet kjo dashuri, kjo kënaqësi, ky iluzion?

Çmimet me të cilat bota blen dashurinë janë të larmishme. Por, ashtu si në teatrot dhe në stadiume, ka bileta me çmime të ndryshme për vendë të ndryshme apo përkarrige të preferuara. Vështrimi është biljetë e domosdoshme për dashurinë. Një fjalë e urtë thotë se dashuria hynë nëpërmjet syve. Në të vërtetë, kur biem në dashuri, gjithë bota nuk ekziston në vështrimin tonë dhe ne kemi sy vetëm për qenien që dashurojmë. Një natë, në Buenos Aires, jo pa u skuqur në fytyrë, gjithë emocioni, njëherazi, turp, zbulova një tjetër dimension të vështrimit dashuror: mungesën e tij. Mikesha janë Luiza Valenzuela (shkrimtare dhe gazetare argjentinase) na çoi, mua dhe time shoqë, në një vend tangoje, diku te Avenida Rivadavia, që s'ka të mbaruar. Një sallon i veçantë balloje, ku s'kishte turistë e as lojëra dritash, strobelights verbuese. Një sallon i njojsh lagjeje, një orkestër me piano, violinë dhe harmonikë. Njerëzit të ulur në karrige të mbështeturë përmuri, si në festat familjare. Çifte të të gjitha moshave dhe përmasave. Dhe një mbretëreshë e pistës së vallëzimit. Një vashëz e verbër, me syze të errëta dherë me fustan plot lule. Një Delia Garses (artiste argjentinase, kinemajë dhe teatri, me një bukuri fizike të pashoqe. E njojur si "dama e çiltër". Një nga yjet më të shquara të kinemasë së artë argjentinase në dekadat e 40-50) e rilindur. Ishte balerina më e duartrokitur. Linte mbi karrige bastunin e saj të bardhë dhe dilte e vallëzonte pa parë, amë, duke genë e soditur. Vallëzonte në mënyrë të mrekullueshme. I jepte tangos përkufizimin e Santos Discépolo (kompozitor, dramaturg dhe kineast argjentinas): «Është një mendim i trishtë, që vallëzohet.» Ishte një formë e bukur dhe e çuditshme dashurie vallëzimi, njëherazi, në drithë dhe në errësirë. Givsmëdrithë.

Po ashtu, "muzgu i brendshëm", me kalimin e kohës, na mëson se mund të duam edhe të metat e qenies së dashur. Nuk e duam, duke e anashkaluar, të metën e qenies së dashur, por e duam pse e ka atë të metë. Sepse një lloj mangësie, një defekt i vlerësueshëm, na e bën më të dashur personin që duam, jo pse na bën të besojmë tek epërsia jonë - grekët e lashtë e ndëshkorin hybris-in si fyerje tragjike, më shumë kundër kufijve njerëzor se kundër perëndive -, veç, përkundrazi, ngaqë na lejon të pranojmë pikërisht të metat tonë dhe, me përpikëri, na bën më të barabartë. Kjo ndryshon nga forma tjetër e dashurisë, që është vullneti për të dashuruar. Bëmë e dykuptimtë, ku dinakëria apo një formë

miqësie për leverdi, për të cilën Aristoteli na thotë se mund të shfaqet me valëvitet e flamujve të solidaritetit, por gjithashtu mund dalë e veshur edhe me leckat e përfitimit vetjak. Duhet t'i kemi shumë të qarta këto dy lloj dashurie, sepse e para është shpirtmadhësi e pastër, ndërsa e dyta i përket vetëm egoizmit.

«Një egoizëm i përsosur midis të dyve» është formula, tepër franceze, siç e përcakton Sasha Guitri (aktor, dramaturg dhe skenarist francez, me origjinë ruse) dashurinë, duke i dhënë një pamje ironike vetë intimititetit. Egoizmi i përbashkët do të thotë, nga njëra anë, të pranosh, të tolerosh apo të ruash maturinë përballë mjerimeve të shumta që, sipas fjalëve të Hamletit, «mishi trashëgon». Por thjesht egoizmi - vëtmia e plotë dhe koprrace -, jo vetëm është ndarje nga tjetri, por edhe nga vetvetja. Mbi të gjitha, nuk mungon ai që thotë se çasti më i mirë i dashurisë është ndarja, vëtmia, melankolia e kujtimeve, momenti vëtmitar... Gjendje e parapëlqyeshme për melanolinë e dashurisë që kurrë nuk ka ndodhur nga nxitimi, nga mospërfillja, nga mungesa e kohës. «Nuk pati kohë. Nuk pati kohë për fjalën e fundit. Nuk pati kohë për të thënë të gjitha gjérat e dashurisë.»

Vulln apo zakon, shpirtmadhësi apo papërsosmëri, burkuri dhe tërësi, intimitet dhe ndarje, dashuria, ky akt human, si çdo gjë humane, paguan çmimin e një fundi. Në qoftë se dashuria bëhet synimi më i sigurt dhe kënaqësia më e padyshimtë e jetës sonë, kjo ndodh ngaqë, sepse është e tillë ose për të qenë e tillë, duhet të ëndërrrohet e kufizuar vetëm sepse, fatalisht, është e kufizuar. Dashuria, vetëm në vjetvete ngjizet pa kufi. Në të njëjtën kohë, të dashuruarit e dinë (edhe pse nga pasioni ata verbohen dhe e mohojnë një gjë të tillë) se dashuria e tyre do të ketë kufij - nëse jo në jetë, me siguri me vdekjen e saj që, sipas Bataille (shkrimitar, antropolog dhe mendimtar francez), është perandoria e erotizmit real: «Vazhdimi i dashurisë më të zjarrtë në mungesë për shkak të vdekjes së qenies së dashur.» Kati dhe Hitkif te romani Majat e stuhishme i Emily Bronte. Pedro Paramo dhe Suzana San Huan te romani Pedro Páramo i Huan Rulfo. Por, në jetë, a na kënaq plotësisht më absolutja dhe më e madhja e dashurive? Mos vallë në jetën tonë duam gjithmonë më shumë? Nëse do të ishim të pambarimtë, do të ishim Zot, thotë poeti. Por, të paktën duam të dashurojmë pafundësisht. Dashuria jonë është gati hyjnore. Është vështrimi ynë i perëndimit dhe vështrimi ynë prej Perëndie.

Dashtë Zoti që lexuesi i këtij shkrimi gjenn format e larmishme të dashurisë në çdo shkronjë të alfabetit tim personal. Megjithatë, ka një formë dashurie që kam dëshirë ta vë në dukje, me qëllim që ta keni gjithnjë parasysh. Është cilësia e përkujdesjes. Dashuria vetë si përkujdesje. Të përkujdesesh për të dashurin. T'i jepesh përkujdesjes. Sepse përkujdesja ekstreme është aftësia krijuese dhe prirja e saj është dashuria.

Filosofja me origjinë hungareze, Agnes Heller, shkruan se etika është çështje përgjegjësie personale, përgjegjësi që e marrim në emër të një personi tjetër: përgjigja jonë ndaj thirrjes së tjetrit. Çdo etikë kulmon në një moral të përgjegjësisë: moralist jemi përgjegjës për veten tonë dhe për të tjerët. Megjithatë, si mundet vetëm një person të bëhet përgjegjës për të gjithë? Kjo është pyetja qendrore e romaneve të Dostoevskit.

Si mund të rroket përvoja e plotë e një njerëzimi të vuajtur, të poshtëuar, të shumëdëshiruar? - e pyet Dostojevski, me dëshpërim ronor, kritikun më të madh rus të kohës së vet, Visarion Gregorievic Bielinski. Përgjigja e kritikut ishte, jashtë mase, e saktë: «Fillo vetëm me një qenie njerëzore. Me atë që ke më pranë. Kape me dashuri dorën e burrit të fundit, e gruas së fundit, që ke parë, dhe në sytë e tij apo të saj do të shohësh të pasqyrohen hallet, përvojat dhe dashuria e gjithë njerëzimit.»


(Në shqip: B. Karabolli)

SHKRUAJ PËR LEXUESIT, JO PËR KRITIKËT

Jam bërë më i vetëdijshëm për lexuesin. Them se kur isha më i ri thjesht shkruaja; nëse lexuesit shfaqeshin diku, shumë mirë, nëse jo, s'prishte punë. Kam pasur një lloj qëndrimi shumë më të ashpër

Salman RUSHDIE

S'mund t'ia lejosh vetes të mendosh për kritikën kur po shkruan librin. Është tepër e vështirë ta shkruash librin dhe në të njëjtën kohë, të rrekesh të hamendësosh si do të jetë reagimi kritik ndaj tij. Por them se i përfytyroj mjafit mirë lexuesit e mi. Ndërsa vitet mbi supe më shtohen, interesohem gjithnjë e më shumë për mënyrën se si lexojnë njerëzit, çfarë ka të ngjarë t'i largojë dhe t'i tërheqë. Jam bërë më i vetëdijshëm për lexuesin. Them se kur isha më i ri thjesht shkruja; nëse lexuesit shfaqeshin diku, shumë mirë, nëse jo, s'prishte punë. Kam pasur një lloj qëndrimi shumë më të ashpër. Por tani jam vërtet i interesuar të lexohem, për dukurinë e leximit dhe si, nëse informacionin e jep në rendin e saktë, mund të tregosh gjëra shumë të ndërlikuara, të cilat për lexuesin bëhen të rrokshme, kanë lidhje me ta dhe u ngjallin dëshirën për t'i zbuluar. Për shembull, në rastin tim, gjithmonë kam menduar që komedia ndihmon shumë. Mendoj se nëse arrin t'i bësh njerëzit të qeshin, mund t'u thuash gati çdo gjë. Nëse s'i bën dot të qeshin, s'do të duan të të dëgjojnë për një kohë të gjatë. Kjo është e para. Por për kritikët, për një lloj reagimi kritik ndaj asaj që shkruaj, s'mendoj dot. Dua të them se në këtë moshë kuption se ka njerëz që s'do ta pëlqenjë çfarëdo që të shkruash. Kësisoj, e dija që mund të shkruaja librin më të mirë që mund të shkruaj dhe sërisht do të kishte disa që



thjesht s'do ta pëlqenin, dhe s'ka gjë përtu quditur këtu. Kjo është arsyesa pse në librari ka lloje të ndryshme librash, që njerëzit të zgjedhin atë që u pëlqen. Prandaj s'më shqetëson kjo. Përmjëmend s'më shqetëson reagimi i kritikës. Kur ke shkruar disa libra, e ke të qartë drejtimin nga do të shkosh. Këndvështrimi im është: tani për tanin do të shkoj në këtë drejtim dhe vërtet shpresoj se dëshironi të vini me mua. Shpresoj ta shijoni udhëtimin dhe kështu me radhë, por nëse, për çfarëdo arsyese, s'mund të më shqëroni në këtë udhëtim, unë do të vazhdoj të ndjek rrugën time. Dhe atëherë merr me vete kë të mundesh në këtë arrati. Mendoj se, në përgjithësi, kam pasur goxha shumë shoqëruar

gjatë arratisjeve të mia. Mund të parashikoj se kur ndodh akident me kritikën letrare gjatë udhëtimit, sepse e marr me mend, por në njëfarë mënyre kjo s'ka rëndësi. Dua të them, mbaj mend që në një lloj epoke të parainternet kishte një kohë kur revista të ndryshme letrare pëndoreshin përtë botuar recensione në mënyrë anonime dhe më e famshme Times Literary Supplement s'i përmendte kurrë emrat e kritikëve të saj. Ideja ishte që të krijohej përshtypja që ishte Times që po jepte mendimin e saj për veprën tënde dhe jo një individ. Dhe pastaj në kohë tjetër, them se diku në vitet 1980, kjo politikë u ndryshua duke vënë emrat e kritikëve. Menjëherë vlerësimet u bënë shumë më të matura,

sepse emri i kritikut i bashkëngjitej kritikës letrare. S'ka dyshim se mënyra si jetojmë me internetin është gjysmë imaginare. E para, njerëzit përdorin emra të rremë gjatë gjithë kohës, përdorin vazhdimisht pseudonime dhe përtë këtë arsyë, mund të shpikin vetveten përtë qenë në internet pa i pyetur se kush janë. Mendoj se kjo mund të jetë e mirë dhe e keqe. E shoh qartë se çfarë ndodh në pjesë të botës që janë shqëri më pak të hapura, që anonimati i lejon njerëzit të shprehen pa frikë. Dhe mendoj se ka një lloj lojçakëria në këtë. Shpik përveten një emër të çmendur dhe mbas mund të jesh një person pak më ndryshe me atë personalitet sesa të mundesh të jesh si vetvetja. Kështu, ka shumë përtë thënë përtë këtë çështje. Dua të them se më pëlqen shumë lojçakëria dhe një lloj aspekti çlirues i saj. Një lloj shqetësimi që kam përvendet përdorues anonim të internetit është se kjo krijon deri diku dukurinë e karremit. Duke qenë plotësisht i sigurt pas ekranit të emrit imagjinar, ti mund të jesh shumë, shumë i pasjellshëm. Kam frikë ndonjëherë se po bëjmë të mundur të kemi një brez njerëzish shumë të vrazhdë që mund të flasin në internet në një mënyrë që kurrë s'do të flisin nëse do të ishin në dhomë me ty. Ky është shqetësimi im. Por mendoj se, në përgjithësi, është një hapësirë e gjallë. Është një hapësirë ku njerëzve u pëlqen të jenë shpikës dhe imagjinues përveten e tyre dhe teknologjia u lejon ta bëjnë këtë. (2019)

Interpretim

POEZIA E ARSENI TARKOVSKIT

Sa mahnitëse është që një poet me një përulësi kaq të madhe (ndaj humusit, tokës) është në gjendje që strofën e fundit, ta mbyllë duke folur si vdekatar

Philip METRES

Arseni Tarkovski (1907–1989) është një prej poetëve prijës në poezinë ruse, të dalë nga epoka sovjetike, megjithëse, siç thuhet, shumicën e kohës është marrë me përkthime të poezisë aziatike. I biri, Andrei Tarkovskij, filmbërës, u dha një jetë tjetër vargjeve të tij.

Poezia e Tarkovskit demonstron pasurinë e poezisë ruse, të prirë siç është nga muzika e saj dhe nga një shumëlojshmëri mahnitëse e metrave dhe skemave të rimës; përkthimi ynë, siç e përcaktuam, duhet të bëjë çdo përpjekje për një muzikë paralele (në mos tamam korresponduese). Për shembull, në portretin e tij të kohës së luftës "Një i verbër po udhëtonë...", Tarkovski praktikon një trimetër daktelic (plus një ritëm përfundimtar) në varg distik që u bën jehonë metrave të këngës popullore të lirshme të Nikolai

Nekrasovit, duke krijuar një efekt keqtingëllues me fotografinë e zymtë të një të verbri në një tren mallrash gjatë pushtimit nazist. Pothuajse rastësish, fillova ta dëgjoja poemën si amfibrah, një këmbë e pazakonshme triplësëshe (e patheksuar-e theksuar-e patheksuar) dhe pastaj punova përtë ta hequr atë valle gati deri në fund.

Pa një ritëm dhe rimë, do të rrezikonim ta kthenim Tarkovskin në një realist socialist standard, duke humbur atë qepje tingulli dhe vizioni që e bën poezinë e tij të qëndrueshme. (I kam dhënë vetes pak liri me kuptimin, por kryesisht si një mënyrë përtë mos e thyer artikulimin.

Te "Për poemat", panteizmi karakteristik kristian i Tarkovskit ngrihet në sipërfaqjen e poemës, si e gjelbra e papritur në pranverë. Vijat përfundimtare paraqitnin një problem që u qartësua nga F.D. Reeve, i cili

vërejti se «Sytë e barit» u referohet fushave me bar, që janë të mbushura me lule të egra, «sytë» e të cilëve do të mbillnin farën në tokë.

Në atë që është një problem tepër tipik në përkthim, ajo që dukej si një surrealizëm i pastër i thelli "Sytë e barit" ishte një kërcim bashkëshoqëruar nga një vend në një vend tjetër, shumë mbi tokë dhe nën tokë. Sa mahnitëse është që një poet me një përulësi kaq të madhe (ndaj humusit, tokës) është në gjendje që atë strofë të fundit, ta mbyllë duke folur si vdekatar.

Arseni Tarkovski

NJË I VERBËR I HIPUR NË NJË TRENA NGROHJE

Një i verbër i hipur në një tren pa ngrohje,

Nga Brianci po udhëtonë përtë shtëpi me fatin e tij.

Fati i pëshpëriti diçka që i gjithë vagoni mundi ta dëgjonte: Pse duhet ta vrasësh mendjen përvërbërinë dhe luftën?

Është mirë, po i thoshte, që ti nuk sheh dhe je i varfër.

Po të mos ishe i varfër, nuk kishe përtë mbi jetuar.

Gjermanët do të të kishin vrarë, ti ishe askushi përtë ta,

Lermë të ta vë këtë çantë në sup.

Atë me vrima, të grisurën bosh. Më lër të të ngre qepallat sa më lart.

I verbri po udhëtonë përtë shtëpi me fatin e tij

Tani falënderues përvërbërinë. I lumtur që e kish.

(Përktheu: Irena Dono)

NUMRI I ARDHSHËM MË 5 SHTATOR

HEJZA

20 GUSHT, 2023

Kryeredaktor i Hejzës: **Avni Halimi** (avni65halimi@gmail.com)

Editon Produksioni **TAKAT STUDIOS**
Drejtor: **Genc Halimi** (genc@takat.tv)

Rruga e Kaçanikut nr. 208, Shkup, 1000